

# Qeveria e Republikës së Maqedonisë

## **Propozimi i Strategjisë për Menaxhim me Mbeturinat në Republikën e Maqedonisë**

**(2008 – 2020 )**

Shkup, mars 2008

# Përmbajtja

## REZIME EKZEKUTIVE.....

5

ROLI I STRATEGJISË PËR MENAXHIM ME MBETURINAT NË POLITIKËN PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR NË MAQEDONI .....	5
Roli i përgjithshëm i Strategjis për menaxhim me mbeturinat.....	5
Politika për menaxhim me mbeturinat .....	7
Korniza egzistuese ligjore dhe aktivitetet e transponimit.....	7
Status i tanishëm i institucioneve dhe në organet kompetente .....	7
Vetëdije te subjektet e involvuara dhe publiku i gjerë .....	8
Rrjedha egzistuese të mbeturinave dhe praktikave në menaxhimin me mbeturinat.....	8
ASPEKTET STRATEGJIKE DHE QËLLIMET E MENAXHIMIT ME MBETURINAT .....	11
Qëllimet e përgjithshme strategjike dhe të veçanta .....	11
Principet themelore në menaxhimin me mbeturinat.....	13
MASAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR MENAXHIM ME MBETURINAT .....	18
MASAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR MENAXHIM ME MBETURINAT .....	20
Regullativa ligjore për menaxhim me mbeturinat .....	20
Masat ekonomike .....	23
Instrumentet e planifikimit hapsinor dhe mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore.....	24
Vetëdija dhe konsultimi i subjekteve të involvuara dhe i publikut .....	25
Masat prioritare dhe aksionet .....	26
Masat dhe aktivitetet e veçanta kohore .....	28
Vlerësimi i investimeve të nevojshme dhe i fitimeve.....	28
Pasqyrë e planit me aksione për zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat .....	29
1. PARAQITJA HYRËSE E ROLIT TË STRATEGJISË SË MENAXHIMIT ME MBETURINAT NË POLITIKËN e MJEDISIT JETËSOR TË MAQEDONISË.....	30
1.1 Roli i Përgjithshëm i Strategjisë për Menaxhimin me Mbeturinat .....	30
1.2 Roli i Strategjisë së menaxhimit të mbeturinave në kuadër të politikës për mbrojtjen e mjedisit jetësor .....	31
1.3 Roli i strategjisë së menaxhimit të mbeturinave në raportin midis politikës për zhvillim ekonomik dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor .....	33
2. Pasqyrë e shkurtër dhe vlerësimi i gjendjes së tanishme të menaxhimit të mbeturinave dhe sektorëve të ngjajshëm me rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave në Maqedoni.....	36
2.1 Politika e menaxhimit të mbeturinave .....	36
2.2 Korniza ligjore ekzistuese dhe aktivitetet e transponimit .....	37

2.3	Statusi i tanishëm i institucioneve dhe i organeve kompetente.....	37
2.5	Vetëdija tek subjektet e interesuara dhe publiku më i gjerë/konsultim.....	39
2.6	Çështjet ekonomike.....	40
2.7.1	Mbledhja dhe transporti i mbeturinave.....	43
2.7.2	Tretmani, shfrytëzimi dhe reciklimi .....	44
3.	Aspektet strategjike dhe qëllimet e menaxhimit me mbeturinat .....	48
3.2	Qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta strategjike.....	50
3.3	Parimet themelore të menaxhimit me mbeturinat.....	52
3.3.1	Parimet kyçe .....	52
3.3.2	Parimet kyçe për kultivimin e menaxhimit me mbeturinat me elementet themelore të strategjisë së UE dhe resurseve .....	54
3.4	Karakteristikat strategjike të skemës së përgjithshme për menaxhim me mbeturinat .....	55
3.4.1	Parimet themelore për zhvillimin e skemës për menaxhim me mbeturinat në Maqedoni.....	55
3.4.2	Karakteristikat themelore e shemave gjenerale për menaxhim me mbeturinat .....	60
4.	MASA PËR REALIZIMIN E STRATEGJIS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT.....	70
4.1	Regullativa ligjore për menaxhim me mbeturinat dhe harmonizimi me <i>acquis communautaire</i> .....	72
4.2	Masa institucionale dhe organizative dhe rolet e subjekteve kryesore të involvuara për zbatimin e strategjisë për menaxhimin me mbeturinat.....	74
4.2.1	Përforcimi i niveleve institucionale dhe nacionale.....	74
4.2.2	Institucioni për menaxhim me mbeturinat në nivel nacional.....	74
4.2.3	Përforcimi i institucioneve në nivel lokal.....	75
4.2.4	Institucionet për monitorim dhe zbatim.....	75
4.2.5	Detyrat, obligimet dhe kompetencat në sektorin prodhues dhe afarist.....	76
4.2.6	Rolet, obligimet dhe përgjegjësitë e qytetarëve.....	76
4.2.7	Rolet, obligimet dhe përgjegjësitë e organizatave joqeveritare, institucionet arsimore dhe shkencore.....	77
4.3	Masa ekonomike .....	77
4.4	Instrumentet për planifikim hapsinor dhe për mbrojtjen e trashëgimis natyrore dhe kulturore 80	
4.5	Vetëdija e publikut, e subjekteve të involvuara, dhe konsultimet.....	81
5.	PASQYR E PLANIT ME AKSIONET PËR ZBATIMIN E STRATEGJIS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT .....	83
5.1.	Prioritetet e masave dhe aksioneve.....	83
	Masa të veçanta kohore dhe aktivitete.....	88
5.3	Vlerësimi i investimeve i fitimeve të nevojshme.....	88

5.4	Pasqyrë e planit me aksionet për menaxhim me mbeturinat.....	89
Nr. 19-1541/1 e sjellur më.....		98
ZËVENDËS KRYETAR I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË .....		98
Kjo strategji do të shpallet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë ” .....		98
6.	aneksi.....	99

Në bazë të nenit 16 paragrafi 1 nga Ligji për menaxhim me mbeturinat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonis” nr. 68/04 dhe 107/07), Qeveria e Republikës së Maqedonis në mbledhjen e mbajtur më 11 mars të vitit 2008 solli:

## Strategjin për Menaxhim me Mbeturinat në Republikën e Maqedonisë (2008-2020)

### REZIME EKZEKUTIVE

#### ROLI I STRATEGJISË PËR MENAXHIM ME MBETURINAT NË POLITIKËN PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR NË MAQEDONI

##### Roli i përgjithshëm i Strategjis për menaxhim me mbeturinat

Strategjia për menaxhim me mbeturinat e shpreh politikën nacionale në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe paraqet bazë për përgaditjen dhe për zbatimin e sistemit integruar për menaxhim me mbeturinat, i cili do të jetë efektiv në raport me harxhimet. Me këtë dokument strategjik, Republika e Maqedonis i definon drejtimitet fundamentale në sferën e menaxhimit me mbeturinat për periudhën e ardhshme dymbëdhjet vjeçare (2008-2020), në bazë të diturisë se menaxhimi jopërkates me mbeturinat, sot dhe në të kaluarën, sfidojnë pasoja serioze për mjedisin jetësor dhe për natyrën dhe i cakton drejtimitet themelore për vendosje shkallë shkallë në sistemin për menaxhim me mbeturinat, i themeluar në kierarki të principeve themelore në menaxhim me mbeturinat, si dhe në principet themelore të zhvillimit të qëndrueshëm në resurset natyrore.

Strategjia për menaxhim me mbeturinat është rezultat i vendimit të Qeveris, si qeveri ekzekutive dhe në atë kontekst i paraqet vendimet kryesore të Republikës së Maqedonis të lidhura ngusht me qëllimet e mbrojtjes së mjedisit jetësor, qëllimet ekonomike dhe sociale, aktivitete dhe masa për zbutjen e ndikimeve të tanishme ndaj mjedisit jetësor dhe zgjidhëja e çështjeve të lidhura me menaxhimin me mbeturinat në të ardhmen. Harmonizimi i legjislacionit me *acquis communautaire* si proces i patejkaluar në afrimin e Maqedonis drejt anëtarësimit në Unioni Europian paraqet mjet të dobishëm në vendosjen e sistemit efikas dhe të qëndrueshëm në menaxhimin me mbeturinat.

Strategjia për menaxhim me mbeturinat është dokument për qëllimin dhe për vërtetimin e masave relevante

- me qëllim prioritar të tejkalohet gjendja e papranueshme e mjedisit jetësor në kontekst të pasojave nga menaxhimi jopërkates me mbeturinat ndaj ajrit, ujit, tokës, mjedisit natyror, si dhe ndaj shëndetit të banorëve,
- me qëllim të mëtutjeshëm që të arihet kontrollë e tërishme mbi rrjedhat e krijuara të mbeturinës, të zvogëlohen sasitë e mbeturinave dhe potenciali i rrezikut në të njëjtin, të arihet

shfrytëzim optimal i mbeturinave si material/energji, dhe mënjanim i mbeturinës me sistem optimal dhe bashkëkohor në kapacitete të reja infrastrukture dhe

- me qëllim përfundimtar të futen teknologji për prodhim më të pastër dhe menaxhim të qëndrueshëm me resurset natyrore dhe me mbeturinat, si dhe të zvogëlohen emisionet e gazërave të qelqëta që i krijojnë mbeturina.

Mbeturina në të njëjtën kohë posedon komponente ekologjike dhe ekonomike. Mbeturina nuk është vetëm gjenerator i pasojave ndaj mjedisit jetësor, por mundet që të ripërtirhet dhe përsëri të shfrytëzohet. Të gjitha fazat në ripërtirje të fraksioneve të mbeturinës, të cilat janë të përdorura për prodhimin e produkteve të reja ose energjisë, mundësojnë ruajtjen e resurseve natyrore të paripërtitura. Por, materiali i lëndës së parë i fituar nga rrjedhat e mbeturinës dhe i dedikuar për reciklimin si material dhe për prodhimin e energjis duhet që ta gjejë tregun e tyre. Gjatë asaj, çmimet e materialeve të lëndëve të para të marura nga mbeturina nuk janë tërësisht të lëshuara në treg të lirë, me shikim në atë se janë lëndë të politikës dhe në qëllimet që i parashtron shoqëria. Në të njëjtën kohë, menaxhimi me mbeturinat në të gjitha fazat e tyre të grumbullimit, shfrytëzimi si material dhe për energji, paraqet potencial për vende të reja të punës në veprimtaritë shërbyese dhe prodhuese.

Të gjithë përfaqësuesit e shoqëris janë të obligueshëm që të ndërmarin përgjegjësi përkatëse për mbeturinën, sepse të njëjtit paraqiten si posedues dhe krijuar të mbeturinës në tre role të kundërta

- kujdesi për cilësinë e mjedisit jetësor, shëndeti dhe cilësia e jetesës, posaçërisht për gjeneratat e ardhëshme në nivel global dhe lokal,
- krijimi i mbeturinës dhe ndotja e mjedisit jetësor nëpër mes aktivitetetë të përditëshme dhe
- shfrytëzimi i prodhimeve dhe shërbimet .

Ky është shkaku për statusin e veçantë të problemeve të lidhura me mbeturinën, kurse suksesshmëria dhe efikasiteti i zbatimit të strategjis për menaxhim me mbeturinat mvaren, veçanërisht nga investimet e nevojshme kapitale dhe nga kufizimet hapsinore, para së gjithash nga baraspesha përkatëse në mes instrumenteve juridike, institucionale, organizative, sociologjike dhe veçanërisht atyre ekonomike/finansiare.

## **PASQYR E SHKURTËR DHE VLERËSIMI I GJENDJES SË DERITANISHME NË MENAXHIMIN ME MBETURINAT**

Problemet e mëdhaja dhe kufizimet në sferën e menaxhimit me mbeturinat në Republikën e Maqedonis janë prezent pothuajse në të gjitha sferat në sistemin egzistues në menaxhimin me mbeturinat, si dhe në të gjitha marrëdhëniet në shoqëri të cilat sillen në menaxhimin me mbeturinat: korniza politike dhe ligjore; organizimi i institucioneve dhe i resurseve njerëzore, mbulimi i harxhimeve dhe finansimi i shërbimeve dhe investimeve, vetëdija e subjekteve të involvuara dhe informimi i të njëjtave, të gjitha fazat në menaxhim teknik nga grumbullimi deri te deponimi i mbeturinës, egzistimi/sanacimi i ngarkimit në mjedisin jetësor, ndikimi ndaj shëndetit të njerëzve dhe ndaj mjedisit/natyrës jetësore me ndikim potencial ndaj ekonomisë maqedonase.

Gjendja e deritanishme me menaxhimin me mbeturinat në Maqedoni mundet që të karakterizohet si substandarde në shikim të resurseve finansiare dhe njerëzore, si dhe e pamjaftueshme dhe jo efektive në shikim të monitorimit dhe zbatimit të dispozitave, që rezulton në sisteme të ndryshme disfunktionale në shoqëri dhe në shumë efekte negative të njajshme ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj shëndetit të njerëzve.

## **Politika për menaxhim me mbeturinat**

Menaxhimi me mbeturinat është një nga problemet më serioze në Maqedoni. Politika e përgjithshme për menaxhim me mbeturinat, me qëllim që të tejkalohet gjendja egzistuese dhe të vendoset sistem i qëndrueshëm për menaxhim me mbeturinat, ishte e formuar në Ligjin për mjedisin jetësor, në Planet nacionale ekologjike akcionale (NEAP 1996/2007) dhe veçanërisht në Ligjin për menaxhim me mbeturinat. Ligji për menaxhim me mbeturinat fut dokumente të reja në politikën për menaxhim me mbeturinat: Strategjia për menaxhim me mbeturinat, Plani nacional për menaxhim me mbeturinat dhe programi për menaxhim me mbeturinat. Iniciativat e caktuara politike të përmbajtura në NEAP (2007) janë ngusht të lidhura me projektet të lidhura me Protokollin e Kiotës, të themeluara në Mekanizmin për zhvillim të pastër. Por, vendosja egzistuese e politikës dhe në legjislacionin e nivelit nacional janë të pamjaftueshme në disa sfera që të mundën të plotësohen kërkesat e sektorit të mbeturinës.

## **Korniza egzistuese ligjore dhe aktivitetet e transponimit**

Rregullativa themelore nacionale ligjore për menaxhim me mbeturinat përbëhet vetëm nga Ligji për menaxhim me mbeturinat, i cili paraqet akt themelor ligjor dhe i përcakton rregullat e përgjithshme të cilat zbatohen për çështjet themelore të ndërlidhura me mbeturinën dhe me mbeturinën e rrezikëshme; ai, gjithashtu, siguron bazë themelore për sjelljen e shumë akteve nënligjore, por pjesë e tyre mungojnë ose janë të sjellura në formën e rregullores ose drejtimeve. Ligji për menaxhim me mbeturinat ka lidhje të rëndësishme me akte tjera ligjore me të cilat rregullohen detyrat dhe kompetencat në lidhje me çështjet organizative dhe operative nga sfera e menaxhimit me mbeturinat, veçanërisht me Ligjin për mjedisin jetësor, i cili përmban dispozita themelore për lejet ekologjike, procedura për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor, emisionet e gazërave të qelqëta. Rregullativa ligjore themelore nacionale për menaxhim me mbeturinat, e cila paraqet aktin themelor dhe i përcakton rregullat e përgjithshme të cilat zbatohen për çështje themelore në lidhje me mbeturinat në përgjithësi dhe me mbeturinat e rrezikëshme; gjithashtu, siguron bazën ligjore për sjelljen e akteve të shumta nënligjore, por një pjesë e tyre mungon ose janë sjellur në formë të rregullores ose drejtimeve. Ligji i menaxhimit me mbeturinat ka lidhje të rëndësishme me aktet e tjera ligjore me të cilat rregullohen detyrat dhe kompetencat që kanë të bëjnë me çështjet organizative dhe operative nga sfera e menaxhimit me mbeturinat, sidomos me Ligjin e mjedisit jetësor, i cili përmban dispozitat themelore për lejet ekologjike, procedurën e vlerësimit të ndikimeve ndaj mjedisit jetësor, emisionet e gazrave të qelqta.

## **Status i tanishëm i institucioneve dhe në organet kompetente**

Detyrat dhe kompetenca në sferën e menaxhimit me mbeturinat, në praktikën, janë të ndara në mes disa institucioneve qeveritare, të cilat në mes institucioneve qeveritare dhe komunale. Përgaditja, miratimi dhe zbatimi i legjislacionit themelor primar dhe sekondar patjetër duhet të realizohet bashkëpunim i përbashkët me ministrit, organet, komunat tjera me sektorin prodhues/shërbyes dhe me subjektet tjera të involvuara, por llogaritet se egzistojnë paqartësi të vogëla në shikim të rolit dhe në kompetencën, si dhe mungesë e komunikimit dhe koordinimit.

Sipas ligjit, komunat janë përgjegjës për detyra vulluminoze dhe të rënda të lidhura me menaxhimin me mbeturinat, por një numër i vogël prej tyre kanë emëruar seksione kompetente/persona në strukturën administrative të tyre dhe sigurimin e trajnimit përkatës.

Nëse shqyrtohen detyrat dhe kompetencat e nivelit shtetëror dhe lokal, të gjitha institucionet në MMJPH, ministritë, komunat tjera dhe sektori prodhues/shërbyes të cilët kanë kompetenca për zbatimin e detyrave themelore në menaxhimin me mbeturinat kanë mbetje të resurseve njerëzore, dituri dhe përvojë për përgaditjen dhe për zbatimin e rregullativës së tërsishme ligjore, në standardet, instrumentet dhe investimet për vendosjen e sistemit integruar për menaxhim me mbeturinat.

## **Vetëdije te subjektet e involvuara dhe publiku i gjerë**

Mungon sistem i organizuar në komunikimin në mes MMJPH dhe ministrive tjera, komunat dhe subjektet tjera relevante në shoqërin për këmbim të informatave për menaxhim me mbeturinat, në raport të planeve, kërkesave dhe pasojave nga rregullimi i ri, si dhe për zgjerimin e informatave të përgjithshme në lidhje me problemet me mbeturinat.

Niveli i përgjithshëm i vetëdijes për mjedisin jetësor dhe për problemet me mbeturinën në Maqedoni është i ulët; gjegjësisht, njerëzit nuk janë të vetëdijëshëm për problemet të cilat rezultojnë nga menaxhim jo përkatës me mbeturinat dhe për efektet negative ndaj shëndetit të tyre dhe ndaj mjedisit jetësor dhe natyrës. Njerëzit nuk kanë vetëdije për përgjegjësin e tyre përkatëse dhe rolin si krijues të mbeturinës. Nga ana tjetër, qëndrimet në publik mundet që të manifestohen nëpër mes kundërshtimit të fuqishëm në çfardo ndryshime të praktikës egzistuese në menaxhim me mbeturinat; qëndrimet e këtilla mbështeten në friksimin dhe kujdesin real, si dhe në informacionin e pamjaftueshëm dhe mungesa e praktikës për qasje të publikut deri te informatat.

## **Çështje ekonomike**

Burimet në mjetet për mbulimin e harxhimeve dhe për finansimin për menaxhim me mbeturinat janë kryesisht kompenzimet direkte për transport dhe për mënjanimin e mbeturinës. Kompenzimet për shërbimet për menaxhim me mbeturinat i fakturon dhe drejtëpërdrejt i paguajnë ndërmarjet publike komunale, ata janë të themeluara në procedura të barabarta (paushal) të cilat dallohen në mes komunave, lartësia e kompenzimit është e vogël, kurse përqindja e mos paguesëve shpesh herë është shumë e lartë. Kompenzimet paushale për grumbullimin dhe për mënjanimin e mbeturinave komerciale dhe industriale i paguajnë ndërmarjet publike, kryesisht me tarifa të larta në krahasim me ato për mbeturinën e fortë komunale.

Këto kompenzime fakturohen dhe paguhen direkt nga ndërmarjet publike komunale si dhënës të shërbimeve, kurse jo nga komunat, kurse vendosja e këtill e parandalon pjesëmarrjen më të madhe të sektorit privat në aktivitetet për grumbullimin e mbeturinës.

Harxhimet reale për sigurimin e shërbimeve nuk mbulojnë tërësisht me pagimin, kurse rregullimi i sistemit nuk mundëson zbatim të principit “ndotësi paguan”. Gjendja financiare e ndërmarjeve publike bëhet plotësisht dhe si pasojë e rrugës së ekonomis.

Nuk egziston fond si burim i mjeteve në nivel shtetror ose komunal që të inicohen detyra të caktuara të ndërlydhura me investimet në infrastruktur të re; detyrat përgaditëse që kanë mundur të rezultojnë në investimet në infrastrukturën për menaxhim me mbeturinat ose në sanacion vatrave ekologjike zbatohen, kryesisht, me mjetet e donatorëve dhe me ndihmë tjetër ndërkombëtare financiare.

Taksat ekologjike të vërtetuara në Ligjin e mjedisit jetësor nuk janë të dedikuara dhe bëhen pjesë nga buxheti integral shtetror; kompenzimet e paguara mundet që të përdoren për realizimin e programeve për menaxhim me mbeturinat, por në konkurrenc me programet tjera për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

## **Rrjedha egzistuese të mbeturinave dhe praktikave në menaxhimin me mbeturinat**

Grumbullimi, transporti dhe deponimi janë metodat themelore për mënjanimin pothuajse në të gjitha fraksionet e mbeturinës. **Në tabelën 1** është dhënë pasqyr për sasis e mbeturinave të vlerësuara përafërsisht që krijohet brenda vitit, duke inkuadruar mbeturinën nga xehëtaria. Për sa i përket sasis së mbeturinës së krijuar komunale, mundet që të pritët rritje e sasisë së mbeturinës për 1,7% në vit, në vitet vijuese 10-12; ndryshimet në sasinë e mbeturinave nga prodhimi/shërbimi/bujqësia mvaren nga dinamika e zhvillimit ekonomik të shtetit.

**Tabela 1: Sasi të vlerësuara të mbeturinës që krijohet**

<b>Lloji i mbeturinës</b>	<b>Sasi e vlerësuar (t/në vit)</b>
Mbeturina komunale	420.000
Mbeturina komunale ( me pjesë përbërse të njajshme me ato të mbeturinës nga amvisria)	150.000
Mbeturina nga institucionet shëndetësore	1
Mbeturinat dhe mbetjet urbane	500.000
Mbeturina industriale e parrezikshme	2.120.000
Mbeturina industriale e rrezikshme	77.500
Mbeturina nga miniera	17.300.000
Mbeturina bujqësore nus-prodhimet e kafëshëve	4.900.000
Mbeturina bujqësore – nus prodhimet e bimëve	550.000
Gomat e vjetëra	5000
Vajrat e vjetëra minerale	8000
Automjete të vjetra	17.500
Akulumator të vjetër	3.500
Gjithësejt	III 26.000.000

### **Grumbullimi dhe transporti i mbeturinës**

Vetëm rreth 70% e banorëve i shfrytëzojnë shërbimet e sistemit të grumbullimit të mbeturinës komunale, që i kryejnë ndërmarjet publike. Pajisja për grumbullimin e mbeturinës dhe niveli i shërbimeve nuk është në pajtim me kërkesat rrjedhëse. Grumbullimi i fraksioneve joserperate të mbeturinës komunale dhe asaj industriale të parrezikshme, si dhe në fraksionet e mbeturinës së rrezikshme dhe të parrezikshme, është praktik e zakonëshme. Nuk egzistojnë grumbullues oficial të licensuar dhe transporter të mbeturinës së rrezikshme.

Mbeturinat metalike ballafaqojnë pjes të mëdha nga mbeturinat e grumbulluara për reciklim. Shkalla e grumbullimit të ndarë të fraksioneve të mbeturinave mundet që të reciklohen mvaret vetëm nga kushtet tregëtare; separohen vetëm ato lloje të mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme që munden që të shiten. Grumbullimi i ndarë, në pjes të madhe, e kryen sektori joformal.

Nuk egzistojnë sisteme formale për grumbullimin e mbeturinës dhe mbetjes urbane, si dhe për indet e larta shtazore të rrezikëshme nga thertoret dhe nga fermat blegëtorale.

Niveli i menaxhimit me mbeturinën e rrezikëshme dhe me mbeturinën medicinale të mbetur të parrezikshme në spitalet, kryesisht është i ulët.

### **Tretman, përpunim dhe reciklim**

Aktivitetet për përpunimin dhe reciklimin e mbeturinës komunale janë shumë të kufizuara dhe pa qasje të organizuar. Kryesisht, shfrytëzimi i shumë llojeve/pjesëve përbërse të materialeve që mund të reciklohen është financiarisht i papagueshëm në kushtet egzistuese. Me grumbullimin dhe reciklimin e materialeve me potencial për reciklimin, siç janë metalet, fletat, plastikat, akulumatorët automobilistik, vajrat e mbeturinave etj, meren, në pjes më të madhe, sektori joformal dhe kompanit private, në placet për mbeturina me ndikime potenciale negative për mjedisin jetësor dhe për shëndetin e banorëve.

Tregu për reciklimin e plastikës në Maqedoni është i pazhvilluar, veçanërisht për mbeturinat metalike . Egziston rrjet i zhvilluar i grumbulluesëve dhe/ose parapagues, si dhe tregu i fuqishëm stabil për ripërtirjen e mbeturinat metalike .

Pjesë e madhe nga indet bimore që prodhohet në bujqësi shfrytëzohet përsëri, në mënyr që është më i volitëshëm për mjedisin jetësor. Plehëri i fituar nga kafshëve të mëdha dhe të imta shfrytëzohet në

tërsi, për plehënimin e tokës. Kompostimi dhe kalëbja anaerobe e mbeturinës organike, kryesisht, nuk praktikohen ose nuk egzistojnë kapacitetet për atë dedikim.

Sasi të mëdhaja në mbeturinën e rrezikshme prodhohen në instalimet metalurgjike industriale dhe kryesisht skladohen në deponi të paregullta në rrethin e firmave. Pjesa më e madhe nga vajrat e rrezikshëm të mbeturinave, të krijuara në sektorin prodhues dhe në aktivitete tjera sot djegen si lënd djegëse.

Transformator për të cilët egziston dyshim se përmbajn vajëra me PHB, edhe pse në pjesë më të madhe të evidentuar, mundet ende të shfrytëzohen në sistemin e furnizimit me energji dhe se prodhohen në disa fabrika dhe prodhimtari. Por, nuk egzistojnë laboratorit lokale për zbatimin e analizave të nevojshme për burimet e mundëshme të PCB/PCT në Maqedoni.

### ***Mënjanimi i mbeturinës***

Instalimet egzistuese dhe kapacitetet për mënjanimin me mbeturinave janë të papërshtatëme, kurse praktika e menaxhimit me mbeturinat kontribuon drejt ndotjes së ajrit, në resurset e ujërave dhe tokës, si dhe drejt reziqeve për biodiversitetin, toka bujqësore dhe shëndeti i njerëzve. Pothuajse metoda e veçantë për mënjanimin e mbeturinës është deponimi i deponive; vetëm pjesë nga mbeturina e rrezikshme nga institucionet shëndetësore dhe mbeturinat e caktuara të lëngëshme të rrezikshme kallen, gjegjësisht djegen.

Pjesa e më e madhe nga ***mbeturina e fort komunale*** dhe mbeturina tjetër e grumbulluar pezullohet pa paratretman të deponive komunale; lloje të ndryshme të mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme, siç janë gomat e vjetra, akulumatorët e automobilave, komponentat e yndyrshëm automobilistik dhe mbeturinat tjera deponohen në deponi të “egra”. Deponit punojnë pa leje të punës, me një përjashtim, pa asnjë teknikë që zbatohen në deponit dhe monitorim të rregullt në raport të ndikimit ndaj mjedisit jetësor. Nuk egziston evidencë në mbeturinën e dorëzuar, kurse nuk kryhet as inspektion vizuel i karakteristikave të mbeturinave që duhet të deponohet. Deponimi i mbeturinës së kombinuar të rrezikshme dhe të parrezikshme dhe kallëja e mbeturinës komunale, mbeturina nga indi bimorë dhe plastika në hapsir të hapur, paraqesin reziqe më serioze dhe pasoja për mjedisin jetësor. Një e treta nga 51 deponit egzistuese kategorizohen në klasën me rezik më të lartë sipas vlerësimit të rezikut të tyre nga aspekti i mjedisit jetësor dhe mbyllja dhe sanimi i tyre është prioritarë.

***Mbeturina e rrezikshme*** që e krijojnë kapacitetet maqedonase të minierave dhe kapacitetet prodhuese industriale ballafaqohet me probleme serioze: deponimet për mbeturinat nga proceset e caktuara janë të lëshuara, egzistojnë pak ose nuk egzistojnë informata për historinë e deponive të mbeturinave dhe për pasojat ndaj mjedisit jetësor, trashigimia juridike në raport të të njëjtive është e paqartë. 16 sfera më të mëdhaja industriale dhe deponit për mbeturinat janë të identifikuar si “vatara ekologjike” ndaj bazës në ndikimet e vërtetuara ndaj mjedisit jetësor dhe potenciali i lartë i rezikut.

Menaxhimi aktual dhe mënjanimi i indeve shtazore nga thertoret dhe nga feramat e blegëtorëve përbëhet nga mbulimi i gropës së fermave ose hudhja e deponive fshatare për mbeturinat. Në të dy situatat, kjo kryhet me pjesëmarje tepër të vogël ose pa pjesëmarje dhe mbikqyrës nga ana e veterinarëve të autorizuar, kryesisht në mënyr të pa kulturuar dhe larg nga standardet e nevojshme sanitare.

Mënjanimi i paketimit i kontaminuar me pesticide dhe mbeturina tjera karakteristike agrokimike deponohen me djegjen në hapsir të hapur, me hudhjen së bashku me mbeturinën komunale; mbetjet nga tretjet pesticide thjesht hudhen në mjedis me ujë.

## ASPEKTET STRATEGJIKE DHE QËLLIMET E MENAXHIMIT ME MBETURINAT

### Çështjet strategjike

Zhvillimi në Republikën e Maqedonisë drejt sistemit të qëndrueshëm për menaxhim me mbeturinat do të kërkoj miratim të mëtutjeshëm të ligjslacionit shtëpiak me atë të UE, ndryshime në organizatën institucionale dhe ndryshime të mëdhaja në praktikën e përgjithshme në menaxhimin me mbeturinat. Ndryshime të suksesëshme në menaxhimin me mbeturinat, duke pasur para sysh shoqërit egzistuese në mjedisin jetësor dhe me nevojën e fuqisë së saj legjislativë dhe regullative; por, sukcesi përfundimtar në praktik mundet që të arihet veçanërisht nëse të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë e kuptojnë realizimin në mes menaxhimit të pargullt dhe efektet negative ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj shëndetit të njerëzve, nëse bëhen të vetëdijshëm për përgjegjësit e tyre, obligimet dhe detyrat në sferën e menaxhimit me mbeturinat edhe nëse motivohen me masa organizative dhe më shumë me masa ekonomike.

Objektet e reja infrastrukturore të reja të vendosura patjetër duhet të sigurojnë bazë teknike për funksionimin e menaxhimit me mbeturinat, të sigurojnë zhgjerime të mëtutjeshme teknologjike dhe hapsinore dhe sa është e mundur të mbajnë shkallë të caktuar të fleksibilitetit funksional.

Finansimi i vendosjes së sistemit të ri për menaxhim me mbeturinat, si dhe në sanacimin e ngarkimeve të mjedisit jetësor, patjetër duhet që të shqyrtohet me kujdes. Mbulimi i harxhimeve për investime kapitale dhe në harxhimet operative është faktor i rëndësishëm për shtetin me 2 milionë banorë dhe me rrjedha të vogëla të mbeturinave, ku është veçanërisht prezent efekti i ekonomisë së madhe, pa mar para sysh se a bëhet fjalë për shfrytëzimin, tretmanin ose deponimin e mbeturinës. Finansimi i vendosjes së sistemit të ri për menaxhim me mbeturinat, si dhe sanimi i mbingarkimit të mjedisit jetësor, duhet të shqyrtohet me kujdes. Mbulimi i shpenzimeve për investimet kapitale dhe për shpenzimet operative është faktor i rëndësishëm për një vend me 2 milion banorë dhe me lloje të pakta të mbeturinave, ku është veçanërisht prezent efekti i ekonomisë së madhësisë, pamarr parasysh se a bëhet fjalë për shfrytëzimin, tretmanin ose për deponimin e mbeturinave.

Probleme tjera të veçanta në shtetin e menaxhimit me mbeturinat janë pothuajse tërësisht në mungesë të sektorit privat, tregu i kufizuar lokal për materiale dhe prodhime të fituara nga mbeturinat, mungesa e motivacionit ekonomik për investimin në kapacitetet për shfrytëzimin e energjisë nga mbeturinat. Standardi i ulët jetësor i qytetarëve është mesatarisht i ulët dhe gjendja financiare e sektorit prodhues paraqesin pengesa plotësuese për qasje më të shpejtë drejt zbatimit të tërësisht të principit “ndotësi paguan”.

Të nevojshme janë mjetet e rëndësishme për mbylljen e nevojshme dhe/ose sanacimi i deponive të mbeturinave komunale ose industriale të vjetra ose të lëna pas dore, veçanërisht në vatrat ekologjike. Por, kryesisht, nuk ka mjete sistematike të nevojshme për (ko)finansimin e sanacimit të vatrave të caktuara ekologjike, përshkak të prodhimit të pandërprer dhe trashigimisë së paqartë juridike.

Qëndrimet publike drejt problemeve me menaxhimin me mbeturinat mundet të manifestohen si kundërshtim i fuqishëm i ndryshimeve të nevojshme në sjelljen, sipas realizimit real dhe kujdesit, për shkak të mungesës së informatave dhe kuptimi ose për shkak të mos besimit drejt vendimit të sistemit të ri nga shkaqet historike. Realizimi themelor strategjik në raport me qëndrimet e publikut drejt menaxhimit do të jetë ndryshim cilësor në kuptim të problemit me mbeturinën në tërësi.

### Qëllimet e përgjithshme strategjike dhe të veçanta

Qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta të strategjisë për menaxhim me mbeturinat e shprehin **politikën nacionale** të përgjithshme në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe paraqesin bazë për përgaditjen dhe për zbatimin e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturinat, i cili do të jetë efikas në marrëdhënie me harxhimet, gjegjësisht mjetet për vënien në kontroll në të gjitha rrjedhat të mbeturinës

së krijuar, me qëllim që të zvogëlohen sasis dhe potenciali i rizikut të mbeturinës së krijuar të ndahen vlerat materiale dhe energjetike nga mbeturina, të sigurohet mënjanimi i mbeturinës në mënyr të volitshme për mjedisin jetësor, të parandalohet formimi i ngarkimeve të reja të mjedisit jetësor që duhet të zgjidhin gjeneratat e ardhshme dhe të vërtetohen mënyra për sanimin e ngarkimeve të përhershme në ndikime negative ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj shëndetit të banorëve.

Qëllimet strategjike duhet të miratohen në mes të gjitha segmenteve në shoqëri dhe në princip me kërkesat e mjedisit ekonomik në bashkëpunim, gjegjësisht shtetet e UE. Qëllimet e miratuara të përgjithshme dhe të veçanta të menaxhimit me mbeturinat patjetër duhet të ndërtohen në planet zhvillimore të nivelit nacional dhe lokal dhe në planet e sektoreve prodhuese dhe shërbyese me pronësi dominante private.

Qëllimet e plota të përgjithshme dhe të veçanta strategjike patjetër duhet ti shprehin obligimet e shoqëris së plotë maqedonase në lidhje me ndryshimet e rëndësishme, njëherit të rëndësishme dhe të lidhura ngusht në mes veti me menaxhimin me mbeturinat:

miratimi **i politikës dhe legjislacionit** në sferën e menaxhimit me mbeturinat në lidhje me pajtimin politik në shoqëri dhe kërkesat e mjedisit ekonomik për bashkëpunim;

vendosja e **strukturës efektive institucionale dhe organizative** në të gjitha fazat në realizimin e sitemit të ri integrues për menaxhim me mbeturinat: planifikimi, liçensimi i lejeve, finansimi, puna dhe zbatimi;

përforcimi i **resurseve njerëzore dhe kapaciteteve** në sektorin publik dhe privat inkuadron angazhimin gjatë vendosjes së sitemit për menaxhim me mbeturinat, si dhe nxitja dhe angazhimi i dituris, ekspertiza teknike dhe potenciali ekonomik që egzistojnë në vend;

sjellja e **resurseve financiare** stabile dhe **mekanizmat ekonomik** përkatës për sigurimin e mbulimit të tërsishëm të harxhimeve për mbajtjen e sitemit integrues për menaxhim me mbeturinat në pajtim me principin “ndotësi paguan” dhe me efektet maksimale në lidhje me investimet dhe me aktivitetet e punës;

ngritja e **vetëdijes së publikut dhe vetëdija e të gjitha subjekteve të involvuara** në shoqëri nga aspekti i kuptimit të roleve të tyre, përgjegjësi dhe obligime në procesin e menaxhimit me mbeturinat dhe në mbrojtjen e mjedisit jetësor me qëllim që të njëjtat të pranojnë ndryshime të rëndësishme në praktikën e menaxhimit me mbeturinat, nga grumbullimi deri te deponimi.

Vendosja e **sistemit për grumbullimin e të dhënave/informatave** për burimet, natyrën, sasia dhe fati i llojeve të mbeturinave, si dhe për kapacitetet për ripërtirjen e materialeve/energjis dhe për deponimin e mbeturinave dhe sigurimi i inkuadrimin të nevojshëm në publik deri te i njëjti;

vendosja e **sistemit mekanik bashkëkohor për menaxhim me mbeturinat** i cili mer para sysh vendime të ndryshme teknike në shikim të mënjanimin të mbeturinave, zvogëlimi i potencialit të tijë që është në rizik dhe zvogëlimi i tijë i burimit, shfrytëzimi i materialeve/energjis dhe përpunimi i mbeturinës dhe deponimi i sigurt i mbetjeve të stabilizuara në pajtim me “opsioni më i mirë realizues nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor” me qëllim që të ruhen resurset e reja të paripërtitura dhe ti pakësojn në minimum emisionet dhe efektet negative nga procesi i tretmanit/deponimit të mbeturinës ndaj mjedisit jetësor dhe mjedisit natyror, si dhe ndaj shëndetit të banorëve;

zbatimi i **teknikave efikase dhe të volitëshme** për menaxhim me rrjedhat separuese të mbeturinave nëpër mes pjesëmarrjes të sektorit privat me qëllim që të arihet hap nga 100% e grumbullimit të mbeturinave dhe nivel optimal të shfrytëzimit të materialeve/energjis nga mbeturinat;

vendosja e **deponive për mbeturinën e rrezikëshme dhe të parrezikëshme** dhe kapacitete tjera për depinimin e mbeturinave në pajtim me standardet bashkëkohore me qëllim që ta parandalohet paraqitja e ngarkimeve të reja të mjedisit jetësor;

***Mbyllje graduale dhe/ose sanimi i deponive egzistuese komunale për mbeturinat dhe/ose vatrat industriale ekologjike*** sipas inventarit të ngarkimeve në mjedisin jetësor dhe kritere përkatëse të cilat veçanërisht i kanë para sysh efektet negative dhe reziqet për mjedisin jetësor, shfrytëzimi i ardhshëm i hapsirës fizike, harxhimet për sanim dhe pranimi i popullësis.

### **Principet themelore në menaxhimin me mbeturinat**

Zbatimi i ***principeve themelore në menaxhimin me mbeturinat***, d.t.th kierarki në menaxhimin me mbeturinat, principi i afërsis, principi i vetëmbajtjes, përgjegjësi e prodhuesit, principi ndotësi paguan, principi i kujdesëshëm, do ta prezentojë bazën e politikës maqedonase për përmisimin e gjendjes së tashme në sferën e menaxhimit me mbeturinat, nga njëra anë dhe për zhvillimin e shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm në resurset natyrore në të ardhmen, nga ana tjetër.

Menaxhimi me mbeturinat, si pjesë përbërse e ***menaxhimit të qëndrueshëm me resurset natyrore***, së bashku me politikën e prodhimit integruar dhe me politikën për parandalim integral dhe kontrollimi i ndotjes çojnë deri në integrim proaktiv të problemeve ekologjike të lidhura me resurset në politikën tjetra në shoqërinë maqedonase.

Proceset në shfrytëzimin e sërishëm, reciklimi i ripërtirjes së materialeve/energjis nga fraksionet e mbeturinës patjetër duhet të nxiten që të përmisohet shfrytëzueshmëria e resurseve dhe për deponimin do të lejohen vetëm fraksionet e panevojshme. Menaxhimi i rregullt me mbeturinën biondërtuese prezent në mbeturinën komunale dhe në mbeturinën nga pastrimi i ujërave të ndotura, në mbeturinën e bujqësisë dhe në mbeturinën nga industria ushqimore dhe industria për pije mundet të kontribuojnë rëndësi në zvogëlimin e emisioneve të gazërave të qelqëta. Qasje e këtill don të thotë se çdo pjesë e mbeturinës shihet jo vetëm si burim i ndotjes, por dhe si resurs potencial që mund të shfrytëzohet, kurse kjo do të rezultojë nga ndarja e ritjes ekonomike dhe sasitë e mbeturinës së krijuar.

Por, politika maqedonase për menaxhim me mbeturinat patjetër duhet të ndërtojë dhe disa principe dhe obligime plotësuese, veçanërisht ato të lidhura me distinkcionin e qartë dhe menaxhimi me mbeturinën e rrezikëshme dhe të parrezikëshme, me nxitjen e zbatimit prioritar të instrumenteve ekonomike para instrumenteve ligjore dhe me vendosjen e sistemit, për mbikqyrje/kontroll të praktikave të mbeturinave në territorin shtetëror dhe kur mbeturina e rrezikëshme i kalon kufijtë shtetëror, pa mar para sysh në menaxhimin planifikues.

### **Karakteristikat strategjike në skemën e përgjithëshme të menaxhimit me mbeturinat**

#### ***Principet themelore për zhvillim të skemës maqedonase për menaxhim me mbeturinat***

Zbatimi i principeve themelore europiane paraqet kornizë themelore për zhvillim gradual të skemës gjenerale për menaxhim me mbeturinat nga burimet e krijimit të mbeturinës deri te menjanimi/deponimi i mbetjeve, duke marur para sysh inkuadrimitin e masave të caktuara kohore për menaxhim dhe ngarkesa të përhershme të mjedisit jetësor të sfiduara me menaxhimin jopërkates me mbeturinat në të ardhmen.

Zhvillimi i skemës për menaxhim me mbeturinat nëpërmes zbatimit të principeve themelore në menaxhim do të fokusohet, kryesisht, në çështjet të cilat janë gjeneralisht të zbatuara në menaxhimin me mbeturinat, kurse paralelisht do të shpreh karakteristikat e Republikës së Maqedonisë: zgjidhja e problemeve me mbeturinat në vet burimin, grumbullimi i ndarë i llojeve të mbeturinës, shfrytëzimi i mbeturinës si këmbim i resurseve natyrore, rrjeti racional i kapaciteteve për tretman dhe për deponim, racionalitet në menaxhimin me hapsirën dhe ruajtja e trashigimis natyrore dhe kulturore, deponimi i

mbetjeve stabilizuese nga mbeturina me vullum të vogël dhe sanim të lokaliteteve ekologjike kontaminuese, gjegjësisht vatra ekologjike.

Principi i **zgjidhjes së problemeve të burimit në krijimin e tyre** d.t.th përgjegjësi e drejtëpërdrejtëshme dhe e përbashkët dhe poseduesi/krijuesi i mbeturinës gjatë tërë jetës së tyre shekullore, për kontrollin dhe për grumbullimin e mbeturinave të llojeve individuale, për regjistrimin e sasive të tyre dhe karakteristikave dhe për sigurimin e aktiviteteve në tretman dhe mënjanim të mbeturinës të cilat janë në pajtim me dispozitat, të pranueshme nga aspekti ekonomik. Përgjegjësi plotësuese u jepet prodhuesëve- prodhimin, ta shfrytëzojnë energjin nga proceset nga rrjedhat e mbeturinave, të organizojnë tretman/përpunim të prodhimeve me afat të skaduar të nevojës dhe ti ulin në minimum sasit dhe potencialin e rrezikut të mbeturinës që do të deponohen.

Njëra nga prioritetet themelore është që të vendoset **sistem i grumbullimit të ndarë të mbeturinës** në pajtim me karakteristikat e rrezikut, sipas pikës së tyre të burimit ose burim i dispensuar të krijimit dhe sipas qëllimit për menaxhim të mëtutjeshëm i cili do të jetë i pranuar nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe nga aspekti ekonomik. Dituri të veçantë prioritare duhet që ti përkushtohet në separacionin e mbeturinave të rrezikëshme nga rrjedhat e parrezikëshme në vet burimin dhe në mënjanimin e caktuar të këtyre llojeve. Njëra nga prioritetet themelore është dhe inkuadrimi i mbeturinës komunale, duke inkuadruar mbeturinën nga veprimtarit e vogëla shërbyese (mbeturina komerciale) në sistemin organizues të grumbullimit dhe mënjanimi, për mbeturin të përzier të tepruar.

Rrjeti për grumbullimin me qëllim që të shfrytëzohen komponentat e vlefshme të **prodhimeve me afat të skaduar** i cili është i themeluar në principin “përgjegjësi e prodhuesit”, do të organizohet nga ana e prodhuesëve, distributorëve dhe shitësëve të prodhimeve në shitje me pakic dhe nga ndërmarjet specializuese shërbyese, kurse efekte të volitëshme dhe të shpejta mundet që të priten në raport në ripërtirjen e materialeve/energjis nga mbeturina, sasit e zvogëluara të mbeturinës në deponit dhe punësime me investime relevante të ulta dhe harxhime operative.

Duke marë para sysh atë se mbeturina mundet që të paraqet lëndën e parë sekundare, menaxhim me mbeturinat d.t.th shfrytëzim optimal i resurseve potenciale të **mbeturinës si këmbim për resurset natyrore të ripërtitura**, duke mar para sysh aspektet ekonomike, ekologjike dhe sociale. Zhvillimi i këtill mundet që të hap opzione për reciklimin e fraksioneve të ndara grumbulluese të mbeturinës në vet burimin, si dhe për prodhimin e biogazit dhe materiale nga toka nga burimet industriale, bujqësore, por edhe nga amvisrit. Për vende me resurse të kufizuara natyrore energjetike, resurse të ripërtitura energjetike siç janë druri i mbeturinave, nus-prodhimet shtazore, plehëri i ahrit, milta nga uji i ndotur dhe llojet tjera të biomasës mundet që të bëhen krahasuese janë më të rëndësishme materialet e lëndëve të para për prodhimin e gasovitëve, lëndë djegëse të buta dhe të forta nga mbeturina.

Vendosja e **rrjetit nacional të kapaciteteve për tretman dhe për mënjanim të mbeturinës**, me leje siguruese për kryerjen e aktiviteteve të caktuara në menaxhimin me mbeturinat, është njëra nga detyrat prioritare dhe të pashmangëshme në Maqedoni në ruajtjen dhe përmisimin e cilësis së mjedisit jetësor dhe në sigurimin e bazës për zhvillimin ekonomik të tijë të ardhëshëm. Si prioritet i parë, do të vendoset infrastruktur e re dhe e përmisuar për menaxhim me mbeturinat për grumbullimin dhe për mënjanimin e **mbeturinës komunale të fortë** në **nivel racional** me përfshirje mbi 200.00 banor, me qëllim që të arihen praktet përkatëse ekonomike për investimin dhe për punën e kapaciteteve për menaxhim me mbeturinën komunale dhe çmime të pranueshme për shërbimet e kryera.

Vendosja e rrjetit, në **kapacitetet infrastrukture të reja, përmisuese ose sanuese për menaxhim me mbeturinat** ka prioritet të lart me qëllim që të sigurohet trajtim/deponim i sigurt i mbeturinës së rrezikëshme nga industria, nga institucionet shëndetësore dhe nga fermat e blegëtorëve dhe thertoret, si dhe të shfrytëzohet pjesë nga vlera matariale/energjetike e fraksioneve të mbeturinave kur është ajo e pranueshme nga pika ekonomike.

Rrjeti i kapaciteteve për grumbullimin, sklاديمin dhe paratretmanin për **rrjedha të veçanta të mbeturinave** do të planifikohet ndaj bazës së rezultateve nga studimet fisilibite, ku do të meren para sysh treqet qasëse për materiale dhe prodhime me afat të skaduar të përdorimit që mund të reciklojnë

ose për pjesë nga fraksionet e tyre, në vendin tonë ose në ndonjërin nga vendet fqinje. Rrjedhat e veçanta të mbeturinave, kryesisht, nga ndërmarjet e vogla private ndaj bazës në lejet administrative për aktivitete të veçanta në menaxhimin me mbeturinat.

Teritori i Republikës së Maqedonis paraqet vlerë nacionale dhe bazë për zhvillim ekonomik dhe social në vendin; ajo kërkon **shfrytëzim nacional dhe të sigurt nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor**, i dedikuar për aktivitete bujqësore, prodhuese, si dhe për vendbanime, dhe shfrytësim racional dhe mbrojtja e resurseve të ujërave, tokës, trashigimia kulturore dhe natyrore. Do të sillen plane për menaxhim me mbeturinat dhe për kontrollin e emisioneve në sferat të dedikuara për aktivitete prodhuese, në mënjanim të pranueshëm nga vendbanimet.

Deponimi paraqet opsionin më të vogël të dëshirueshëm në kierarkin në menaxhimin me mbeturinat, por është opsion i patejkaluar për mënjanimin e pjesëve të papërdorura në mbeturinën e krijuar ose për mbetjet nga mbeturina pas proceseve të ndryshme në përpunimin, reciklimin dhe tretmanin. Mbeturina e mbetur mundet që të mënjanohet në **deponitë** vetëm si **material stabilizues joreaktiv** ose të mbështetet në paratretman para deponimit, me qëllim që të stabilizohet mbeturina, që të pakësohet në minimum volumi dhe të zvogëlohet lëvizshmëria në substancat e rrezikëshme, si dhe emisionet e tyre nëpërmes ujit të kulluar nga objektet e deponive.

**Sanimi i lokalitetit të kontaminuar- vatrat ekologjike**, d.t.th lokalitete industriale të kontaminuara dhe deponi jostandarde komunale dhe industriale munden kryesisht që të kontribuojnë drejt zvogëlimit të ndikimit negativ ndaj shëndetit të njerzëve, toka bujqësore, biodiversiteti dhe ndaj mjedisit natyror dhe përfundimisht ndaj cilësisë së prodhimeve ushqimore në tregjet maqedonase dhe të tjerat. Prioritetet për mbylljen dhe/ose sanimi i ngarkimeve të këtitilla në mjedisin jetësor mvaret nga reziqet e vërtetuar /ose nga ndikimet direkte ndaj ujit dhe ndaj tokës dhe ndaj vendbanimeve më të afërta. Do të vendoset tërsisht sistem i ri i përgjegjësisë për gjendjen e mjedisit jetësor, i cili do të inkuadron mekanizma juridik, instucional dhe financiar me qëllim që të realizohen problemet në të ardhmen të lidhura me sanimin e vatrave ekologjike.

### ***Karakteristikat kryesore në skemën e përgjithëshme për menaxhim me mbeturinat***

Skema e përgjithëshme për menaxhim me mbeturinat paraqet pasqyrë në masat themelore teknologjike-teknike, në mes vete të lidhura dhe vendosja e principeve themelore në zhvillim shumëfazësh të sistemit teknik për menaxhim me mbeturinat në Maqedoni; kompleksi i masave teknologjike dhe teknike do të shërbejnë si mjete efikase për ritjen e procedurës për grumbullimin e mbeturinave, zvogëlimi i sasisë dhe në potencialin e rrezikut në mbeturinën në vet burimin, ritje e shkallës në shfrytëzueshmëri të materiale/energjisë së mbeturinave, për ndërtimin e deponive të përherëshme të reja dhe ripërtirjen për mbetjen nga mbeturina e stabilizuar e rrezikëshme dhe e parrezikëshme sipas standardeve bashkëkohore dhe përfundimisht për sanimin e rajoneve të kontaminuara.

**Skema e përgjithëshme për menaxhim me mbeturinën komunale** d.t.th vendime teknike paralele dhe të njëpasnjëshme të cilat i përfshijnë masat e domozdoshme nga grumbullimi, skladimi, shfrytëzimi i fraksioneve të nevojshme të mbeturinave, nëpërmes tretmanit të ndryshëm, deri te deponimi i mbetjeve stabilizuese, joreaktive nga mbeturina.

**Zvogëlimi** i sasisë së mbeturinës komunale në burimin mundet që të arihet shpejt dhe me çmim të ulët, nëpër mes nxitjes së shfrytëzimit afatgjatë në paketim primar, nëpër mes kompostimit të biombeturinës nga amvisrit në kopshtet dhe nëpërmes kompostimit në mbeturinën e rrezikëshme nga sipërfaqet publike dhe private të gjelbërta .

Zvoglimi i suksesshëm i mbetjeve të rrezikshme të mbeturinave komunale varet, kryesisht, nga zbatimi i një numri më të vogël të mbetjeve të rrezikshme në prodhim dhe në paketim, të disponueshme për tregun.

Në pikëpamje teknike, *masat kryesore për mbledhjen* e mbeturinave të përziara komunale mblidhet me ndihmën e enëve përkatëse për mbledhje, stacionet e mbingarkimit për mbeturina dhe automjetet për mbledhje, si dhe përmes sistemit të organizuar për mbledhjen e mbeturinave masive nga trotoret dhe për materiale të caktuara për reciklim me zbatimin e opcionit „sistemi i sjelljes“ për pranimin e fraksioneve të mbeturinave në kapacitete të reja, përkatësisht në „trualle për reciklim“.

Mbledhja e prodhimeve të caktuara me afat të skaduar të përdorimit të cilat mund të shfrytëzohen, siç janë paketimi sekondar dhe terciar, gomat e vjetra, automjetet e vjetruara mund të organizohen me çmim të ulët të tregut, qendrat për skladium dhe distribuim, si dhe përmes rrjetit mbledhës të specializuar, kryesisht sipas parimit përgjegjësia e prodhuesit.

Mbledhja e ndarë e fraksioneve të mbeturinave komunale do të realizohet me largimin e caktuar të komunave me mbi 50.000 banorë, përmes organizimit të mbledhjes së mbeturinave masive nga trotoret, shpërndarjen në „ishujt mbledhës“ në vendbanimet ose „trualle për reciklim“ të cilat do ti pranojnë mbetjet e caktuara të cilat mund të reciklohen.

Repartet për tretman mekaniko-biologjik (TMB) si duket prodhojnë sasi optimale të fraksioneve të mbeturinave të cilat mund të shfrytëzohen si *zëvendësim i resurseve natyrore*: derivatit sekondar të repartetve për prodhimin e energjisë nga mbeturinat, fraksione të ndryshme të metalit për proceset e reciklimit dhe mbetjeve nga fraksionet më të rënda të dedikuara për tretman biologjik-anaerob ku prodhohet biogasi dhe që shfrytëzohet për energji dhe nxehtësi. Mbetjet e stabilizuara nga proceset e TMB mund të deponohen si tokë punuese e përgatitur në mënyrë artificiale për aktivitete afatgjate të sanimit të sipërfaqeve të deponive industriale dhe të minierave me ndotje të lartë.

Përtëritja, reciklimi dhe llojet e tjera të *përpunimit të prodhimeve me afat të skaduar të përdorimit* mund të zbatohen në nivele të ndryshme teknologjike, në mvarshmëri nga karakteristikat e veçanta të produkteve, kapacitetet ekzistuese për përtëritje, reciklim dhe largim/deponim, dhe madhësisë ekonomike. Fraksionet e përtëritura nga prodhimet me afat të skaduar të përdorimit mund të kyçen në procese të ndryshme të reciklimit dhe largimit /deponimit, të cilat do të jenë të disponueshme në Maqedoni dhe në vendet e tjera.

*Rrjeti i deponive rajonale për mbeturina komunale* të cilat ndërtohen, përgatiten dhe punojnë në pajtim me standardet e UE-së për deponitë e mbeturinave do të përshtaten me rajonet e formuara për menaxhim me mbeturinat, si asociacione të obligueshme të komunave për zgjidhje të përbashkët të problemeve me mbeturinat komunale dhe mbeturinat e tjera të parrezikshme, pranë madhësisë optimale ekonomike. Zgjidhjet konceptuale për ndërtimin dhe punën e kapaciteteve të deponive të cilat posedojnë leje ekologjike të integruara janë themeluar në rekonstruimin e mundshëm të deponive ekzistuese me rrezik të mesëm ose të ulët për mjedisin jetësor, me qëllim që të sigurohet shmangia me kohë e mbeturinave dhe ndërtimi i deponive të reja në lokacione të reja ose me rekonstruimin e deponive ekzistuese me rrezik të ulët.

Midis *kapaciteteve për tretman të mbeturinave*, repartet për tretman mekanik-biologjik (TMB) për mbeturinat komunale, repartet për shfrytëzimin e mbeturinave për energji dhe repartet për prodhim/shfrytëzim të biogazit mund të luajnë rol të rëndësishëm në rrugë drejt realizimit të menaxhimit të qëndrueshëm me mbeturinat komunale në fazën e dytë të zhvillimit.

Deponitë komunale të cilat paraqesin rrezik të lartë për mjedisin jetësor do të mbyllen, me zbatimin e *masave teknike sanuese* me qëllim që të zbuten ndikimet ndaj mjedisit jetësor.

Koncepti teknik i *menaxhimit me mbeturinat medicinale* themelohet me ndarje të rreptë të fraksioneve të mbeturinave sipas shkallëve të ndryshme të rrezikshmërisë dhe sipas vlerës kalorike. Largimi mund të

realizohet nga kapaciteti qendror me efikasitet të lartë për insenerim (djegje) ose nga më tepër kapacitete për dezinfektim, si dhe me deponimin e mbetjeve.

**Mbeturinat dhe mbetjet urbane** mund të shfrytëzohet për paratretman në të njejtën degë teknike, si material i lëndës së parë apo si aditiv, fraksionet e djegëshme mund të shfrytëzohen për derivate sekundare; mbetjet e pashfrytëzuara do të definoohen në mono-deponi. Azbesti, si fraksion i rrezikshëm i mbeturinave urbane dhe mbetjeve urbane, kërkon teknika të veçanta për mbledhje, përdorim dhe deponim.

Zhvillimi i **menaxhimit me mbeturinat e rrezikshme dhe të parrezikshme industriale** është rreptë i lidhur me riorganizimin e ndërmarrjeve prodhuese, metalurgjike, termoenergjetike dhe xehtare të cilat përgjigjen për mbeturinat e tyre. Rezultatet e pritura nga riorganizimi i industrisë, sidomos në procesin e adaptimit me direktivat për parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes, janë efikase **masat për arritjen e sasisë minimale të mbeturinave në burimin e tyre**, d.m.th. për shfrytëzim më efikas të materialit të lëndës së parë dhe të energjisë, reciklim më intenziv intern ose të jashtëm, të llojeve të materialit nga prodhimi shfrytëzimit të substancave më pak të rrezikshme në prodhimin e produkteve, neutralizimi i substancave të rrezikshme në mbeturina para deponimit të tyre dhe mënjanimi/deponimi rreptësisht e ndarë i mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme.

Krahas zbatimit të masave efikase teknike për zvoglimin e sasisë dhe potencialit të rrezikshmërisë së mbeturinave nga industria dhe nga termo-centralet, do të zbatohet **rikonstruimi dhe sanimi i deponive** për zgjyrën dhe hirin e rrezikshëm dhe të parrezikshëm sipas standardeve bashkëkohore për deponimin e mbeturinave.

Për **krrijuesit më të vegjël të mbeturinave të rrezikshme** do të vëhet sistem përkatës për menaxhim, i cili do të përbëhet, kryesisht, nga depot për mbledhje dhe skladim dhe nga kapaciteti qendror për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme; për fraksione të caktuara të mbeturinave të rrezikshme, opcioni real mund të jetë insenerimi dhe/ose ko-insenerimi, ndërsa mbeturina të caktuara, si PHB, mund të eksportohen për tretman përkatës.

Koncepti për menaxhim me **mbeturinat e rrezikshme nga proceset e minierave** do të kryhet me ndihmën e qasjes strategjike dhe me drejtime të ndërlidhura me rregullativën e xehtarisë dhe në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë dhe të ndikimit ndaj mjedisit jetësor.

**Menaxhimi adekuat me nus-prodhimet bujqësore** dhe nga veprimtaritë e tjera të ngjajshme prodhuese, siç janë plehrat, indet shtazore dhe indet e llojllojshme bimore, është e lidhur ngushtë me zbatimin e „praktikës së mirë bujqësore“ dhe me shfrytëzimin e nus-prodhimeve të këtyra si burime të ripërtëritura të energjisë. Prioriteti i posaçëm do të kushtohet strukturës së zbatueshme ekonomike për mbledhjen e ndarë të indeve shtazore të cilat i përkasin klaseve të ndryshme të rrezikut dhe do të formohet rrjet përkatës i kapaciteteve për tretman dhe për deponim, sidomos me vendosjen e kapaciteteve për indet shtazore me rrezikshmëri të lartë (mbeturinat e rrezikshme).

Mbledhja e drejtë, përdorimi dhe mënjanimi/deponimi i mbetjeve toksike agrokimike (insekticideve, fungicideve) dhe paketimi i kontaminuar do të organizohet përmes sistemit të kthimit të organizuar nga sektori distributiv, tregtar dhe prodhues.

Menaxhimi kontinuitiv i parregullt me mbeturinat e rrezikshme nga industria metalurgjike dhe kimike dhe nga termo-centralet rezultoi në **deponitë dhe lokalitetet e kontaminuara industriale**. Me zbatimin e kretereve për cilësitë e rrezikshme të mbeturinave, sferat e kontaminuara klasohen si vatra ekologjike, ndërsa me zbatimin e **kritereve** për kushtet lokale hidro-gjeologjike dhe për **kontaminimin e përcaktuar ose potencial** të tokës punuese dhe ujit, sferat e kontaminuara mund të rangohen si vatra ekologjike me rrezikshmëri të lartë dhe me rrezikshmëri të ulët. Do të realizohen proekte për sanimin e vatrave ekologjike me rrezikshmëri të lartë edhe për ata për të cilët mund të mobilizojnë mjete; zgjidhjet teknike dhe teknologjike për sanim do të përzgjidhen nga metodat e

shumta teknike të disponueshme dhe do të adaptohen vendimeve për çdo vatër të caktuar ekologjike dhe drejt kërkesave të veçanta në mjedis lokal.

## **MASAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR MENAXHIM ME MBETURINAT**

Vendosja e rrjetit funksional për rrjet të kapaciteteve për mbledhje, tretman dhe deponim është në masë më të madhe e determinuar nga dinamika e investimit në kapacitete për menaxhim me mbeturinat, me masat ekonomike dhe masa të tjera që stimulojnë investime, si dhe me masa me të cilat do të garantohet mbulimi i plotë i shpenzimeve për punën e gjithë sektorit për menaxhim me mbeturinat në pajtim me parimin „ndotësi paguan“. Por, dinamika e investimit do të balansohet me zhvillim ekonomik të vendit dhe me standardin jetësor të banorëve, nga njëra anë edhe me shpenzimet për skenaret e pavolitshme dhe me pasojat afatgjate të ndërlidhura midis tyre për mjedis jetësor dhe për ekonominë përdoruese nuk zgjidhen problemet kryesore në sferën e menaxhimit të mbeturinave.

Zvoglimi i suksesshëm i mbetjeve të rrezikshme të mbeturinave komunale varet, kryesisht, nga zbatimi i një numri më të vogël të mbetjeve të rrezikshme në prodhim dhe në paketim, të disponueshme për tregun.

Në pikëpamje teknike, *masat kryesore për mbledhjen* e mbeturinave të përziara komunale mbledhet me ndihmën e enëve përkatëse për mbledhje, stacionet e mbingarkimit për mbeturina dhe automjetet për mbledhje, si dhe përmes sistemit të organizuar për mbledhjen e mbeturinave masive nga trotoret dhe për materiale të caktuara për reciklim me zbatimin e opcionit „sistemi i sjelljes“ për pranimin e fraksioneve të mbeturinave në kapacitete të reja, përkatësisht në „trualle për reciklim“.

Mbledhja e prodhimeve të caktuara me afat të skaduar të përdorimit të cilat mund të shfrytëzohen, siç janë paketimi sekondar dhe terciar, gomat e vjetra, automjetet e vjetruara mund të organizohen me çmim të ulët të tregut, qendrat për skludim dhe distribuim, si dhe përmes rrjetit mbledhës të specializuar, kryesisht sipas parimit përgjegjësia e prodhuesit.

Mbledhja e ndarë e fraksioneve të mbeturinave komunale do të realizohet me largimin e caktuar të komunave me mbi 50.000 banorë, përmes organizimit të mbledhjes së mbeturinave masive nga trotoret, shpërndarjen në „ishujt mbledhës“ në vendbanimet ose „trualle për reciklim“ të cilat do të pranojnë mbetjet e caktuara të cilat mund të reciklohen.

Repartet për tretman mekaniko-biologjik (TMB) si duket prodhojnë sasi optimale të fraksioneve të mbeturinave të cilat mund të shfrytëzohen si *zëvendësim i resurseve natyrore*: derivatit sekondar të repartetve për prodhimin e energjisë nga mbeturinat, fraksione të ndryshme të metalit për proceset e reciklimit dhe mbetjeve nga fraksionet më të rënda të dedikuara për tretman biologjik-anaerob ku prodhohet biogasi dhe që shfrytëzohet për energji dhe nxehtësi. Mbetjet e stabilizuara nga proceset e TMB mund të deponohen si tokë punuese e përgatitur në mënyrë artificiale për aktivitete afatgjate të sanimit të sipërfaqeve të deponive industriale dhe të minierave me ndotje të lartë.

Përtëritja, reciklimi dhe llojet e tjera të *përpunimit të prodhimeve me afat të skaduar të përdorimit* mund të zbatohen në nivele të ndryshme teknologjike, në mvarshmëri nga karakteristikat e veçanta të produkteve, kapacitetet ekzistuese për përtëritje, reciklim dhe largim/deponim, dhe madhësisë ekonomike. Fraksionet e përtëritura nga prodhimet me afat të skaduar të përdorimit mund të kyçen në procese të ndryshme të reciklimit dhe largimit /deponimit, të cilat do të jenë të disponueshme në Maqedoni dhe në vendet e tjera.

*Rrjeti i deponive rajonale për mbeturina komunale* të cilat ndërtohen, përgatiten dhe punojnë në pajtim me standardet e UE-së për deponitë e mbeturinave do të përshtaten me rajonet e formuara për menaxhim me mbeturinat, si asociacione të obligueshme të komunave për zgjidhje të përbashkët të problemeve me mbeturinat komunale dhe mbeturinat e tjera të parrezikshme, pranë madhësisë

optimale ekonomike . Zgjidhjet konceptuale për ndërtimin dhe punën e kapaciteteve të deponive të cilat posedojnë leje ekologjike të integruara janë themeluar në rekonstruimin e mundëshëm të deponive ekzistuese me rrezik të mesëm ose të ulët për mjedisin jetësor, me qëllim që të sigurohet shmangia me kohë e mbeturinave dhe ndërtimi i deponive të reja në lokacione të reja ose me rekonstruimin e deponive ekzistuese me rrezik të ulët.

Midis *kapaciteteve për tretman të mbeturinave*, repartet për tretman mekanik-biologjik (TMB) për mbeturinat komunale, repartet për shfrytëzimin e mbeturinave për energji dhe repartet për prodhim/shfrytëzim të biogazit mund të luajnë rol të rëndësishëm në rrugë drejt realizimit të menaxhimit të qëndrueshëm me mbeturinat komunale në fazën e dytë të zhvillimit.

Deponitë komunale të cilat paraqesin rrezik të lartë për mjedisin jetësor do të mbyllen, me zbatimin e *masave teknike sanuese* me qëllim që të zbuten ndikimet ndaj mjedisit jetësor.

Koncepti teknik i *menaxhimit me mbeturinat medicinale* themelohet me ndarje të rreptë të fraksioneve të mbeturinave sipas shkallëve të ndryshme të rrezikshmërisë dhe sipas vlerës kalorike. Largimi mund të realizohet nga kapaciteti qendror me efikasitet të lartë për insenerim (djegie) ose nga më tepër kapacitete për dezinfektim, si dhe me deponimin e mbetjeve.

*Mbeturinat dhe mbetjet urbane* mund të shfrytëzohet për paratretman në të njejtën degë teknike, si material i lëndës së parë apo si aditiv , fraksionet e djegëshme mund të shfrytëzohen për derivate sekundare; mbetjet e pashfrytëzuara do të definoohen në mono-deponi. Azbesti, si fraksion i rrezikshëm i mbeturinave urbane dhe mbetjeve urbane, kërkon teknika të veçanta për mbledhje, përdorim dhe deponim.

Zhvillimi i *menaxhimit me mbeturinat e rrezikshme dhe të parrezikshme industriale* është rreptë i lidhur me riorganizimin e ndërmarrjeve prodhuese, metalurgjike, termoenergjetike dhe xehtare të cilat përgjigjen për mbeturinat e tyre. Rezultatet e pritura nga riorganizimi i industrisë, sidomos në procesin e adaptimit me direktivat për parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes, janë efikase *masat për arritjen e sasisë minimale të mbeturinave në burimin e tyre*, d.m.th. për shfrytëzim më efikas të materialit të lëndës së parë dhe të energjisë, reciklim më intenziv intern ose të jashtëm, të llojeve të materialit nga prodhimi shfrytëzimit të substancave më pak të rrezikshme në prodhimin e produkteve, neutralizimi i substancave të rrezikshme në mbeturina para deponimit të tyre dhe mënjanimi/deponimi rreptësisht e ndarë i mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme.

Krahas zbatimit të masave efikase teknike për zvoglimin e sasisë dhe potencialit të rrezikshmërisë së mbeturinave nga industria dhe nga termo-centralet, do të zbatohet *rikonstruimi dhe sanimi i deponive* për zgjyrën dhe hirin e rrezikshëm dhe të parrezikshëm sipas standardeve bashkëkohore për deponimin e mbeturinave.

Për *krrijuesit më të vegjël të mbeturinave të rrezikshme* do të vëhet sistem përkatës për menaxhim, i cili do të përbëhet, kryesisht, nga depot për mbledhje dhe skladium dhe nga kapaciteti qendror për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme; për fraksione të caktuara të mbeturinave të rrezikshme, opcioni real mund të jetë insenerimi dhe/ose ko-insenerimi, ndërsa mbeturina të caktuara, si PHB, mund të eksportohen për tretman përkatës.

Koncepti për menaxhim me *mbeturinat e rrezikshme nga proceset e minierave* do të kryhet me ndihmën e qasjes strategjike dhe me drejtime të ndërlidhura me rregullativën e xehtarisë dhe në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë dhe të ndikimit ndaj mjedisit jetësor.

*Menaxhimi adekuat me nus-prodhimet bujqësore* dhe nga veprimtaritë e tjera të ngjajshme prodhuese, siç janë plehrat , indet shtazore dhe indet e llojllojshme bimore, është e lidhur ngushtë me zbatimin e „praktikës së mirë bujqësore“ dhe me shfrytëzimin e nus-prodhimeve të këtilla si burime të

ripërtëritura të energjisë. Prioritet i posaçëm do të kushtohet strukturës së zbatueshme ekonomike për mbledhjen e ndarë të indeve shtazore të cilat i përkasin klaseve të ndryshme të rrezikut dhe do të formohet rrjet përkatës i kapaciteteve për tretman dhe për deponim, sidomos me vendosjen e kapaciteteve për indet shtazore me rrezikshmëri të lartë (mbeturinat e rrezikshme).

Mbledhja e drejtë, përdorimi dhe mënjanimi/deponimi i mbetjeve toksike agrokimike (insekticideve, fungicideve) dhe paketimi i kontaminuar do të organizohet përmes sistemit të kthimit të organizuar nga sektori distributiv, tregtar dhe prodhues.

Menaxhimi kontinuitiv i parregullt me mbeturinat e rrezikshme nga industria metalurgjike dhe kimike dhe nga termo-centralet rezultoi në deponitë dhe lokalitetet e kontaminuara industriale. Me zbatimin e kreteve për cilësitë e rrezikshme të mbeturinave, sferat e kontaminuara klasohen si vatra ekologjike, ndërsa me zbatimin e **kritereve** për kushtet lokale hidro-geologjike dhe për **kontaminimin e përcaktuar ose potencial** të tokës punuese dhe ujit, sferat e kontaminuara mund të rangohen si vatra ekologjike me rrezikshmëri të lartë dhe me rrezikshmëri të ulët. Do të realizohen proekte për sanimin e vatrave ekologjike me rrezikshmëri të lartë edhe për ata për të cilët mund të mobilizojnë mjete; zgjidhjet teknike dhe teknologjike për sanim do të përzgjidhen nga metodat e shumta teknike të disponueshme dhe do të adaptohen vendimeve për çdo vatër të caktuar ekologjike dhe drejt kërkesave të veçanta në mjedis lokal.

## **MASAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR MENAXHIM ME MBETURINAT**

Vendosja e rrjetit funksional për rrjet të kapaciteteve për mbledhje, tretman dhe deponim është në masë më të madhe e determinuar nga dinamika e investimit në kapacitete për menaxhim me mbeturinat, me masat ekonomike dhe masa të tjera që stimulojnë investime, si dhe me masa me të cilat do të garantohet mbulimi i plotë i shpenzimeve për punën e gjithë sektorit për menaxhim me mbeturinat në pajtim me parimin „ndotësi paguan“. Por, dinamika e investimit do të balansohet me zhvillim ekonomik të vendit dhe me standardin jetësor të banorëve, nga njëra anë edhe me shpenzimet për skenaret e pavolitshme dhe me pasojat afatgjate të ndërlidhura midis tyre për mjedis jetësor dhe për ekonominë përdërisa nuk zgjidhen problemet kryesore në sferën e menaxhimit të mbeturinave.

Zbatimi i suksesshëm i konceptit teknik për menaxhim me mbeturinat në praktikë varet nga koncenzusi i plotë politik dhe nga kushtet e volitshme për zbatimin e masave kyçe të ndërlidhura midis tyre, në fakt rregullativa ligjore për menaxhim me mbeturinat, masat organizative dhe institucionale në kombinim me përforcimin e resurseve njerëzore, masat ekonomike, masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, masat për subjektet e interesuara dhe për ngritjen e vetëdijes publike në lidhje me problemet me mbeturinat, si dhe nxitja e aktiviteteve hulumtuese dhe zhvillimore.

Realizimi i sistemit të qëndrueshëm për menaxhim me mbeturinat është proces gradual, i cili nga ana e tij kyç realizimin e masave të zgjedhura juridike, institucionale/organizative e sidomos masa ekonomike të prioritetit të lartë, me qëllim që të realizohet përparimi i nevojshëm në këto sfera, gjatë të cilit realizimi kërkon ndryshime fundamentale në sferat e ndryshme ekonomike dhe shoqërore të ndërlidhura midis tyre.

### **Regullativa ligjore për menaxhim me mbeturinat**

Inkorporimi i rregullave themelore, parimet, obligimet dhe shpërndarja e kompetencave dhe struktura operative përkatëse për menaxhim me mbeturinat e harmonizuar me *acquis communautaire* në legjislaturën nacionale është njëra nga detyrat kryesore për tejkalimin e problemeve të ndërlidhura me rrjedhat prioritare të mbeturinave, sidomos mbeturinat e rrezikshme dhe të ndërprehet ndotja e mjedisit jetësor e shkaktuar nga menaxhimi aktual me mbeturinat, që të vendoset rregullim juridik dhe sistem i ri bashkëkohor për menaxhim me mbeturinat në procesin e aproksimit të Maqedonisë në UE-së.

Rregullativa ligjore për menaxhim me mbeturinat duhet të jetë e ndërlidhur me legjislaturën horizontale e cila ka të bëjë me mjedisin jetësor dhe me traktatet ndërkombëtare dhe legjislaturë tjetër të ngjashme nacionale për procedurat e përgjithshme administrative, ndërtimi investues dhe planifikimi hapsinor, xehtaria, ekonomia dhe finansat, vetëqeverisja lokale, ndërmarrjet publike dhe koncesionet.

Transponimi i përgjithshëm i Direktivës Kornizë për mbeturina dhe i Direktivës për mbeturina të rrezikshme do të realizohet si prioritet i parë afatshkurtër. Këto direktiva i përcaktojnë rregullat, parimet dhe strukturën themelore, të sistemit të përgjithshëm adekuat për menaxhim me mbeturinat, si dhe rregullat dhe dispozitat themelore për lokacionet e deponive, ndërtimet dhe lejet, për klasifikimin e deponive dhe për masat pas mbylljes së deponive. Rregullativa ligjore nacionale për deponitë për mbeturina do të përcaktojë edhe obligimet dhe rregullat për menaxhim me deponitë jostandarde dhe të egra, si dhe për revitalizimin e vatrave ekologjike në një numër relativisht të madh.

Paralelisht, rregullat e përgjithshme për djegien/kalljen e mbeturinave, për vlerat kufitare të emisioneve në ajër dhe për lëshimin e ujit do të rregullohen në të njëjtin nivel të rregullimit të kornizës ligjore, si dhe obligimet dhe rregullat me të cilat rregullohet puna e deponive, ndërsa direktivat e tjera themelore për menaxhim me llojet e veçanta të mbeturinave do të transponohen në kornizën ligjore nacionale.

Për menaxhim të suksesshëm me llojet prioritare të mbeturinave në mënyrë të qëndrueshme, duhet të garantojë prioritet të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm, d.m.th. të mjedisit jetësor, para shfrytëzuesit individual, ndërsa masa ekonomike përkatëse për çdo lloj të veçant të mbeturinës dhe obligime të ndërlidhura me parimin e „përgjegjësia e prodhuesit“ dhe për mbulimin e plotë të shpenzimeve për aktivitetet në kuadër të menaxhimit me mbeturinat ndërsa do të përgatiten dhe do të ndërtohen në rregullativë ligjore nacionale; dispozitat e këtyra do të miratojë organi legjislativ, ndërsa do të zbatohet në punën e sistemit për menaxhim me mbeturinat.

## **Masat institucionale dhe organizative dhe rolet e subjekteve kryesore të involvuara për zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat**

### ***Përforcimi i institucioneve në nivel nacional***

Do të duhet riorganizim dhe përforcim institucional, numër shtesë të resurseve njerëzore përkatëse të trajnuara, si dhe bashkëpunim i mirë dhe harmonizim midis sektorëve në nivel nacional dhe që të zbatohet Strategjia Nacionale për menaxhim me mbeturinat, për zbatimin e ligjeve, detyrave institucionale dhe organizative, masat teknike dhe ekonomike/finansiare dhe proektet për zhvillimin e vetëdijes publike, nga njëra anë dhe në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e monitorimit, mbikqyrje dhe mekanizma për zbatimin e objekteve infrastrukturore të ndërlidhura me punën e krijuesve të mbeturinave për menaxhim me mbeturinat në nivel lokal dhe nacional (menaxhimi me mbeturinat komunale në kapacitete për deponim, industriale, krijuesit e tjerë të mbeturinave), nga ana tjetër.

Dega për menaxhim me mbeturinat në përbërje të Drejtorisë së Mjedisit Jetësor pranë MMJPH do të mbetet organ qendror për mbrojtjen e mjedisit jetësor kompetent për menaxhim me mbeturinat me detyrë të rregullt organizative që ta vendosë, zhvillojë dhe realizojë me sukses sistemin e menaxhimit me mbeturinat në Maqedoni, përmes planifikimit, paisjen me leje, regjistrimin dhe autorizimin, mbledhjen/menaxhimin/dorëzimin e të dhënave, përgatitjen e tenderëve, studimeve teknike dhe ekonomike, me udhëheqjen e proekteve për mbylljen e deponive të egra dhe revitalizimin e vatrave ekologjike, si dhe me zbatimin e proekteve finansiare nga UE. Me rrjedhën e kohës, ndërsa në pajtim me kompetencat kjo degë duhet të zgjerohet në Sektor për menaxhim me mbeturinat.

Dega e zgjeruar për parandalim të integruar dhe kontroll të ndotjes në kuadër të Sektorit për ndotje industriale dhe menaxhimi me rrezikun në Drejtorinë e Mjedisit Jetësor do të ketë rol udhëheqës në paisjen me liçencë ekologjike të integruar për deponitë e reja dhe ato ekzistuese dhe për kapacitetet e reja për mënjanimin e mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme. Kontrolli i zbatimit të lejeve ekologjike të integruaradhe lejet për harmonizim me planin operativ do të paraqesin veglën themelore për sigurimin e mbrojtjes së mjedisit jetësor nga veprimi me mbeturinat. Do të vendoset lidhje e ngushtë dhe bashkëpunim me Degën për mbeturina dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor.

Zyra e Zgjeruar për Komunikim me Publikun në përbërje të MMJPH do të luaj rol udhëheqës në koordinimin e detyrave të ndërlidhura me ngritjen e vetëdijes publike dhe me kontaktet me krijuesit e mbeturinave, në kontekst të problemeve në mjedisin jetësor.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor do të jetë përgjegjës gjeneral për monitorimin/mbikqyrjen/zbatimin e sektorit prodhues dhe shërbyes në lidhje me menaxhimin me të gjitha llojet e mbeturinave dhe me punën e kapaciteteve për tretman/mënjanim të mbeturinave. Inspektorati Shtetërorë i Mjedisit Jetësor, si organ në përbërje të MMJPH, do të organizohet në nivel nacional dhe rajonal me sektorët e formuar ose degët me qëllim që të arrihet racionalizim më i madh i punës dhe i resurseve njerëzore në këtë fushë.

Me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, Qendra Informative e Mjedisit Jetësor do ta zgjerojë perimetrin e aktiviteteve në mbledhjen e të dhënave dhe do të sigurojë informim të sigurt për publikun, me ndarjen e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave me institucionet e tjera të autorizuar dhe me përpunimin dhe mirëmbajtjen e bazës qendrore të të dhënave për çështje të ndërlidhura me mbeturinat.

### ***Përforcimi i institucioneve në nivel lokal***

Në parim, komunat janë përgjegjëse për sigurimin e menaxhimit përkatës dhe mënjanimin e mbeturinave komunale për qytetarët e tyre. Me pranimin e nivelit rajonal në zgjidhjen e problemit me mbeturinat, komunat janë të obliguara që të angazhojnë dhe të trajtojnë persona përgjegjës për aktivitetet e ndërlidhura me vendosjen dhe me funksionimin e sistemit rajonal për menaxhim me mbeturinat komunale në pikëpamje ligjore, organizative dhe financiare.

Ndërmarrjet rajonale për menaxhim me mbeturinat komunale (NRMMK) do të formohen me konzorciumet e komunave në pajtim dhe/ose me pjesëmarrje të MMJPH dhe ata do të marrin pjesën më të madhe të përgjegjësisive dhe të detyrave për planifikim, udhëheqjen e investimeve, marrëdhëniet me publikun dhe në organizimin e aktiviteteve të tjera të ndërlidhura me menaxhimin me mbeturinat komunale të cilat në fillim kanë qenë detyrë e komunave, dhe për organizimin e menaxhimit me mbeturinat komunale dhe mënjanimin e mbetjeve në emër të komunave të bashkuara dhe qytetarëve të tyre. Pjesëmarrja në sektorin privat, përmes koncesionit ose partneritetit publik privat do të nxitet, si mekanizëm i sigurisë së zgjidhjes optimale ekonomike e cila njëkohësisht është ekologjikisht e pranueshme.

### ***Detyrat, obligimet dhe kompatancat e sektorit prodhues dhe afarist, institucionet e qytetarëve, joqeveritare, arsimore dhe shkencore***

Sektori prodhues dhe sektorët e tjerë afariste, ndërmarrjet publike të autorizuar dhe operatorët e tjerë për menaxhim me mbeturinat, në pajtim me liçencat e tyre dhe/ose leje do të marrin masa teknologjike dhe organizative për parandalim, përtëritja dhe reciklimi i mbeturinave, do të sigurojnë përdorim të rregullt, monitorim dhe informim për menaxhim me mbeturinat përmes zbatimit të masave të tyre financiare dhe organizative ose përmes vendosjes së planeve të tyre organizative për menaxhim me llojet e veçanta të mbeturinave me zbatimin e marrëveshjeve vulnetare ose do të angazhojë ndërmarrje shërbyese të cilat posedojnë liçencë.

Qytetarët do ti mbledhin fraksionet e mbeturinave komunalesipas planeve dhe programeve komunale; ata do të kontribuojnë për bashkëraportin të rregullt midis shërbimeve të kryera dhe arkëtimit për to dhe do të bëhen persona të interesuar në aspekt të investimeve në kapacitete të reja për menaxhim me mbeturinat.

Roli kryesor i organizatave joqeveritare mund të jetë në lobimin në lidhje me çështjet e planifikimit dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor, si dhe në zgjerimin e informatave të ndryshme për mjedisin jetësor. Procesi kryesor i universitetit dhe institucioneve të tjera hulumtuese dhe shkencore, mund të jetë në zbatimin e hulumtimeve profesionale dhe hulumtimeve në sferën e mjedisit jetësor, analiza dhe kërkesa, si dhe në kuptimin dhe interpretimin e parametrave të ndryshme ekologjike të ndërlidhura midis tyre.

## **Masat ekonomike**

Me qëllim të promovimit të zhvillimit të masës ekonomike dhe efikasitetit energjetik dhe të efikasitetit të tyre nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor, **masat ekonomike** duhet ti kenë parasysh të gjitha aktivitetet e rëndësishme ekonomike: shpenzimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore. Masat ekonomike mund të arrijnë masa pozitive në vend nën këto kushte: vlerën e njohur ekonomike të mjedisit jetësor, duke pasur parasysh kufizimet në shfrytëzimin e resurseve natyrore, internalizimin e shpanzimeve eksterne në produktet e plasura në treg dhe zbatimin e parimit „ndotësi paguan“.

Intereset afatgjate të Maqedonisë do të jenë që të zbatohet politika e kthimit të tërësishëm të shpenzimeve të të gjitha kapaciteteve dhe shërbimeve për menaxhim me mbeturinat, aq shpajt sa të lejojnë mundësitë ekonomike dhe kufizimet politike. Vendimi i këtillë, e inkorporuar në dokument strategjik, paraqet porosi të qartë për prodhuesit e mbeturinave se shpenzimet për menaxhim me mbeturinat e tyre në mënyrë të qëndrueshme ekologjike do të jenë, nga njëra anë, të internacionalizuara në vlerën tregtare të prodhimeve, ndërsa në anën tjetër kjo do ti nxisë prodhuesit e mbeturinave që ta zvoglojnë sasinë e mbeturinave të cilën e shkaktojnë dhe të fillojnë të marrin masa për përpunimin dhe për reciklimin e mbeturinave.

Masat ekonomike përfshijnë tri elemente themelore me rëndësi kyçe për zhvillimin e ardhshëm dhe qëndrueshmërinë afatgjate të shërbimeve të menaxhimit me mbeturinat, d.m.th. kthimi i shpenzimeve dhe finansimi i investimeve dhe shërbimet e ndërlidhura me mbeturinat, instrumentet ekonomike dhe financiare për rregullimin e aktiviteteve për zvoglimin/reciklimin e mbeturinave dhe përmirësimi i investimeve dhe i efikasitetit të shërbimeve përmes konkurrencës dhe kyçja e sektorit privat në sistemin për menaxhim me mbeturinat.

### ***Kthimi i shpenzimeve dhe finansimi i investimeve dhe shërbimeve***

Pagesa në mynyrë konsekuente e kompenzimeve nga të gjitha subjektet e involvuara, përkatësisht nga qytetarët dhe nga sektori afarist dhe sigurimi i të hyrave të nevojshme paraqesin bazën e investimeve të reja, për revitalizim të deponive dhe për masa ekonomike të cilat duhet të vendosen me qëllim të zvoglimit të ndikimit ndaj mjedisit jetësor; duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese, pagesa konsekuente do të arrihet me tejkalimin e kufizimeve të numërta politike, ekonomike, institucionale dhe organizative në shoqëri në sferën e menaxhimit me mbeturinat.

Përmirësimet e rëndësishme në realizimin e arkëtimit të kompenzimeve mund të arrihet me riorganizimin e shërbimeve për arkëtim dhe për mënjanim të mbeturinave komunale, sidomos me vendosjen dhe me funksionet e reja organizative të ndërmarrjeve rajonale për menaxhim me mbeturinat komunale, me pjesëmarrje të sektorit privat dhe me raportete e ndryshuara të arkëtimit midis subjekteve kryesore të involvuara „qytetarë – komunë – ndërmarrja për menaxhim me mbeturinat komunale dhe deponia – ndërmarrjet për mbledhjen e mbeturinave“.

Mund të vazhdojë zbatimi i mekanizmit indirekt për përcaktimin e kompenzimeve për mbledhjen/deponimin për mbeturinat nga amvisria; në etapën e dytë zhvillimore, kompenzimet për

mbledhje/tretman/deponim do të themelohen, në rastin më të mirë, të sasisë dhe të peshës së mbeturinave komunale, ndërsa mbeturinat e parrezikëshme komerciale dhe industriale ata do të bazohen kryesisht në peshë..

Për realizimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat mund të zbatohen opsione të ndryshme të finansimit për investime; por tatimet/taksat ekologjike të alokuara të ndërlidhura me tretmanin dhe me mënjanimin e mbeturinave do të gjenerojnë rrjedha të reja, të parapara dhe të sigurta të të ardhurave, me qëllim që të garantohet aftësia kreditore e investitorit dhe realizimi i investimeve të caktuara me (ko) finansim në praktikë.

Transferi nga buxhetet e rregullta shtetërore dhe komunale, kryesisht, për fillimin e proekteve për menaxhim me mbeturinat dhe për aktivitetet e përgatitura për investimet prioritare.

### ***Instrumentet ekonomike dhe finansiare për rregullimin e aktiviteteve për zvoglimin/reciklimin e mbeturinave***

Republika e Maqedonisë do të vendosë instrumente efikase ekonomike/finansiare dhe ekologjike, të cilat do të jenë kompatitabile me rregullativën tjetër ligjore dhe të cilat mund të gjenerojnë rrjedhë të të ardhurave, sipas mundësive të dedikuara për qëllime konkrete të ndërlidhura me menaxhimin e mbeturinave.

Masat ekonomike destimulative, siç janë taksat/taksat e jashtëzakonshme, do të vendosen me qëllim parësor që të shkaktohen ndryshime në sjelljen e shkaktuesve të mbeturinave; masat stimulative ekonomike, siç janë format e ndryshme të subvencioneve, do të planifikohen me qëllim që të mundësohet motivimi pozitiv financiar për menaxhim me mbeturinat në mënyrë të shëndoshë dhe të qëndrueshme ekologjike, si dhe për zvoglimin e emisioneve të gazrave të qelqta..

Do të vendoset sistem i qëndrueshëm i menaxhimit me mbeturinat i cili do të jetë efikas në raport me shpenzimet, ndërsa me të do të menaxhojnë dhe për të do të paguajnë sektori prodhues dhe ai tregtar, në pajtim me skemat për „përgjegjësia e prodhuesit“ me involvim të vogël, intervenim dhe kontroll nga institucionet qeveritare.

### ***Kyçja e sektorit privat në sistemin për menaxhim me mbeturinat***

Pjesëmarrja e sektorit privat në sistemin e menaxhimit me mbeturinat do të vendoset si partneritet midis sektorit privat dhe atij publik, me qëllim që shërbimet publike dhe investimet në infrastrukturë të sigurohen dhe të funksionojnë në mënyrën më ekonomike dhe efikase të mundëshme.

Do të zbatohen ndryshime rrënjësore në strukturën institucionale dhe organizative në raportet midis „autoriteteve publike – ndërmarrjet publike – sektori privat – kapacitetet ekzistuese/të reja infrastrukturore“ me qëllim që menaxhimi me mbeturinat të ndahet nga aktivitetet e tjera të cilat sot i kryejnë ndërmarrjet publike, që të sigurohet garancion/për kthimin e shpenzimeve të shërbimeve për menaxhim me mbeturinat komunale, që të mundësohet vendosje e procedurave tenderiane dhe investimet private në sistemin e menaxhimit me mbeturinat.

Sektori privat i licencuar mund të kyçet në menaxhimin me mbeturinat në sferën e menaxhimit me mbeturinat institucionale, medicinale, komerciale dhe industriale, me pritjen e shërbimeve të larta efikase dhe kualitative.

### **Instrumentet e planifikimit hapsinor dhe mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore**

Planifikimi hapsinor në nivel nacional dhe lokal, në lidhje me lokacionet e pranueshme për kapacitetet për menaxhim me mbeturinat, duhet ti ketë parasysh karakteristiket topografike, gjeologjike, hidro-

gjeologjike dhe destinimi i tanishëm i tokës punuese, lokacionet për zgjerimin e vendbanimeve, pronësia e tokës dhe sferat e ndieshme të identifikuar në raport resurset ujore dhe vendbanimeve natyrore. Në nivelin nacionaë dhe lokal, do të identifikohen sfera të ndieshme nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor, si informata hyrëse të rëndësishme gjatë përpunimit të planeve hapsinore.

Kapacitetet për tretman dhe për insinerim të mbeturinave do të ngriten në lokacione ku dominojnë kapacitetet industriale, energjetike dhe transportuese dhe nuk mund të priten kufizime të përgjithshme për teknologjitë në kontekst të cilësisë së kualitetit të mjedisit jetësor.

Lokacionet e deponive do të zgjidhen së pari sipas kriterëve të lidhura me karakteristikat dhe mbrojtjen e mjedisit natyror, pronësia e tokës punuese, me shfrytëzimin dominant të lokacionit, si dhe efektet ekonomike dhe sociale. Megjithatë, prioritet do ti ipet lokacioneve të deponive ekzistuese të mbeturinave dhe ato të lëna pas dore, ku rikonstruimi i deponisë mund të jetë ekonomikisht i volitshëm, ndërsa shfrytëzimi alternativ do të ishte jopraktik, ndërsa gjatë kësaj është e mundur që të plotësohen kriteret për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe kriteret ekonomike mund të plotësohen në kuadër të pranueshmërisë sociale.

Lokacionet e zgjedhura sipas kriterëve të përcaktuara dhe të dedikuara për funksionim afatgjatë të kapacitetit të ri për trajnim/deponim të mbeturinave do të përgatiten dhe të miratohen si pjesë përbërëse e planeve hapsinore në nivel lokal dhe nacional, duke pasur parasysh zgjerimin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave në këto lokacione në të ardhmen.

### **Vetëdija dhe konsultimi i subjekteve të involvuara dhe i publikut**

Mbeturinat paraqesin çështje komplekse e cila, në shoqëritë bashkëkohore, i tejkalon aspektet teknike, ekonomike dhe juridike. Detyra kryesore e strategjisë për menaxhim me mbeturinat, në aspekt të vetëdijes publike, është që të arrihet ndryshim fundamental në kuptimin e problemeve me mbeturinat në tërësi dhe të shpallen ndryshimet e patejkalueshme politike dhe strukturore në sektorin e menaxhimit me mbeturinat e forta përmes pjesëmarrësve të informuar aktiv, kyçja e publikut dhe mbështetja publike.

Mjeti i cili është në dispozicion për krijimin e vetëdijes në shoqëri për problemet me mbeturinat dhe për ndryshimet e panevojshme në përvojën e tyre të menaxhimit me mbeturinat është strategjia e komunikimit, e shpallur përmes procesit të komunikimit ose përmes kampanjave publike. Procesi i ngritjes së vetëdijes publike, në secilën fazë të saj, duhet ti plotësojë parimet fundamentale në vijim-korektësinë, autenticitetin, dhe arsyeshmërinë.

Kampanjat publike për ngritjen e vetëdijes publike në Maqedoni, përmes zbatimit të qasjqs proaktiv/pozitiv, do të fokusohen në grupet themelore të problemeve në vijim:

- Ndalimi i ndikimeve ndaj mjedisit jetësor si pasojë nga mënjanimi i mbeturinave në mënyra jo të rregullt, të pakontrolluar, dhe jolegale;
- Përmirësimi i shkallës së shfrytëzimit të sërishëm, reciklimi dhe përtëritja e mbeturinave;
- Përmirësimi i menaxhimit me mbeturina të rrezikshme;
- Krijimi i qasjes së integruar të bashkëpunimit në menaxhimin me mbeturinat.

Zyra për komunikim me publikun pranë MMJPH do të sigurojë model për zbatim të themeluar mbi karakteristikat e komunikimit me grupe të ndryshme qëllimore në shoqëri, d.m.th. udhëheqësit e proektit, publiku politik, publiku profesionist,mediat,bashkësitë lokale dhe publiku i përgjithshëm dhe do të organizojë kampanjë për ngritjen e vetëdijes për të gjitha subjektet e interesuara, sidomos për grupet e tanguara qëllimore.

Zyra për komunikim me publikun, gjithashtu, do të udhëheqë kampanja informative për rritjen e nivelit të vetëdijes ke sektori afarist dhe prodhues për kuptimin, pranimin dhe bashkëpunimin në insistimet e përbashkëta për mënjanimin e sigurt ekologjik të mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme.

## **PASQYRË E PLANIT ME AKSIONE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË MENAXHIMIT ME MBETURINAT**

Arritja e qëllimeve strategjike vërteton për tejkalimin e problemeve ekzistuese dhe mangësitë me menaxhimin me mbeturinat imponon zbatimin e masave në vëllim të gjërë, të cilat do të zbatohen në mënyrë kontinuitive dhe në periudhë të gjatë kohore prej rreth 20 vitesh. Plani i aksioneve për realizimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat i pasqyron aktivitetet të cilat duhet të realizohen në periudhë më të shkurtër dhe relativisht më të paraparë prej 12 viteve dhe përfshin tri tema kryesore:

- Përcaktimi i prioriteteve për masat e ndërlidhura midis tyre të orientuara drejt ndryshimit të përvojës ekzistuese të menaxhimin me mbeturinat;
- Masa/aktivitete konkrete kohore me të cilat do të mundësohet kalim më i lehtë drejt funksionot të sistemit më bashkëkohor për menaxhim me mbeturinat;
- Vlerësimi i investimeve të nevojshme dhe i shpenzimeve të tjera të bashkangjitura, si dhe i përfitimeve afatgjate dhe afatshkurte..

### **Masat prioritare dhe aksionet**

Kriteret për zgjedhje të masave dhe aksioneve prioritare janë themeluar në model i cili e shpreh radhitjen logjike të zbatimit të kërkesave ligjore për menaxhim me mbeturinat:

- Sigurimi i resurseve njerëzore dhe strukturat organizative;
- Përgatitja e dokumenteve dhe planeve politike dhe regullative;
- Përgatitja e dokumentacionit teknik dhe investues;
- Themelimi i sistemit ndihmës, sidomos vetëdija publike dhe mbështetja financiare ;
- Realizimi i investimeve në infrastrukturës themelore për menaxhim me mbeturinat.

Përgatitja efektive e detyrave politike/regullatore dhe vendosja e institucioneve të nevojshme drejtpërdrejt zhvillohen së bashku me përforcimin adekuat të resurseve njerëzore.

### ***Korniza ligjore për menaxhim me mbeturinat dhe instrumentet ekonomike***

Transponimi i plotë i direktivave të UE-së të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave do të përfundojë pas tri viteve; por, detyrë afat shkurtër, d.m.th. për një vit, është formimi i kornizës së përgjithshme ligjore për menaxhim me mbeturinat me transponimin e direktivave të UE-së për mbeturinat, për mbeturinat e rrezikshme dhe për deponimin e mbeturinave, si dhe vendosjen e sistemit të përgjithshëm për lajmërim i cili paraqet përmbajtje „të butë“ drejt dispozitave për çdo krijues të mbeturinave dhe bazë për përpunimin e planeve për menaxhim me mbeturinat ,dokumente teknike dhe investuese, për aktivitete për mbikqyrje dhe inspektim, për arkëtim të kompenzimeve për menaxhim jo adekuat dhe deponim të mbeturinave të veçanta dhe për vendosjen e instrumenteve të tjera ekonomike.

Zbatimi i regullativës themelore ligjore të sjellur për menaxhim me mbeturinat pakontest do të ngushtojë interesat dhe kompetencat e të gjithë anëtarëve të shoqërisë; harmonizimi i interesave të ndryshme të shoqërisë do të jetë i domosdoshëm dhe i një rëndësie të veçantë për zbatimin e prioritetit për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm, në fakt të mjedisit jetësor para shfrytëzuesit individual.Në fakt, baza ligjore e miratuar, duhet të sigurojë të ardhura të parapara dhe kthimin e plotë të shpenzimeve që rezultojnë nga aktivitetet e menaxhimit me mbeturinat, të ndikojë në disiplinën e pagesës, ta sigurojë rëndësinë të instrumenteve ekonomike/financiare të dedikuara për zvoglimin/përtëritjen/reciklimin e mbeturinave dhe të mundësojë themelimin e fondeve të reja për ko-investim në kapacitete rajonale për menaxhim me mbeturinat.

Vendimet e miratuara politike dhe dokumentet ligjore paraqesin kushtetУсвоените политички “*sine qua non*” (parakushte absolute) për vendosjen e sistemit të ri bashkëkohor për menaxhim me mbeturinat.

### ***Struktura institucionale dhe aktivitetet***

Përgatitja e dokumenteve politike, regullative, planore dhe teknike/investuese, si dhe zbatimi i procedurave të ndryshme për regjistrimin/dhënien e lejeve/liçencave dhe mbledhja/dorëzimi i të dhënave do të kërkojë, si prioritet të lartë, përf forcime të dukshme të institucioneve administrative, inspektues dhe të tjera; do të jenë të pashmangëshme punësimet e reja dhe trajnimet e kuadrove në pes vitet e para nga zbatimi i strategjisë për menaxhim me mbeturinat.

Përgatitja e dokumenteve prioritare dhe planore për vendosjen dhe për punën e sistemit të ri rajonal për mbledhje/tretman/deponim të mbeturinave, për mbeturinat komunale dhe mbeturinat e tjera të parrezikshme, për mbylljen e deponive të egra dhe për ndërtimin e deponive të reja, për menaxhimin me mbeturinat themelore të rrezikshme dhe me mbeturinat dhe mbetjet urbane, do të paraqesë pjesën qendrore të aksioneve të cilat do të duhet ti realizojë dega/ sektori për mbeturina në pes vitet e para të zbatimit të strategjisë për menaxhim me mbeturinat. Sipas interesave të shprehura, përgatitja e dokumenteve planore dhe politike për menaxhim me llojet e veçanta të mbeturinave, me mbeturinat e bio-degraduese dhe për nxitjen e parandalimit të shkaktimit të mbeturinave, përdorimi i sërishëm i tij dhe reciklimi, shfrytëzimi për energji dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve të përtëritura energjetike mund të përputhet me aktivitetet në fazën e parë të zbatimit ose mund të zhvendoset në pjesën e dytë të periudhës për zbatim të strategjisë për menaxhim me mbeturinat.

Qeveria, sidomos MMJPH, do të nxisë zgjidhje politike dhe do të organizojë vendosjen e trupave të reja rajonale –ndërmarrje dhe institucione, në drejtim të zbatimit të detyrave që do të rezultojnë në sistem bashkëkohor rajonal për menaxhim me mbeturinat dhe do të ndihmojë në zhgjidhjen e aktiviteteve kyçe politike, reorganizative, finansiare, të trafikut dhe aktiviteteve të tjera operative.

Detyrat prioritare të MMJPH dhe prodhuesit e mbeturinave të rrezikshme do të jenë themelimi i ndërmarrjeve qendrore për menaxhim me mbeturinat e rrezikshme, e cila mund të jetë e dedikuar për prodhuesit më të vegjël të mbeturinave, si dhe të fillojnë negociatat me prodhuesit më të mëdhenj të mbeturinave me qëllim që ti përpusojnë zgjidhjet më të shpejta të realizueshme, teknike dhe ekonomike për mënjanimin/deponimin e mbeturinave të rrezikshme dhe për revitalizimin e vatrave ekologjike.

Skemat për mbledhjen/përpunimin/reciklimin e llojeve të veçanta të mbeturinave sipas parimit për „përgjegjsia e prodhuesit“ dhe marrëveshjet vullnetare, mundet dukshëm të ndihmojnë në zvoglimin e presionit ndaj deponive dhe zbutjen e rrezikshmërisë për mjedisin jetësor.

### ***Infrastruktura prioritare teknike***

Mundet të inicohet përpunimi i dokumenteve të caktuara teknike dhe investuese për infrastrukturën prioritare teknike dhe kërkesë për finansim; pritet mbyllja e deponive të egra dhe e atyre me rrezikshmëri të lartë dhe ndërtimi/rikonstruimi i njëpasnjëshëm i kapaciteteve qendrore për menaxhim me mbeturinat-deponitë rajonale – të realizohen në periudhën prej 9 vitesh.

Infrastruktura prioritare teknike për menaxhim me mbeturinat komunale dhe me mbeturina të tjera të parrezikshme do të përbëhet, kryesisht, nga paisja për mbledhje dhe bartje të mbeturinave, riparimi i deponive ekzistuese dhe ndërtimi i deponive të reja bashkëkohore për mbeturina të parrezikshme komunale.

Infrastruktura teknike për procedimin me mbeturinat intere, kryesisht mbeturinave dhe mbetjeve urbane, mund të zhvillohet me dhënien e mundësisë përfaqësuesve të liçensuar të sektorit privat.

Aktivitetet afatshkurtëra teknike për menaxhim me mbeturinat e rrezikshme, në pjesën më të madhe, ndarja e fraksioneve të mbeturinave të rrezikshme dhe të parrezikshme në burimin, kapacitete më të

mira për skladim dhe përpunim të dokumentacionit teknik dhe investues për teknologjitë e reja procedurale dhe për sanimin e vatrave ekologjike . Investimi në paisjen e proceseve teknologjike dhe në kapacitetet për tretman/deponim të mbeturinave të rrezikshme mund të zhvendosen drejt pjesës së dytë të periudhës për zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat.

Përpunimi i dokumentacionit përkatës teknik dhe investues për kapacitetet e dedikuara për menaxhim me llojet e veçanta të mbeturinave, për zvoglimin e mbeturinave bio-degraduese për mënjanimin e, për shfrytëzimin e energjisë nga mbeturinat dhe për shfrytëzimin e tij për prodhimin e energjisë mundet të shqyrtohet pas njohurive më të detajuara për sasinë dhe për përbërjen e llojeve të mbeturinave. Investimet në kapacitetet e procesuara mundet të zhvendosen kah fundi ose më tutje në periudhën për zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat.

Vendosja e infrastrukturës prioritare teknike për menaxhim me mbeturinat nga mbledhja deri ke mënjanimi/deponimi kërkon aktivitete intenzive të informimit dhe promovimit efektiv me qëllim që të ngritet vetëdija publike vetëdija/bashkëpunimi ke krijuesit e mbeturinave.

### **Masat dhe aktivitetet e veçanta kohore**

Masat dhe aktivitetet e caktuara të patejkaluara kohore mundësojnë kalim më të lehtë drejt funksionimit të menaxhimit më bashkëkohorë me mbeturinat. Kompleksi i pranuar i masave teknike përbëhet nga përpunimi i planeve për adaptimin e deponive të zgjedhura, përpunimi i proekteve për rikonstruim dhe kryerja e rikonstruimit për deponitë e zgjedhura me qëllim që të tejkalohet mangësia e kapaciteteve për deponim në rrugë të deponimit kohor të mbeturinave komunale. Deponitë e këtitilla ekzistuese por të rikonstruara do të pranojnë mbeturina komunale nga komuna të ndryshme, të cilat do ta formojnë rajonin e ri për menaxhim me mbeturinat dhe do të punojnë sipas standardeve bashkëkohore për punë.

Në periudhën kalimtare, MMJPH, ME dhe krijuesit e mbeturinave do të bëjnë përpjekje të mëdha që të sigurohen zgjidhje të pranueshme kohore financiare dhe ekologjike për deponim të fraksioneve të rrezikshme të ndara në mënyrën me të cilën do të kryhen ndikimet më të vogla të mundshme ndaj mjedisit jetësor, me masat teknike sot të disponueshme dhe me zbutjen e efekteve negative nga vatrave ekologjike ndaj mjedisit jetësor.

### **Vlerësimi i investimeve të nevojshme dhe i fitimeve**

Shpenzimet kapitale totale të ndërlidhura me transponimin e Direktivave të UE-së në sferën e menaxhimit me mbeturinat në kornizën ligjore të Maqedonisë dhe zbatimi i plotë i tyre vlerësohen rreth 400 milion €.

Me qëllim që të arrihen qëllimet kryesore për tejkalimin e ndikimeve negative ndaj mjedisit jetësor të cilat i shkaktojnë mbeturinat, të identifikuara në strategjinë për menaxhim me mbeturinat, investimet prioritare në transponimin e rregullativës ligjore dhe në infrastrukturën për mbeturina të rrezikshme komunale, do të arrijnë, në nivel vjetor, rreth **1,5% nga PBM**. Kapacitetet më të sofistikuara për tretman bioteknologjik dhe termal të mbeturinave do të kërkojnë investime kapitale shtesë; këto investime do të bëhen të pashmangëshme në fund ose pas periudhës së paraparë për zbatimin e strategjisë për mbeturina.

Zbatimi i strategjisë për menaxhim me mbeturinat do të sjellë ndryshime të mëdha në sjelljen e të gjitha subjekteve të involvuara në raport me problemet me mbeturinat, gjatë përdorimit, tretmanit dhe deponimit të mbeturinave në vend, si dhe deri ke ndryshimet në kontekstin e shfrytëzimit të materialeve dhe të energjisë nga mbeturinat dhe të fraksioneve të përdorshme. Realizimi i qëllimeve kryesore strategjike në sferën e menaxhimit me mbeturinat do të rezultojnë në përfitime të mëdha për banorët dhe për shoqërinë në përgjithësi: zvoglimi i reziqeve dhe i ndikimeve për resurset e ujrave të pishëm, për ajrin, për tokën punuese dhe për shëndetin e banorëve, ekosistemet e ruajtura dhe të riparuar, vendbanimet dhe mjedisi natyror, rrezikshmëri më të vogël dhe ndotje më të vogël të

mjedisit ujqor, të tokës punuese dhe të prodhimeve bujqësore, me rritjen e shkallës së shfrytëzimit të materialit dhe potencialit energjetik të mbeturinave.

### **Pasqyrë e planit me aksione për zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat**

Që të mundësohet instalim i infrastrukturës së shëndoshë themelore teknike për menaxhim me mbeturinat komunale dhe ato të rrezikshme, duhet të sillen strukturë ligjore përkatëse, strukturë institucionale, organizative dhe strukturë tjetër ndihmëse, si dhe mjete financiare përkatëse. Nuk mund të bëhet dallimi se çka është më e rëndësishme, me që të gjitha parakushtet krijojnë kushte për funksionimin e infrastrukturës teknike. Elementet integrale dhe të gjitha çështjet e shqyrtuara e krijojnë strukturën e përgjithshme për planin me aksione për zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat.

# 1. PARAQITJA HYRËSE E ROLIT TË STRATEGJISË SË MENAXHIMIT ME MBETURINAT NË POLITIKËN E MJEDISIT JETËSOR TË MAQEDONISË.

## 1.1 Roli i Përgjithshëm i Strategjisë për Menaxhimin me Mbeturinat

Strategjia e Republikës së Maqedonisë për menaxhimin e mbeturinave

- Përcakton drejtimit bazë në sferën e menaxhimit me mbeturinat në periudhën dymbëdhjet vjeçare në vijim(2008-2020), të prira nga njohuritë se menaxhimi joadekuat i mbeturinave, sot dhe në të kaluarën, shkaktojnë pasoja serioze për mjedisin jetësor dhe natyrën;
- përcakton drejtimit bazë për vendosjen procedurale të sistemit të menaxhimit të mbeturinave në periudhën vijuese, në pajtim me qasjen bazë të Unionit European drejt menaxhimit të mbeturinave, gjatë së cilës do të merren parasysh mundësitë ekonomike;
- përcakton principet bazë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të resorëve natyror edhe për menaxhimin me mbeturinat, duke përfshirë këtu hierarkinë e parimeve bazë në menaxhimin e mbeturinave;
- udhëheq sistemin e aktiviteteve në sferën e harmonizimit të legjislaturës me *acquis communautaire* si proces i pashmangshëm në afrimin e Maqedonisë drejt anëtarësimit në Unionin European;
- përcakton kompetencat bazë për mbeturinat, vërteton rëndësinë dhe rolin e pronësisë së kapitalit, si dhe rolin dhe detyrat e subjekteve të interesuara individuale në shoqëri;
- përcakton kornizën e aktiviteteve në sferën e menaxhimit me mbeturinat, si pjesë e politikës për mbrojtjen e mjedisit jetësor, për zhvillim ekonomik dhe social;
- vendos qëllimet bazë në sistemin e menaxhimit me mbeturinat, të përcaktuara për periudhën prej 12 viteve dhe më tutje, përmes pasqyrimin të masave urgjente institucionale, organizuese, teknike dhe ekonomike për ndalimin ose zbutjen e ndikimeve ndaj mjedisit jetësor të cilat i shkakton mënyra e tanishme e menaxhimit me mbeturinat nga njëra anë dhe përmirësimi procedural i sistemit të menaxhimit me mbeturinat përmes kombinimit optimal të mekanizmave dhe instrumenteve, nga ana tjetër;
- prezanton vlerësimin e investimeve të nevojshme për realizimin e qëllimeve strategjike.

Strategjia e Republikës së Maqedonisë për menaxhimin e mbeturinave nuk i përfshin çështjet e ndërlihdura me mbeturinat radioaktive, pamarr parasysh prejardhjen e tyre, nga mjetet e vjetruara eksplozive dhe me municion, as edhe me mbeturinat nga minierat, të cilat rregullohen me ligje të veçanta. Kategoritë e mbeturinave nuk i kyçin elementet ekonomike të ndërlihdura me shfrytëzimin e materialeve ose mbeturinave për prodhimin e energjisë, e me ato edhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resorëve natyrorë, e që i karakterizon menaxhimi me mbeturinat dhe produkteve të mbeturinave në kuadër të përfshirjes së këtij dokumenti strategjik. Përrjashtim bëjnë vetëm mbeturinat e deponuara nga minierat, si mbingarkesë e mjedisit jetësorë, të ashtuquajtura „vatrat ekologjike“ të cilat shkaktojnë ndikime negative ndaj mjedisit jetësor dhe kërkojnë masa të veçanta të sanimit, si dhe mbeturinat nga blegtoaria , të cilat rregullohen me dy segmente komplementare të legjislaturës: me dispozitat e veterinarisë për menaxhimin e nus-prodhimeve të kafshëve dhe me dispozitat e mjedisit jetësor/mbeturinat.

## 1.2 Roli i Strategjisë së menaxhimit të mbeturinave në kuadër të politikës për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Republika e Maqedonisë ka përgatitur dhe ka sjellur dy ligje themelore të rëndësishme për rregullimin e menaxhimit me mbeturinat: Ligjin e mjedisit jetësor dhe Ligjin e menaxhimit të mbeturinave; çështje të caktuara nga sfera e menaxhimit me mbeturinat ose çështje të ngjajshme të rregulluara me ligje, veçanërisht me Ligjin e ndërmarrjeve publike, Ligjin e vetëqeverisjes lokale, Ligjin për ndërtim investues, Ligjin e koncesioneve dhe Ligjin për planifikim hapsinor dhe urban.

Ligji i mjedisit jetësor sjell një seri të principeve dhe obligimeve fundamentale me rëndësi kyçe për rregullimin dhe për arritjen e qëllimeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor në Maqedoni. Ai paraqet një pjesë nga baza ligjore për aktivitete të caktuara të lidhura ngushtë me menaxhimin e mbeturinave, siç janë revizionet ekologjike, dhe sidomos vlerësimin e ndikimeve ndaj mjedisit jetësor, si fazë të rëndësishme në procedurën administrative për marrjen e lejeve të integruara ekologjike dhe lejeve për harmonizim. Ligji i mjedisit jetësor, gjithashtu, parasheh sjelljen e Strategjisë Nacionale për zhvillim të qëndrueshëm me qëllim të harmonizimit të zhvillimit ekonomik, avansimin e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor në nivel nacional, ndërsa siguron edhe bazë ligjore për rregullimin e aktiviteteve të ndërlidhura me menaxhimin e mbeturinave në sferën e zbutjes së ndryshimeve klimatike, luftën kundër shkretësisht dhe parandalimin e efekteve nga thatësitrat, si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Ligji i menaxhimit të mbeturinave i përshkruan rregullat e përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me përpunimin e strategjisë, planeve dhe programeve se si të veprohet me mbeturinat në përgjithsi dhe me mbeturinat e dëmshme, në deponimin final të mbeturinave në deponitë dhe me insineracionin/ko-insineracionin, e eksport/importit/tranzitit të mbeturinave, të monitorimit, menaxhimit me mbeturinat dhe sistemit informativ, finansimit, definimin e organeve kompetente dhe mbikqyrjen edhe të dispozitave ndëshkuese.

Baza ligjore ekzistuese është pjesërisht në pajtim me legjislaturën e UE, pjesa më e madhe e akteve nënligjore dhe standardeve janë ende në fazën përgatitore, institucionet administrative dhe institucionet e obliguara për zbatimin e rregulativës ligjore ende nuk janë përforcuar deri në shkallën e nevojshme për vënien e menaxhimit bashkëkohorë me mbeturinat, të pranueshëm në aspektin e mbrojtjes së mjedisit jetësor. Mënyra e menaxhimit me mbeturinat e trashëguar nga periudha e më parshme mbetet në zbatim, me pasoja evidente ndaj mjedisit jetësor; mjedisi jetësorë ndotet dyfish me deponitë e egra të pakontrolluara.

Analiza e gjendjes së gjithanëshme me menaxhimin me mbeturinat, problemet urgjente të ndërlidhura me mbeturinat në shumicën e vetëqeverisjeve lokale, në industri dhe në shërbimet dhe dëmet evidente në mjedisin jetësor e bëjnë të shtojnë nevojën e përpunimit të strategjisë së menaxhimit të mbeturinave, ashtu siç e parasheh edhe Ligji i menaxhimit të mbeturinave. Strategjia e menaxhimit me mbeturinat do të jetë para së gjithash, *vendim i Qeverisë*, si degë ekzekutive e pushtetit në Republikën e Maqedonisë. Ajo do të paraqesë *vendimet* për qëllimet kryesore ekologjike ekonomike dhe sociale, masat dhe aktivitetet e orientuara drejt zgjidhjes së problemeve me mbeturinat dhe bazën e qartë për përgatitjen e Programit Nacional Aksional për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

### **Strategjia e menaxhimit me mbeturinat**

a) i definon qëllimet e veçanta dhe të përgjithshme fundamentale të menaxhimit me mbeturinat dhe e përcakton kornizën e qasjeve drejt menaxhimit me mbeturinat, si dhe masat e pranueshme për

ndalimin e ndikimeve të mëtutjeshme të mbeturinave mbi ujrat, tokën punuese dhe natyrën, si dhe ndaj shëndetit të njerëzve.

- b) definon zhvillimin fundamental të masave të përgjithshme të menaxhimit të mbeturinave me qëllim që të zvoglohen pasojat negative ndaj mjedisit jetësor të shkaktuara nga mbeturinat nga faza e prodhimit, përmes proceseve të shfrytëzimit dhe reciklimit të mbeturinave deri ke deponimi përfundimtar i mbeturinave nga prodhimtaria dhe nga shpenzimet.
- c) parasheh zgjidhje afatgjate për
  - zvoglimin e sasisë të të gjitha llojeve të mbeturinave të shkaktuara,
  - zvoglimin e shkallëzuar të potencialit të rrezikshmërisë së vet mbeturinave dhe si mbeturina të hudhura në deponitë,
  - kontrolli për llojet e mbeturinave të cilat shkaktohen në teritorin e Maqedonisë dhe i kalojnë shtetet kufitare në të dyja drejtimet,
  - shfrytëzimi optimal i materialeve dhe i energjisë nga llojet e mbeturinave,
  - vënia e sistemit optimal të kapaciteteve infrastrukture/përdorimi i sërishëm dhe tretmani i mbeturinave dhe sigurimi i hudhjes së sigurtë finale, i pranueshëm nga aspekti i mjedisit jetësor dhe nga aspekti ekonomik, veçanërisht i deponive.
- d) parasheh përpjekje afatgjate për
  - menaxhim të qëndrueshëm me resorët e ripërtëritura dhe jo të ripërtëritura natyrore dhe shfrytëzimin efikas të tyre në aspektin ekonomik, si dhe në aspektin e mbrojtjes së mjedisit jetësor ,
  - ndarjen e zhvillimit ekonomik nga degradimi i mjedisit jetësor, aq sa është i mundur,
  - vënien e teknologjive më të pastërta dhe shfrytëzimin e zëvendësimeve të tyre të cilat janë gjithnjë e më pak problematike për mjedisin jetësor.
- e) vlerësimin e opcioneve të volitshme për
  - finansimin e investimeve kapitale në kapacitete të reja apo të rikonstruara për tretman dhe deponimin e mbeturinave,
  - kthimin e pjesës fikse dhe variabile të shpenzimeve operative për mbledhjen, përpunimi dhe mënjanimi i mbeturinës.

Një qasje e tillë don të thotë se mbeturinat nuk shikohen vetëm si burim i ndotjes i cili duhet të zvoglohet, por edhe si zëvendësim potencial për resorët e ripërtëritura natyrore.

Por, të gjitha qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta, të gjitha masat e parapara në Strategjinë e menaxhimit me mbeturinat detyrimisht e marrin parasysh afrimin e Maqedonisë drejt integritimit evropian, zhvillimin e ekonomisë nacionale, cilësinë e mjedisit jetësor dhe të natyrës dhe ndieshmërinë e natyrës dhe resurseve natyrore.

Me Strategjinë e menaxhimit me mbeturinat konkretizohen parime të caktuara fundamentale të Ligjit për menaxhim me mbeturinat, të cilat janë të rëndësishëm për harmonizimin e dispozitave të Maqedonisë me *acquis communautaire* të UE-së dhe vendoset qasje për ndalimin ose zbutjen e ndikimeve të mëtutjeshme si pasojë e mënyrës ekzistuese të menaxhimit me mbeturinat. Si shtesë, Strategjia i vë principet themelore të Programit të Gjashtë Aksional të mjedisit jetësor (2002 –2012 ), për zhvillim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe menaxhimin e mbeturinave , por i mer para sysh dhe karakteristikat në zhvillimin e e ekonomisë së Maqedonisë dhe vëllimi i tij i vogël relevant, ndieshmëria e resurseve natyrore, sidomos ajri, mediat ujore dhe ato tokësore dhe të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Me qëllim të konkretizimit të principeve të menaxhimit me mbeturinat në Maqedoni, vendosen karakteristikat themelore të konceptit të menaxhimit me llojet kryesore të mbeturinave dhe vendosen zgjidhje të caktuara të përgjithshme konceptuale për sanimin e mbingarkimeve të identifikuara në

mjedisin jetësor, me qëllim të zbutjes së ndikimeve negative, sidomos ndaj ujrave dhe tokave. Pamarr parasysh shkallën e zhvillimit, koncepti i qëndrueshmërisë së menaxhimit me mbeturinat udhëzon fillimin e aktiviteteve në burimin e krijimit të mbeturinave. si detyrë kryesore dhe më efektive. Por, një koncept i tillë i menaxhimit me mbeturinat detyrimisht do të ketë ndikim të madh në proceset prodhuese dhe ekonominë e prodhimit dhe atë të shpenzimit, të potencialit të rrezikshëm të nus-prodhimeve, prodhimeve me afat të skaduar dhe llojeve të tjera të mbeturinave; ai, gjithashtu, do të ndikojë në aktivitetet sociale dhe pranueshmërinë e të gjitha fazave të menaxhimit me mbeturinat dhe të kapaciteteve për tretman dhe për deponimin e mbeturinave. Një ndikim i tillë i jep një *status të veçantë çështjeve të lidhura me mbeturinat*, suksesin dhe efikasitetin e zbatimit të konceptit të menaxhimit me mbeturinat të cilat varen, përveç nga investimet kapitale të nevojshme dhe hapsirave të kufizuara, para së gjithash nga instrumentet juridike të përpikta dhe bilansit të rregullt, instrumenteve organizative-sociologjike e sidomos instrumenteve ekonomike.

### **1.3 Roli i strategjisë së menaxhimit të mbeturinave në raportin midis politikës për zhvillim ekonomik dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor**

Sipas definicionit, mbeturinat janë materiale dhe lëndë të tilla të klasifikuara në kategori të mbeturinave dhe të paraqitura në listë përkatëse të mbeturinave të cilat poseduesi i tyre i hudh ose ka për qëllim ose madje edhe kërkon që të hudhen. Përgjegjsia e mbeturinave është e poseduesve të mbeturinave; por, poseduesit janë persona juridik apo fizik të cilët posedojnë mbeturina dhe paraqiten si pjestarë të shoqërisë njëkohësisht në tri role kontradiktore edhe atë:

- a) ata kujdesen për cilësinë e mjedisit jetësorë, për shëndetin dhe për cilësinë e jetesës së gjeneratave të ardhëshme, në nivel global dhe lokal,
- b) ata janë krijues të mbeturinave dhe të ndotjes së mjedisit jetësor përmes aktiviteteve të përditëshme dhe
- c) shpenzues të produkteve dhe të shërbimeve.

Shihet qartë se mbeturinat nuk janë vetëm shkaktarë të ndikimeve ndaj mjedisit jetësor, por mundet edhe të shfrytëzohen përsëri pjesërisht apo plotësisht; në këtë rast, mbeturinat paraqesin burim sekundar për prodhimin e produkteve të reja apo të energjisë. Kështu, çështjet e lidhura me mbeturinat janë njëkohësisht specifike dhe komplekse, ndërsa përgjegjsia për mbeturinat e shkaktuara është e ndarë, ashtu siç janë të ndara edhe obligimet për mbulimin e shpenzimeve midis këtyre roleve. Ky është edhe shkak pse menaxhimi me mbeturinat rregullohet me dispozita ligjore për menaxhim me mbeturinat nga mbledhja, përpunimi i materialeve dhe/ose përbërësve energjetik të mbeturinave dhe përfundimisht deponimi i mbeturinave, por ato duhet patjetër të jenë të pashmangëshme, me mbështetje të masave të gjera rregullatore nga sektorët e tjerë të shoqërisë.

Mbeturinat mund të jenë edhe ngarkesë e mjedisit jetësorë vetëm në fund të prodhimit ose shpenzimit, atëherë kur mbetjet e panevojshme duhet të deponohen në mënyrë të kontrolluar. Të gjitha fazat e shfrytëzimit të fraksioneve të mbeturinave të cilat mund të përdoren për prodhimin e produkteve të reja ose të energjisë paraqesin ruajtjen e resurseve të papërmirësueshëm natyrorë, e që është edhe një nga qëllimet kryesore të dokumenteve programore dhe të direktivave të UE-së në sferën e mjedisit jetësor.

Mbeturinat, gjithashtu, mund të shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin jetësor si pasojë e potencialit të dëmshëm që del nga përdorimi i substancave të rrezikshme për mjedisin jetësor në procesin e prodhimit të prodhimtarisë së tregut ose kur ato substanca janë krijuar gjatë vet prodhimit. Si rezultat i potencialit të lartë të ndikimeve negative ndaj mjedisit jetësor, prodhimi i sigurt për mjedisin jetësor dhe menaxhimi i rregullt i mbeturinave të dëmshme janë të një interesi më të lartë publik.

Masat për zvoglimin e sasisë së mbeturinave me një rrjedhë të brendëshme të mbyllur të materialeve në ciklet prodhuese dhe për zvoglimin e potencialit të rrezikshmërisë së mbeturinave nga prodhimtaria dhe shfrytëzimi i prodhimeve, sipas natyrës së saj, paraqet çështje të zhvillimit teknologjik. Masat kryesisht, kërkojnë investime të reja në ristrukturimin e proceseve të prodhimtarisë dhe në vënien e teknologjive të reja, e që rezulton me një shpenzim më të vogël të energjisë në procesin e prodhimtarisë dhe gjatë përdorimit të mallrave të prodhuara, si dhe me përdorimin e materialeve të reja më pak të rrezikëshme dhe më të përshtatshme për mjedisin jetësor.

Nga ana tjetër, sektori i shpenzimeve kërkon prodhime të reja dhe me këtë paraqitet si gjenerator i rritjes së prodhimtarisë dhe i prosperitetit ekonomik. Një proces i tillë krijon sasi të reja të mbeturinave dhe të nus-prodhimeve dhe duhet të vehen masa të veçanta për shfrytëzimin e asaj që kanë në dispozicion, përdorimi i fraksioneve të mbeturinave dhe për mbajtjen më shumë ose më pak konstante të sasisë së mbetjeve të papërdorshme të cilat më në fund do të deponohen.

Mbylljen e llojeve të materialeve dhe të energjisë në vet ciklet prodhuese dhe/ose lidhshmëria e fraksioneve të veçanta të mbeturinës me procese tjera prodhuese mund të rezultojnë me sasi më të vogël të mbeturinave të destinuara për deponim dhe me përmisimin e efikasitetit të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe në efikasitetin ekonomik të ndërmarjeve individuale. Nga ana tjetër, sistemet dhe teknologjitë e mbledhjes së mbeturinave të cilat janë të domosdoshme për shfrytëzimin/reciklimin e fraksioneve të përdorëshme të mbeturinave – lëndët e para sekundare – gjithashtu ofrojnë mundësi për punësime të reja për veprimtari të ndryshme shërbyes apo prodhuese.

Materialet e lëndës së parë të fituara nga llojet e mbeturinave dhe të destinuara për reciklimin e materialeve dhe për prodhimin e energjisë duhet ta gjejnë tregun e vet, d.m.th. kapacitetin e qëndrueshëm ekonomik të përpunimit. Mënyrat për arritjen e një qëndrueshmërie ekonomike dhe konkurrencës së tregut varen nga faktorë të ndryshëm.. **Çmimi i materialit të lëndës së parë të fituar nga mbeturinat nuk është krejtësisht i lënë në duart e tregut të lirë, duke pasur parasysh faktin se ato janë lëndë të politikës dhe qëllimeve të vëna nga shoqëria.** Shfrytëzimi i fraksioneve të mbeturinave si materiale të lëndës së parë u tregua si ekonomikisht atraktiv vetëm po qe se shteti vendos instrumente përkatëse ekonomike për rrjedhën e veçantë të mbeturinave, në pajtim me kërkesat për cilësi të standardizuar dhe çmimeve me të cilat do tu ofrohen këto lëndë të para sekundare janë konkurente. Përkundër faktit se mbeturinat mund të paraqesin material të lëndës së parë, d.m.th. mall tregtar, qarkullimi i tij brenda territorit të vendit, si dhe jashtë kufijve ose në kuadër të zonave të lira tregtare ose të tregjeve të brendëshme, ai duhet të mbetet nën kontroll; materiali i lëndës së parë, megjithatë, mbetet „mbeturinë“, e jo produkt klasik tregtar.

Masat e ndërlidhura me menaxhimin e mbeturinave kanë efekte të drejtpërdrejta ekonomike dhe efekte për mjedisin jetësor dhe kanë rëndësi për politikën ekonomike dhe teknologjike, si dhe për politikën shpenzuese.

Është me rëndësi që të mbizotërojë vetëdija se menaxhimi i mbeturinave çdo herë paraqet shpenzim; ky shpenzim mund të jetë më i vogël nëse shpenzimet për menaxhimin e mbeturinave dhe shfrytëzimi i mëtutjeshëm i mbeturinave si material i lëndës së parë paraqet zvoglimin e shpenzimeve për deponimin e mbeturinave. Vendosja e instrumenteve përkatëse ekonomike për balansimin e shpenzimeve për shfrytëzimin/reciklimin e mbeturinave dhe shpenzimet për deponimin e mbeturinave është njëra nga detyrat themelore dhe më të rëndësishme të politikës për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe për zhvillimin ekonomik.

#### **1.4. Përmbajtja e përgjithëshme e dokumentit strategjik për menaxhim me mbeturinat**

Strategjia për menaxhim me mbeturinat e shpreh **politikën nacionale** në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe paraqet bazë për përgaditjen dhe për zbatimin e sistemit integruar për menaxhim me

mbeturinat, i cili do të jetë efektiv në raport të harxhimeve. Në bazë të vlerësimit të ndikimit të gjendjes egzistuese në sferën e menaxhimit me mbeturinat, shqyrtohen çështjet e përgjithëshme dhe të veçanta të lidhura me menaxhimin me mbeturinat në Maqedoni.

Qëllimet e përgjithëshme dhe strategjike i shprehin obligimet e të gjitha pjesëve të shoqëris së Maqedonis në drejtim të vendosjes së sistemit bashkëkohor për menaxhim mbeturinat, në të cilat do të ndërtohen principet themelore në menaxhim me mbeturinat, do të plotësohen specifikat e caktuara në mjedisin jetësor të Maqedonis dhe do të dedikohen ndryshime të rëndësishme në tërë shoqërinë në shikim të ndërtimit procedural dhe funksionimi i sistemit të ri teknik për menaxhim me mbeturinat dhe në shikim të kombinimit të masave të lidhura në mes veti, resurset njerëzore dhe kapacitetet, planifikimi i hapsirës dhe mbrojtja e mjedisit jetësor, finansimi dhe kthimi i harxhimeve, vetëdija e subjekteve të involvuara, grumbullimi i të dhënave dhe sistemi informativ.

Baza e planit aksionar i vlerëson afatet kohore të nevojshme për zbatimin e Strategjis për menaxhim me mbeturinat dhe

- propozon prioritete, masat në mes veti të lidhura për fillim optimal me vendosjen e sistemit të ri për menaxhim me mbeturinat,
- propozon masa kohore me qëllim që të tejkalohet gjendja e përherëshme me menaxhimin me mbeturinat, dhe
- i vlerëson harxhimet dhe fitimet e nevojshme nga zbatimi i strategjis për menaxhim me mbeturinat.

## **2. PASQYRË E SHKURTËR DHE VLERËSIMI I GJENDJES SË TANISHME TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE DHE SEKTORËVE TË NGJAJSHËM ME RËNDËSINË E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË MAQEDONI.**

### **2.1 Politika e menaxhimit të mbeturinave**

Akti më i lartë juridik i Maqedonisë d.m.th. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, shënon se të gjithë kanë të drejtë për mjedis të shëndoshë jetësor dhe obligim që ta mbrojnë dhe avansojnë mjedisin jetësor dhe natyrën. Sipas kësaj, Shteti është i obliguar që t'u sigurojë qytetarëve të saj mjedis të shëndoshë jetësor.

Menaxhimi i mbeturinave është njëri ndër problemet më serioze ekologjike në Maqedoni. Politika e përgjithshme e menaxhimit të mbeturinave ishte e formuar në Planin e Parë Nacional Aksional të Mjedisit Jetësor (PNAMJ), më 1996, me qëllim të tejkalimit të gjendjes ekzistuese dhe të vendoset një sistem i qëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave. Qeveria e vendosi rrugën me kornizën e menaxhimit të mbeturinave përmes iniciativës së politikës së PNAMJ, të reviduar më 2006 (PNAMJ II), i cili i kyç, përkatësisht është në pajtim me kërkesat e UE-së. Iniciativat politike në PNAMJ dhe në strategjinë për efikasitet energjetik janë të lidhura ngusht me zbatimin e projektit të bazuar në Mekanizmin për zhvillim të pastër në Protokollin e Kiotë-s, me çka do tu mundësohen investime direkte për zvogëlim paralel të emisioneve të gazërave të qelqëta dhe ritje e prodhimit të energjisë së qëndrueshme, d.t.th. energji e ripërtëritur; në fakt sektori i mbeturinës mer pjes me 8-10% të emisioneve me CO<sub>2</sub>-ekivalente, të cilat nuk janë shumë të rëndësishëm, në emisionet e tërsishme të gazërave të qelqëta në Maqedoni.

Korniza e përgjithshme e politikës së menaxhimit të mbeturinave është vënë me Ligjin e menaxhimit të mbeturinave, i cili siguron bazën e sjelljes së akteve nënligjore dhe vendosjen e tri dokumenteve të rëndësishme politike:

- strategjia e menaxhimit të mbeturinave, me qëllim të definimit sidomos të nevojave afatgjate në sferën e menaxhimit të mbeturinave, si dhe masat e nevojshme ligjore për zbatimin e të njejtave ;
- planin për menaxhimin e mbeturinave, me të cilin vlerësohet gjendja e tanishme dhe jepen rekomandimet, aktivitetet dhe investimet themelore, si dhe mjetet dhe mekanizmat financiarë në procesin e menaxhimit të mbeturinave për periudhën e ardhëshme gjashtëvjeçare;
- programet e menaxhimit të mbeturinave, të cilët përgatiten për çdo periudhë tri vjeçare dhe miratohen nga MMJPH, nga njësit e vetëqeverisjes lokale dhe nga personat juridik dhe fizik të kyçur në fazën e realizimit të menaxhimit të mbeturinave.
- programet e menaxhimit të mbeturinave, me çka përgaditen për secilin nga periudhat trivjeçare nga personat fizik dhe juridik të inkuadruar në fazat e realizimit të menaxhimit të mbeturinave.

Në raport me dokumentin politik dhe profesionist i cili duhet të përgatitet në bazë të Ligjit të menaxhimit të mbeturinave, Planit Nacional për menaxhimin e mbeturinave (PNMM) u përgatit në projekt-version në vitin 2005 (MMJPH); projekt dokumenti ishte i themeluar në studimet e veçanta të lidhura me të gjitha çështjet themelore në sferën e menaxhimit të mbeturinave në Maqedoni.

Por, për momentin orientimet nacionale, politika dhe legjislatura janë edhe më tej të pamjaftueshme në disa sfera që ti përgjigjen kërkesave të sektorit të mbeturinave. Politika Nacionale e menaxhimit të mbeturinave nuk është mjaft e zhvilluar, sepse politika ekzistuese nuk i përfshin të gjitha sferat kyçe të punëve në sferën e menaxhimit të mbeturinave, nuk ekziston një bazë e qartë për përcaktimin e

prioriteteve, kërkesat për efektivitet ose për qëllimet, kurse standardet e nevojshme të menaxhimit të mbeturinave mbeten të vështira për implementim.

## **2.2 Korniza ligjore ekzistuese dhe aktivitetet e transponimit**

Maqedonia po kalon në fazën e një zhvillimi intenziv të legjislaturës në sferën e menaxhimit të mbeturinave. Për momentin, regulativa ligjore themelore nacionale e menaxhimit të mbeturinave përbëhet vetëm nga Ligji i menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, ky akt ligjor kontribuon në masë të madhe drejt procesit të aderimit përmes vënies së sistemit bashkëkohorë dhe gjithpërfshirës të menaxhimit të mbeturinave, i zënë fill në direktivat themelore të UE-së për mbeturinat në përgjithësi dhe për mbeturinat e rrezikëshme. Ligji i menaxhimit të mbeturinave si akt themelor ligjor i përshkruan rregullat e përgjithshme të cilat zbatohen për çështjet në vijim: definicionet dhe zbatueshmëria e llojeve të mbeturinave, përpunimi i strategjisë, planet dhe programet e niveleve të ndryshme, procedurat e menaxhimit të mbeturinave dhe dhënia e lejeve përkatëse; deponitë, insenerimi dhe ko-insenerimi i mbeturinave, importi, eksporti dhe transporti i mbeturinave, monitorimi, informimi, menaxhimi me të dhënat, mbikqyrja nga organet kompetente, dispozitat ndëshkuese, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Por, me të nuk rregullohet menaxhimi i mbeturinave të minierave, ndërsa vetëm pjesërisht menaxhimi i mbeturinave i cili përfshihet në dispozitat e veterinerëve. Transponimi i direktivave themelore të UE-së për menaxhimin e mbeturinave në kornizën ligjore maqedonase vazhdon me përgatitjen dhe miratimin e obligimeve dhe rregullave të mbeturinave të rrezikëshme për vajrat e mbeturinave, për paketimin dhe mbeturinat nga paketimet, për mënjanimin e PCB/PCT (polikloruret bifenile dhe polikloruret trefenile) dhe bateritë dhe akulumatorët, për mbeturinat nga pajisja elektrike dhe elektronike dhe automjete të vjetra, përshkak të sigurimit të bazës së nevojshme ligjore për përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e akteve nënligjore. Duhet të përgatiten akte nënligjore më të rëndësishme (rregullore, drejtime, standarde) për çështjet e definuara në Ligjin e menaxhimit të mbeturinave me qëllim që Ligji të bëhet operativ.

Ligji i menaxhimit të mbeturinave ka lidhshmëri të rëndësishme me aktet e tjera ligjore, sidomos me Ligjin e mjedisit jetësor, i cili përfshin çështjet themelore, siç janë lejet ekologjike, procedurën e vlerësimit të ndikimeve ndaj mjedisit jetësor, emisionet e gazrave të qelqta. Ky, gjithashtu, është i lidhur ngusht me dispozitat e tjera, siç janë Ligji i organizimit të organeve të administratës shtetërore, Ligji i vetëqeverisjes lokale, Ligji i ndërmarrjeve publike, Ligji i planifikimit hapsinor dhe urban, Ligji i investimeve ndërtimore, Ligji i koncesioneve, Ligji i furnizimeve publike dhe Propozim-ligji i ujrave, të cilët janë lëndë shqyrtimi dhe ndryshimi në Qeveri dhe në Kuvend.

## **2.3 Statusi i tanishëm i institucioneve dhe i organeve kompetente**

Organi kompetent për përgatitjen dhe sjelljen e të gjitha instrumenteve dhe për zbatimin e të gjitha direktivave relevante për mbeturinat është MMJPH, si organ i administratës publike kompetent për çështjet nga sfera e mjedisit jetësor. Organe kompetente për kryerjen e inspektimeve dhe detyrave të tjera mbikqyrëse, janë kryesisht, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor (MMJPH) dhe organet lokale inspektuese (komunat dhe Qyteti i Shkupit). Shpërndarja e brendëshme e detyrave dhe kompetencave në kuadër të MMJPH ekziston në bazë të strukturës së tanishme të MMJPH; përsosshmëria e vetme më e rëndësishme drejt detyrave të reja në sferën e menaxhimit të mbeturinave është formimi i sektorit të ri për menaxhimin e mbeturinave, me diapazon të gjerë të aktiviteve dhe kompetencave: planifikimi, miratimi dhe zbatimi i standardeve dhe regjimeve pranë menaxhimit me lloje të ndryshme të mbeturinave, monitorimit dhënia e lejeve për mbledhësit, transportuesit, eksportuesit dhe operatorët e mbeturinave në kapacitetet e menaxhimit me mbeturinat. Përgatitja e legjislaturës themelore, primare dhe sekundare vazhdon dhe dërgohet së bashku/në bashkëpunim/ përmes konsultimeve/në pajtim me ministrinë e tjera dhe organeve kompetente, por duket se ka paqartësi në çështjen e rolit dhe kompetencave, ndërsa ka edhe mungesë komunikimi dhe koordinimi.

**Detyrat dhe kompetencat** në sferën e menaxhimit me mbeturinat, në praktikë, janë ndarë midis disa **institucioneve** në vend, ndërsa shpesh ndodh përputhje e brendëshme në mes institucioneve qeveritare, si dhe në mes institucioneve qeveritare dhe komunale. Gjithashtu, disa aktivitete mungojnë, siç janë me siguri analizat e karakteristikave/pjesët përbërëse të mbeturinave ose mungesë e regjistrimit të personave të cilët merren me mbeturinat; një situatë e tillë vështirëson detyrat e inspektimit, kontabilitetit, informimit dhe zbatimit të menaxhimit përkatës me mbeturinat e dëmshme në nivel nacional dhe krahas regjistrimit të krijuesve të mbeturinave.

Në lidhje me çështjen e lidhur me menaxhimin e mbeturinave, Ministria e Ekonomisë (ME) dhe MMJPH janë të obliguar së bashku të përgatisin disa dispozita, të cilat kanë të bëjnë me paketimin dhe mbeturinave nga paketimi. Mbikqyrja inspektuese ndaj përmbushjes së kushteve lidhur me prodhimet dhe kompetencat e Inspektoratit Shtetëror Tregtar (në përbërje të ME). Ministria e Financave luan rol të rëndësishëm në sjelljen e vendimeve dhe në zbatimin e instrumenteve efektive financiare/ekonomike dhe fondeve për nxitjen e zhvillimit dhe menaxhimit me mbeturinat. Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe MMJPH gjithashtu janë të obliguara që të përgatisin, të sjellin dhe të bëjnë mbikqyrjen mbi dispozitat e menaxhimit me mbeturinat medicinale dhe mbi menaxhimin me helmet; nuk ekzistonte ndarje e qartë e kompetencave në lidhje me inspektimin ndaj çështjeve të lidhura me mbeturinat medicinale. Mbledhja, tretmani dhe deponimi final i nus-prodhimeve të kafshëve dhe mbikqyrja mbi substancat aktive për mbrojtjen e bimëve janë nën kompetencat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (MBP). Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (MTL), është kompetente për dhënien e lejeve për transport të mbeturinave të rrezikëshme, si dhe ka kompetencë në kontrollin e ndërmarrjeve komunale nëpërmes Inspektoratit komunal shtetëror.

Me procesin e decentralizimit në vend, shumë kompetenca u janë deleguar **komunave**. Komunitat janë kompetente për aktivitete të rëndësishme: organizimin e mbledhjes, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale; mbikqyrja e transportit dhe deponimit të mbeturinave të parrezikëshme industriale, sjellja e vendimeve për lokacionin e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave, miratimin e dispozitave për menaxhimin e mbeturinave në nivel lokal, finansimi dhe mbikqyrja mbi mbylljen e deponive të egra dhe mbyllja e kapaciteteve të menaxhimit të mbeturinave. Shqetëson fakti se komunitat japin leje ndërtimi edhe atëherë kur bëhet fjalë për investimet e tyre personale dhe japin madje edhe leje ekologjike (leje B sipas (PIKN). Krijimi i deponive për mbeturinat e parrezikëshme dhe interte është gjithashtu nën kompetencat e komunave; por dhënia e lejeve, inspektimi dhe monitorimi në lidhje me çështjet nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetësor, në përjashtim të deponive për mbeturina inerte, është nën kompetencat e MMJPH. Mirëpo, vetëm disa nga komunitat kanë formuar departamente ose persona të emruar për menaxhimin e mbeturinave në strukturën e saj administrative; do të duhet të bëhen përpjekje të mëdha që të vendosen institucione lokale, profesionale dhe administrative, si dhe organizatat operative midis komunale d.t.th nivel rajonal, të cilat duhet të pranohen nga të gjitha komunitat e involvuara.

Detyrat dhe kompetencat e MMJPH për menaxhimin e mbeturinave, krahas përgatitjes dhe miratimit të instrumenteve juridike, në përgjithësi kanë karakter institucional: planifikimi dhe zhvillimi i politikave; regjistrimi, dhënia e lejeve, monitorimi, mbledhja/menaxhimi i të dhënave, mbajtja e bazës së të dhënave dhe lajmërimi; inspektimi dhe llojet e tjera të zbatimit të dispozitave. Është e qartë se të gjitha institucionet në përbërje të MMJPH dhe komunave të cilat i kryejnë detyrat kryesore në sferën e menaxhimit të mbeturinave nuk kanë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për përgatitjen dhe zbatimin e të gjitha standardeve dhe instrumenteve relevante, sipas kërkesave të rregulativës së re ligjore për mbeturinat. Me qëllim që të arrihet një koordinim, monitorim dhe realizim i menaxhimit të mbeturinave sa më efikas, në Maqedoni, të gjitha institucionet duhet patjetër **ti përforcojnë kapacitetet e tyre** me reorganizim dhe mjete financiare shtesë, me punësime të reja dhe me zbatimin e trajnimit përkatës të ekspertëve në nivel lokal, rajonal dhe nacional.

Mbledhja, tretmani dhe deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave, pa marr parasysh cilësitë e tyre të rrezikëshme, i ekzekutojnë **subjektet e tjera** në procesin e menaxhimit të mbeturinave: ndërmarrjet publike, personat që merren me mbeturinat dhe mbledhësit joformal të fraksionit të përdorshëm të mbeturinave; disa ndërmarrje kanë dhe trajtojnë kapacitetet dhe deponitë vetanake të menaxhimit të mbeturinave. Por, përkundër bazës ligjore ekzistuese për mbledhjen, evidentimin dhe lajmërimin për

mbeturinat që hyjnë/dalin nga procesi i menaxhimit të mbeturinave, mungon monitorimi i mjedisit jetësor i kapaciteteve të menaxhimit të mbeturinave, ndërsa mungon edhe funksionimi i sistemit për evidentimin e të dhënave dhe lajmërimit.

Subjektet e tjera institucionale të involvuara në proceset e menaxhimit me mbeturinat dhe në zhvillimin në këtë sferë u bashkuan, siç janë Oda Ekonomike, Unioni i Shërbimeve Publike, Unioni i menaxhuesve të mbeturinave, Organizatat Joqeveritare dhe Institucionet Shkencore të Universitetit; roli i tyre përfshin, veçanërisht konsultime në lidhje me regulativën ligjore, funksionimin dhe finansimin e menaxhimit me mbeturinat, përcaktimin e raporteve midis parametrave ekologjike, zhvillimin e teknologjive për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe monitorimin dhe përfaqësimin e interesave të grupeve të ndryshme të shoqërisë në lidhje me çështjet nga sfera e menaxhimit me mbeturinat në vend.

Por, komunikimi përgatitja e drejtimeve dhe zbatimi i trajnimeve janë pjesa më e dobët në punën e MMJPH. Nuk egziston sistem organizues për mbledhje të rregullta në mes MMJPH dhe komunat, industria apo subjektet e tjera të interesuara, për këmbimin e informatave për menaxhimin me mbeturinat, ndërsa mungojnë edhe drejtimit për zbatimin e rregullativës ligjore për mbeturinat. Nuk ka masa të vendosura për përparimin e dialogut midis palëve të interesuara dhe organeve kompetente para se të vehen procedura të reja për rregullimin e mbeturinave, si dhe masave për promovimin e dialogut midis palëve të interesuara dhe organeve kompetente në raport të përgatitjes dhe zbatimit të programit për komunikim. Masat e tilla duhet ti stimulojë krijuesit e mbeturinave që të çojnë ato në sasi sa më të vogël të mundshme të mbeturinave dhe ti shfrytëzojnë të njejtat sipas hierarkisë së menaxhimit me mbeturinat.

## **2.5 Vetëdija tek subjektet e interesuara dhe publiku më i gjerë/konsultim**

Niveli i përgjithshëm i vetëdijes për mjedisin jetësor në Maqedoni është i ulët dhe informimi për problemet ekologjike nuk është i mjaftueshëm. Në fakt, njerëzit nuk janë të vetëdijshëm për problemet me mbeturinat dhe për efektet negative mbi shëndetin e tyre dhe mbi mjedisin jetësor dhe natyrën. Njerëzit dhe industria nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet potenciale nga mbeturinat e rrezikëshme. Njerëzit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre vetanake dhe rolin si prodhues të mbeturinave dhe aktorë në zvoglimin e mbeturinave. Sasia në rritje e mbeturinave të krijuara është pasojë në masë të madhe e sjelljes dhe e zgjedhjes së shpenzuesve të painformuar. Ekziston dijeni e kufizuar për atë se çka do të thotë deponi sanitare e projektuar dhe e menaxhuar sipas standardeve bashkëkohore, ndërsa njerëzit janë mësuar dhe e kanë pranuar deponimin e egër të mbeturinave. Gjithashtu, mungon edhe mirëkuptimi i rëndësisë së pagesës së shërbimeve për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave; një pjesë e madhe e banorëve nuk i paguajnë kompensimet për mbledhjen dhe mënjanimin e mbeturinave.

Mungon strategjia nacionale për informimin me qëllim të ngritjes së vetëdijes publike në lidhje me problemet me mbeturinat; por me kapacitetin e pamjaftueshëm institucional nuk mundet që të përparohet vetëdija publike dhe edukimi i publikut. Ndërmarrjet publike komunale vuajnë nga mungesa e mjeteve financiare dhe nga paisjet e vjetruara për mbledhjen e mbeturinave dhe me përjashtime të shpeshta nuk u kushtojnë kujdes zhvillimit të vetëdijes dhe edukimit të publikut.

Krahas vetëdijes së ulët publike dhe vetëdijes së ulët të krijuesit e mbeturinave, qëndrimet e publikut mund të manifestohen fuqishëm përmes kundërshtimit të rrept drejt ndryshimeve të domosdoshme në praktikën ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave. Këto qëndrime publike bazohen në frikën reale dhe brengosjen e qytetarëve, ndërsa përgjithësisht jo në shpenzimet shtesë të cilat duhet të paguhet për mbledhjen dhe deponimin e rregullt të mbeturinave. Njëra nga arsyt kryesore për kundërshtimin dhe informimin e pamjaftueshëm dhe qasjen e publikut deri ke informatat për sa i përket mbeturinave komunale, mbeturinave medicinale, mbeturinave të rrezikëshme, dhe llojet tjera të mbeturinave që e prodhojnë sektorin prodhues/shërbyes/bujqësor, për rreziqet e tyre për shëndetin dhe për mjedisin

jetësor dhe për opcionet për menaxhimin e të njejtave. Dy efekte plotësuese sociale, gjithashtu, nuk mundën që të mos vërehen: efekti “vetëm të mos jetë në oborin tim” dhe efekti “ nuk është në kohën e zgjedhjeve të mia”.

Në Maqedoni, ka përpjekje të kufizuara për përpunimin e programit gjithpërfshirës dhe instrumenteve për krijimin e vetëdijes publike ke qytetarët për problemin e mbeturinave. Në fakt, të gjitha iniciativat rrjedhin nga organizatat joqeveritare, me përjashtime të rralla kur komunat zhvillojnë strategji afatgjate për edukimin e mjedisit jetësor për bashkësitë e tyre, përfshirë këtu edukimin për mbeturinat.

## 2.6 Çështjet ekonomike

Burimet e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve dhe për finansimin e menaxhimit me mbeturinat janë kompensimet kryesore direkte për transportin dhe për deponimin e mbeturinave. Investimet në infrastrukturën për menaxhimin me mbeturinat, nëse ekzistojnë të tilla, finansohen nga ndihmat e pakthyeshme dhe nga buxheti vjetor i shtetit dhe komunave.

Komunat janë, në përgjithësi, përgjegjëse për organizimin e sistemit efektiv për menaxhimin me mbeturinat e ashpra në teritorin e tyre, përveç për mbeturinat e rrezikëshme, të cilat sipas dispozitave ligjore janë nën kompetencat e shtetit. Ndërmarrjet publike sigurojnë shërbime komunale (kryesisht në rajonet e qyteteve), të cilat përbëhen nga menaxhimi me mbeturinën e fort komunale, gjegjësisht grumbullimi, transporti dhe deponimi, në llogari të komunave.

Finansimi i aktiviteteve të ndërmarrjeve publike ( mbledhja, transporti dhe deponimi i mbeturinave) bazohet në arkëtimin e kompensimeve nga shfrytëzuesit të cilët arkëtohen nga krijuesit e mbeturinave nga ana e ndërmarrjes. Kompensimet i caktojnë ndërmarrjet publike, me konsultimin dhe me miratimin e këshillave të komunave. Kompensimet për sigurimin e shërbimeve janë përcaktuar sipas kategorive të ndryshme të mbeturinave të shkaktuara.

Në përgjithësi, komunat nuk shpërndajnë mjete për finansimin e veprimit me mbeturinat. Gjendja financiare e ndërmarrjeve publike përkeqësohet për shkak të rënies së ekonomisë. Gjendja e tillë ndikon negativisht edhe në kthimin e shpenzimeve, e që krijon jaz midis lartësisë së tanishme të kompensimeve, shkallës së ulët të arkëtimin të kompensimeve dhe shpenzimet reale për kryerjen e shërbimeve. Asnjëra nga ndërmarrjet ekzistuese nuk punon në nivelin e pranueshëm teknik, pa kujdesin dhe brengën e panevojshme për mirëmbajtjen e paisjeve dhe për gjetjen e mënyrës së zëvendësimit të paisjeve.

Vendimet për rritjen e kompensimeve janë bazuar në rritjen e shpenzimeve ose TVSH, ndarja e veprimit të mbeturinave nga shërbimet e tjera komunale dhe/ose zvoglimi i efikasitetit të arkëtimin të kompensimeve. Ndryshimet në kompënzimin e shërbimeve të menaxhimit me mbeturinat shpesh herë nuk janë rezultat i përmirësimit të shërbimit, ndërsa ndonjëherë edhe keq përdoren nga arsyet lokale politike.

Finansimi i shpenzimeve për menaxhimin e mbeturinave të forta komunale sigurohet përmes kompensimeve të shfrytëzuesve të cilët i paguajnë shfrytëzuesit e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave, për shembull amvisritë. Këto kompensime fakturohen dhe arkëtohen direkt nga ndërmarrjet komunale, e jo nga komunat, e që mund ta pengojë zhvillimin drejt rritjes së pjesëmarrjes së sektorit privat në aktivitetet për mbledhjen e mbeturinave. Baza për përcaktimin e lartësisë së kompensimit dallohet midis komunave.

Problemet kyçe në lidhje me *kthimin e shpenzimeve dhe finansimin* e tanishëm janë:

- Me një përjashtim, sistemi ekzistues për imponimin dhe arkëtimin e kompensimeve për shfrytëzimin e shërbimeve për menaxhimin me mbeturinat komunale janë themeluar në kompënzimin fiks për m<sup>2</sup> për banesë / shtëpi ose kompënzim i barabartë (paushall) për amvisri/muaj.

- Kompenzimet për shërbimet të cilat i paguajnë amvisritë dhe krijuesit e tjerë të mbeturinave komunale janë relativisht të ulëta ( dhe mjaft dallohen në pjesë të ndryshme të vendit). Për çdo rast, përqindja e atyre që nuk paguajnë shpesh është e lartë.
- Për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave industriale dhe komerciale, ndërmarrjet publike arkëtojnë kompensim të barabartë, sipas tarifave më të larta se sa për mbeturinat e forta komunale. Përcaktimi i tarifave për mbeturinat industriale dhe komerciale, kryesisht është bazuar në m<sup>2</sup> sipërfaqja e mbuluar ose kompenzim i rregullt mujor, shumë rrallë mangësitë bazohen në madhësinë e kantajnerëve ose përcaktohen për çdo rast veçmas.
- Tarifat i cakton çdo komunë në konsultim me shërbyesit komunal, por ata bazohen në atë që llogaritet si e kapshme/e pranueshme, e jo në shpenzimet reale për sigurimin e shërbimeve.
- Në pjesën më të madhe të rasteve, tarifat e tanishme / lartësitë e kompenzimeve nuk i mbulojnë as shpenzimet e plota për sigurimin e shërbimeve ekzistuese dhe kapacitetet e ndërmarrjeve komunale; Shpenzimet për zhvillimin dhe për zbatimin e sistemeve të reja dhe kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat në pajtim me standerdet e UE-së nuk përfshihen.
- Shpenzimet e vërteta për sigurimin e shërbimeve dhe kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave rrallë janë të njohur për ata që japin shërbime ose të njohur nga shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Ndërmarrjet komunale / dhënësit e shërbimeve janë në përgjithsi joefikas në shfrytëzimin e tyre të mjeteve, ndoshta si pasojë e mungesës të presionit konkurrues.
- Raporti midis komunave, përgjegjësia e të cilave është ti organizojë shërbimet e mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave për qytetarët e saj dhe dhënësit e shërbimeve (për momentin, pothuajse në të gjithë rastet, ndërmarrjet publike komunale) është jotransparent dhe i mungon përgjegjësia.
- Komunitat janë krejtësisht të kufizuara në aftësinë e tyre që të mobilizojnë mjete financiare për investime kapitale për infrastrukturën dhe për paisjen për menaxhimin me mbeturinat, dhe kështu shumë pak mund të besojmë se gjendja mund të ndryshojë në një të afërme të shpejtë.
- Pagesë me kusht e kompenzimeve për shërbimet nuk mundet që të kryhet përshkak të vendimeve ligjore, të cilat japin prioritet për mbrojtjen e shfrytëzuesit individual mbi interesin publik dhe menaxhimi me mbeturinat e trajtojnë si kategori të ndihmës sociale.

Në fazën e tanishme të zhvillimit institucional dhe ekonomik në Maqedoni, rrethveprimi praktik për zbatimin e *instrumenteve financiare/ekonomike* është i kufizuar. Taksat ekologjike të cilat i paguajnë shkaktuesit e mbeturinave në bazë të sasisë së krijuar të mbeturinave të rrezikëshme/parrrezikëshme, sipas lloit/sasisë së mbeturinave të importuara dhe të prodhuara nga prodhimet plastike dhe paketimi i masave plastike, sipas lloit/sasisë së mbetjeve nga mbeturinat e importuara dhe mbetjet për prodhimin e akumulatorëve të plumbit dhe sipas lloit/sasisë së mbetjeve nga importet ose prodhimet e naftës vajrat dhe mbeturinat e vajrave, bëhen pjesë e Buxhetit integral shtetërorë; kompenzimet e arkëtuara paraqesin bazën për finansimin e aktiviteteve prioritare në sferën e mjedisit jetësor; programet për menaxhimin me mbeturinat janë në konkurrencë me programet e tjera për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Shërbimet e menaxhimit me mbeturinat e forta, pothuajse në tërësi, sigurohen nga shërbimet publike komunale. Involvimi *i sektorit privat* është i kufizuar dhe nuk është i përmbajtur qartë me tenderët konkurrent zyrtar dhe me politikën dhe procedurën për lidhjen e kontratave. Shkalla e tanishme e ulët e arkëtimit të kompenzimeve për shërbimet dhe gjendja e keqe financiare në shumë komuna paraqesin reziqe, kurse reziqet të lidhura me kontekstin ligjor dhe institucional, problemet me konkurrencën dhe gjendjen politike e kufizojnë vëllimin për sjelljen e konkurrencës në shërbimet e menaxhimit me mbeturinat dhe pjesëmarrja e sektorit privat në investime.

*Sanimi i vatrave ekologjike* mund të finansohet në bazë të secilit rast individual, për shkak të mungesës së dispozitave të rregullatorëve në ligjet për privatizim dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor

(përgjegjësia për mjedisin jetësor), si dhe për shkak të mungesës së kornizës institucionale dhe mekanizmave për finansim.

## **2.7 Llojet ekzistuese të mbeturinave dhe përvojat e menaxhimit me mbeturinat**

Mbledhja, transporti dhe deponimi e përbëjnë metodën e rregullt kryesore për menjanimin e pothuajse të çdo fraksioni të mbeturinave. Objektet dhe kapacitetet ekzistuese për tretman dhe për deponimin e mbeturinave nuk janë adekuat, rregullativa ligjore dhe standardet nuk zbatohen me efikasitet, ndërsa praktikat e deri tanishme të menaxhimit me mbeturinat kontribuojnë për ndotjen e ajrit, resurseve ujore dhe tokës punuese. Sasia e përgjithshme e mbeturinave e krijuar nga minierat, vlerësohet rreth 26 milion ton/në vit. Fraksioni kryesor i mbeturinave rrjedh nga gërmimi i mineraleve dhe nga përpunimi i xeheve ( rreth 17,3 milion ton/në vit); menaxhimi me këtë lloj të mbeturinave rregullohet me Ligjin për lëndë të para minerale. Por ky grup i mbeturinave përmban sasi të mëdha të pjesëve përbërëse të rrezikëshme, ndërsa deponimi joadekuat shkakton pasojat më evidente ndaj mjedisit jetësor. Mbeturinat bujqësore me rreth 4,9 milion ton/ në vit plehra të kafshëve dhe me 0,6 milion ton/në vit mbeturina bimore paraqet të dytën me radhë për nga madhësia e fraksioneve të mbeturinave, kryesisht e emruar si nus-prodhim, d.m.th. këto lloje të mbeturinave paraqesin fraksionet të cilat mund të reciklohen në aktivitetet bujqësore. Menaxhimi me nus-prodhimet nga thertoret dhe nga kafshët e ngordhura të fermave është larg kërkesës së rregullativës ligjore përkatëse të UE-së.

Mbeturinat e forta komunale janë njëra nga llojet kryesore të mbeturinave që krijohen (rreth 570,000 ton/në vit, me prognozim që të rritet rreth 1,7% në vit dhe të arihet 700.000 ton/në vit në vitin 2020, ose 285-350kg/ banëor/në vit) dhe përbëhet nga mbeturinat nga amvisria, pastrimi i rrugëve dhe mbeturinat e parqeve, mbeturinat komerciale institucionale dhe mbeturinat të cilat krijohen në industri me karakter të ngjashëm të mbeturinave nga amvisria. Një pjesë e vogël e mbeturinave nga amvisria ka cilësi të rrezikëshme( bateritë që përmbajnë metale të forta dhe acide, ngjyra të vajit dhe tretës...).

Përqindje të rëndësishme nga rrjedha e përgjithshme e mbeturinave rrjedh nga prodhimet e shpenzuara dhe prodhimet e ndryshme të shfrytëzuara siç janë mbetjet dhe mbeturinat urbane (rreth 500.000 ton/në vit), gome të përdoruar, akumulatorë, automjete të shfrytëzuara, mbeturina elektrike/elektronike, në sasi të përgjithshme rreth 40,000 ton/në vit. Mbeturina e ndërtimitarë dhe mbetjet urbane përmbajnë dhe asbest si mbeturin e veçant me cilësi të rrezikëshme. Menaxhimi me këto fraksione, të cilat mund të përmbajnë pjesë përbërëse të lëndëve djegëse dhe të rrezikëshme, nuk zbatohet në pajtim me direktivat e UE-së dhe pothuajse i tërë fraksioni i mbledhur deponohet ose hudhet në deponitë e egra.

Qendrat energjetike, termo-metalurgjike dhe proceset joorganike kimike krijojnë një grup shtesë të mbeturinave të parrrezikëshme në sasi prej rreth 2 milion ton/në vit; krijuesit kryesorë i deponojnë mbeturinat e tyre lokale, përderisa krijuesit më të vegjël i deponojnë ato së bashku me mbeturinat komunale.

Sasit kryesore të mbeturinave të dëmshme (rreth 77,500 ton/në vit ) krijohen nga dy kapacitetet më të mëdha metalurgjiko-industriale dhe deponohen në deponitë industriale. Ato paraqesin vatër ekologjike me ndikimin e tyre ndaj mjedisit jetësor. Një pjesë e mbeturinave të materialeve të vajrave djegëse digjen si lëndë djegëse.

Incinitivat nacionale për zvoglimin e mbeturinave në nivel të amvisrisë dhe industrial mungojnë në disa sfera. Krijuesit e mbeturinave nuk janë të vetëdijshëm për mundësitë potenciale dhe për përfitimet nga to, për mundësinë e parandalimit të mbeturinave, informatat për mundësitë dhe për teknikat e parandalimit të mbeturinave nuk janë të disponueshme sa duhet, shpenzimet e vërteta për menaxhim të shëndoshë ekologjik me mbeturinat nuk dihen dhe nuk mbulohen nga krijuesit e mbeturinave, resorët, përfshir këtu edhe resurset finansuese të menaxhimit të mbeturinave, nuk shfrytëzohen

fuqishëm, ndërsa kërkesa për tretmanin e mbeturinave është më e madhe se sa duhet të jetë, nëse meret para sysh cilësia e shërbimeve që sigurohen.

### **2.7.1 Mbledhja dhe transporti i mbeturinave**

Mbledhjen e mbeturinave komunale e kryejnë, kryesisht, ndërmarrjet publike. Vetëm një numër i vogël i mbledhësve janë ndërmarrje private, kryesisht ato të cilat punojnë me mbeturinat në vendbanimet rurale.

Rreth 70% nga popullata e përgjithshme i shfrytëzon shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, por vetëm 10% nga këto në vendbanimet rurale. Mbledhja, selektimi dhe transporti i mbeturinave nuk është i mjaftueshëm në disa sfera që të arrihet respektimi i rregullave ekzistuese. Një pjesë e madhe e mbeturinave tepron, ndërsa automjetet për mbledhjen e mbeturinave janë shumë të vjetra, me kapacitet të vogël dhe shpeshherë të prishura. Nga shfrytëzuesit e shërbimeve mbledhen mbeturinat e përziera industriale dhe komunale, përfshirë këtu edhe fraksionet e rrezikëshme të mbeturinave. Aktivitetet ditore zakonisht karakterizohen me praktika produktive dhe shfrytëzim joadekuat të resurseve ekzistuese, e që nuk nxisin sigurimin e shërbimeve të cilat do të jenë më efikase në krahasim me shpenzimet.

Nuk bëhet mbledhja e selektuar e mbeturinave, përveç e një pjese të caktuar masive të mbeturinave në Shkup dhe mbeturinat organike në komunën e Zërnovcit.

Nuk ekzistojnë sisteme formale për mbledhjen nga mbetjet e mbeturinave urbane.

Mbeturinat e metalit përbëjnë pjesën më të madhe të mbeturinave të mbledhura për reciklim. Ka rrjet të formuar mirë të mbledhësve dhe/ose blerës, si dhe treg stabil dhe të fortë për mbledhjen e metaleve të vjetra.

Në pjesën më të madhe mbledhet plastikë e fortë, përfshirë këtu edhe HDPE, PVC, polipropilet dhe polistirenet. Këto rrjedhin nga akumulatorët dhe automjetet havarike, gypa, makina të vjetra dhe kantajnere. Plastika PET për momentin nuk mblidhet, për shkak të sistemit të shtrejtë të mbledhjes. Gjithashtu nuk ekziston sistem për mbledhjen e plastikës e cila rrjedh nga prodhimtaria oranzherike dhe prodhimtaria e silazhit.

Për momentin nuk ka sistem për mbledhjen e motoreve të vjetër të vajrave dhe emulzione ose çfarë do qoftë mbledhje të organizuara të automjeteve të vjetra. Mbeturinat e automobilave mblidhen kryesisht nga sektori joformal. Bëhet vetëm mbledhja e një pjese të gomave të shkaktuara brenda një viti.

Mbeturinat e parrrezikëshme industriale mblidhen, kryesisht, së bashku me mbeturinat komunale. Në përgjithësi, krijuesit e mbeturinave të rrezikëshme nuk bëjnë selektimin e mbeturinave të tyre industriale, por i përziejnë llojet e ndryshme të mbeturinave të rrezikëshme me mbeturinat e tjera, jo të rrezikëshme. Nëse bëhet selektimi i caktuar, atëherë ajo bëhet kryesisht sipas kërkesave të tregut, d.m.th. ndahen vetëm ato mbeturina të rrezikëshme të cilat nuk mund të shiten. Mbledhës dhe transportues të licencuar të mbeturinës së rrezikëshme zyrtarisht në vendin tonë nuk ka.

Sa i përket mbeturinave të shkaktuara dhe të mbledhura në institucionet shëndetësore, niveli i separacionit dhe i veprimit të drejtë me mbeturinën e rrezikëshme dhe me mbeturinën tjetër të parrrezikëshme medicinale është shumë i ulët. Mbeturinat e rrezikëshme medicinale mbledhen ndaras vetëm në spitalet e Kumanovës dhe të Shkupit.

## 2.7.2 Tretmani, shfrytëzimi dhe reciklimi

Aktivitetet për shfrytëzimin dhe reciklimin e mbeturinave komunale janë shumë të kufizuara dhe pa kurrfar qasje të organizimit. Nuk ka iniciativë në nivelin lokal për organizimin e selektimit dhe reciklimit të mbeturinave komunale. Në pjesën më të madhe, me reciklim ( trolle për metal të vjetër) merren kompanitë private.

Grumbullimi i materialeve të cilat mund të reciklohen, siç janë metalet, letrat, plastikat, akumulatorët e automjeteve, mbeturinat e vajrave dhe të ngjashme, bëhet nga sektori joformal. Shfrytëzimi i shumë llojeve të materialeve të cilat mund potencialisht të reciklohen finansiarisht është e pallogaritëshme në rrethanat e tanishme. Shpenzimet logjistike për sistem formal të reciklimit të letrës mbulohen vetëm me çmimin shitës të letrës. Sektori joformal, i cili i ka marr resurset nuk shfrytëzohen me efikasitet me përfitimet dhe pasojat aktuale dhe potencialet ekonomike ndaj mjedisit jetësor.

Tregu i letrës dhe kartonit është i ndarë në dy pjesë: një pjesë (rreth 20%) është e organizuar nga fabrika e letrës „Komuna“, me zbatimin e „Punkteve mbledhëse“, ndërsa pjesën tjetër e mbledh sektori joformal. Fabrika e letrës „Komuna“ nuk i shfrytëzon të gjitha fraksionet e mbledhjes së letrës për shkak të kufizimeve tregtare dhe në pjesën më të madhe për shkak të kushteve të pagesës së shfrytëzuesit të fundit.

Për momentin, kapaciteti i reciklimit, shfrytëzimi i sërishëm dhe i plotë i paketimit në Maqedoni është mjaft i kufizuar. Vetëm një pjesë e vogël e plastikës reciklohet ose dërgohet për reciklazhë. Tregu për reciklimin e plastikës në Maqedoni nuk është i zhvilluar sa duhet.

Metalet e vjetra paraqesin pjesën më të madhe nga mbeturinat e mbledhura të cilat reciklohen, ndërsa përpunohen në Maqedoni. Ekziston rrjet i përpunuar mirë i mbledhësve dhe/ose blerësve, si dhe treg i fortë dhe stabil për mbledhjen e metaleve të vjetra. Mbetjet nga automjetet e vjetra përpunohen për shfrytëzimin e pjesëve rezervë ose si metali i vjetër. Metalet e vjetra eksportohen ose dërgohen deri te kapacitetet në Maqedoni, e cila posedon mjet thërmues për coptimin e metalit të vjetër para shkrirjes së tij.

Kompostimi dhe zbërthimi anaerob i mbeturinave nuk praktikohet në vendin tonë. Ekziston një pilot lokal kapacitet për kompostim, ndërsa vëllim më të madh kompostimi zbatohet në bujqësi me shfrytëzimin e materialeve hyrëse të njohura dhe të kontrolluara.

Kapacitetet e pakta ekzistuese për zbërthimin anaerob të drejtuar drejt degradimit të mbeturinave bujqësore dhe sidomos plehrat nuk punojnë tani me vite. Një pjesë e madhe e indit bimor që prodhohet në bujqësi përsëri shfrytëzohet në mënyrë të shëndoshë ekologjike. Sasi relativisht të mëdha të plehrave që e prodhojnë kafshët e mëdha dhe të vogla shfrytëzohen tërësisht për plehrimin e tokës punuese, por mungon monitorim për ndikimin ndaj resurseve të ujërave.

Sasitë më të mëdha të mbeturinave të dëmshme prodhohen në instalimet industriale metalurgjike dhe kryesisht skladohen në deponitë e paligjëshme në rrethin e firmës. Pjesa më e madhe e mbeturinave të dëmshme të vajrave që krijohen në sektorin prodhues dhe në aktivitete tjera sot digjen si lëndë djegëse.

Vetëm një përqindje e vogël nga gomat e vjetra të krijuara brenda një viti shfrytëzohet si lëndë djegëse në fabrikat për prodhimin e katranit dhe gëlqerës. Menaxhimi me llojet e tjera të mbeturinave, siç janë bateritë, akumulatorët, veturat e vjetra, PCB, mbeturinat elektrike/elektronike, e tjera. Nuk është në pajtim me direktivat e UE. Hulumtimi i paradokohshëm i mbeturinave me PCB kanë ardhur në përfundim se sasitë e mëdha të transformatorëve për të cilët dyshohet se përmbajnë PHB ende shfrytëzohen në sistemin energjetik. Një pjesë e këtyre vajrave të mbeturinave duhet të mblidhen, të eksportohen dhe ti nënshtrohen djegjes në vend të jashtëm, në ardhmëri të afërt. Gjithashtu, supozohet se mbeturinat që përmbajnë PCB krijohen në industri të caktuara, siç janë pajisjet e hekurudhës. Është e qartë se nuk ekziston asnjë kapacitet në labororet ekzistuese në Maqedoni për identifikimin e përmbajtjes së PCB ose PCT në mbeturina të forta.

#### 2.7.4 Deponimi final i mbeturinave

Pothuajse metodi i vetëm për deponimin final të mbeturinave është deponimi në deponi; vetëm një pjesë e mbeturinave të institucioneve shëndetësore dhe mbeturinave të caktuara të lëngta të rrezikëshme digjen.

Ka 55 deponi komunale aktive pa asnjë leje, por vetëm deponia „Drislla“ ka leje për punë. Pjesa më e madhe e *mbeturinave të forta komunale* dhe nga pjesa tjetër e mbeturinave të mbledhura deponohet pa asnjë tretman paraprak në deponitë komunale. Pjesa më e madhe e mbeturinave nga paketimet deponohet si pjesë përbërëse e mbeturinave të forta komunale dhe të mbeturinave të forta të ngjashme komerciale/industriale. Deponitë punojnë pa asnjë teknikë e cila zakonisht zbatohet në deponitë dhe pa kurrfar aktivitete monitoruese në aspektin e ndikimeve ndaj mjedisit jetësor. Nuk ekziston evidencë gjithëpërfshirëse në mbeturinat e deponuara, ndërsa nuk kryhet as inspektimi vizual i karakteristikave të mbeturinave të cilat duhet të deponohen. Deponia „Drislla“ është lokacioni i vetëm i mbeturinave e cila është në pajtim me kërkesat nacionale; por, madje as ky repart për deponimin e mbeturinave nuk është në pajtim me teknikat dhe standardet bashkëkohore ose me kërkesat e Direktivës së UE-së për deponitë. Një numër i vogël i lokacioneve tjera të deponive, përveç „Drisllës“, do të mund të përsosen që të jenë në pajtim me standardet e UE-së.

Mbeturina komunale e cila nuk mblidhet nga ndërmarrjet zyrtare për mbledhje deponohen në deponitë e egra. Mbeturinat nga mbetjet urbane , gjithashtu, në pjesë më të madhe deponohen në deponitë e egra ; nuk ekziston kapacitet për ndarjen e deponive për deponimin e një lloji të këtyllë të mbeturinave. Vlerësohet se numri i deponive të egra , sidomos në komunat rurale, arrin rreth 1000.

Deponitë komunale dhe deponitë e egra paraqesin rrezik potencial për ndotjen e ajrit, tokës punuese, ujrat tokësorë dhe nëntokësorë, si dhe rreziqet për llojllojshmërinë biologjike, tokën bujqësore dhe shëndetin e njerëzve, si pasojë e deponimit të mbeturinave të përziera të rrezikëshme dhe të parrrezikëshme. Problem shtesë paraqet djegia tradicionale e mbeturinave komunale, mbeturina nga indet bimore, si dhe plastika dhe prodhimtaria e plantazheve dhe e siles në hapsirë të hapur, mënyra e këtyll e djegies së mbeturinës mundet të provokojë sintetizimin e pjesëve përbërëse të organeve toksike dhe bio-akumulative, kurse emisionet e pakontrolluara në ajrit shkaktajnë ndotjen e ajrit ambiental dhe ndotjen afatgjate të tokës punuese bujqësore dhe të bimëve.

Praktika ekzistuese e deponimit të mbeturinave nuk është në pajtim me standardet teknike dhe/ose me standardet e mbrojtjes së mjedisit jetësor. Numri më i madhe i deponive ekzistuese komunale duhet të mbyllen, duke pasur parasysh se kushtet e lokacionit dhe ndikimeve ndaj mjedisit jetësor nuk lejojnë ata të mbindërtohet në mënyrën e rregullt të arsyeshme që të harmonizohen me standardet e UE-së.

Deponitë aktive komunale janë katagorizuar sipas përqindjes së rrezikut për mjedisin jetësor. 16 deponi janë ranguar me rrezikshmëri të lartë, 16 me rrezikshmëri të mesme dhe 19 me rrezikshmëri të ulët për mjedisin jetësor. 4 nga deponitë me rrezikshmëri të lartë janë klasuar si raste të veçanta me rrezikshmëri të lartë dhe duhet në periudh të shkurtër që të mbyllen ose të sanohen.

*Mbeturinat e rrezikëshme* të cilat i krijojnë minierat maqedonase dhe kapacitetet përpunuese ballafaqohen me probleme serioze në periudhën e tranzicionit dhe puna e tyre mund të pengohet pa mundësi që të restartohet në një të afërme të shpejtë. Procesi i tyre i deponimit të mbeturinave në vet rrethin ishte, gjithashtu, i lënë pas dore dhe për historinë e këtyre deponive ekzistojnë shumë pak informacione, poqese ekzistojnë në përgjithësi. Gjatë procesit të privatizimit, nuk ishin lidhur kontrata të qarta me pronarët e rinj për sa i përket pastrimit të depove të vjetra me mbeturina. Kështu, këto lokacione të vjetra të kontaminuara me mbeturina llogariten si vatra ekologjike

Inventari i përgaditur rezultonte me identifikimin e 16 lokacioneve më të mëdha industriale dhe deponimeve të mbeturinave– *vatrat ekologjike*, ku ka prezencë të mbeturinave të kontaminuara të mbeturinave ndërtimore dhe të mbeturinave të rrezikëshme të deponuara gjatë procesit. Vatrata më të

mëdha ekologjike rangohen në raport me ndikimet e përcaktuara të mjedisit jetësor dhe potencialit të rrezikshmërisë: tri vatra ekologjike kanë qenë të ranguara me rrezikshmëri të madhe për mjedisin jetësor, shtatë vatra ekologjike me rrezikshmëri të mesme për mjedisin jetësor dhe gjashtë vatra ekologjike me rrezikshmëri të ulët për mjedisin jetësor.

Bateritë e shfrytëzuara të cilat shfrytëzohen për aparatet e amvisrisë deponohen, kryesisht, si pjesë përbërëse të rrezikëshme të mbeturinave komunale të deponive. Akumulatorët e automjeteve të vjetra të cilat shkaktohen në vend nuk mblidhen sistematikisht, ato, kryesisht, përfundojnë në deponitë e egra, madje edhe deponohen në deponitë komunale. Numri më i madh i komponentave të yndyrëshme të automjeteve deponohen ose hudhen në mënyrë jo të rregullt. Gjithashtu, pjesa më e madhe e gomave të përdorura për momentin deponohen në deponi komunale/ose në deponi të egra.

Mbeturinat e rrezikëshme nga institucionet medicinale mblidhen të ndara në vet burimin, vetëm në spitalet e Kumanovës dhe të Shkupit, ndërsa më pas digjen në insinierat e deponisë „Drislla“. Mbeturinat e rrezikëshme dhe mbeturinat e parrezikëshme nga institucionet shëndetësore deponohen në deponitë komunale pa paratretmanin e nevojshëm.

Për momentin, mungojnë korniza ligjore dhe sistemi i shëndoshë nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor për procedim të drejtë me mbeturinat e plehrave të kafshëve dhe të indeve shtazore nga thertoret dhe nga fermat blegtorale. Përvoja e tanishme është futja në dhe e indeve shtazore në zgafellat në tokën e fermave ose ato hudhen në mbeturinat e fshatit. Në të dy situatat, kjo bëhet në një mënyrë krejtësisht të pakontrolluar dhe larg nga standardet e nevojshme sanitare. Vetëm në disa raste të rralla ekzistojnë zgafella të organizuara rajonale për këtë lloj të mbeturinave. Veterinarët zyrtarë nuk janë të involvuar ose janë të involvuar shumë pak dhe nuk bëjnë mbikqyrje. Në Maqedoni, për momentin nuk ekzistojnë industri të organizuara të ushqimeve për kafshët shtëpiake, fabrika për kompostim ose për kalbje anaerobike, deponi të lejuara ose kapacitete të insinieracionit, të cilat do të mund të përdoren për deponimin e rregullt të mbeturinave nga indet shtazore.

Në Maqedoni nuk ekzistojnë kapacitete të sigurta për deponimin e mbeturinave për mbeturina agrokimike të cilat përmbajnë substanca të rrezikëshme, siç janë mbeturina të kontaminuara nga paketimet, të shfrytëzuara për pesticide dhe gdhendës të përdorshëm të anijeve. Mbeturinat e kontaminuara nga paketimet kryesisht digjet ose deponohet së bashku me mbeturinat komunale. Gdhendësit e përdorshëm të anijeve lëshohen në mjedisin jetësor në vet lokacionin.

## **2.8 Rezime e problemeve dhe kufizimeve në Maqedoni**

Revizioni dhe analiza e problemeve kyçe të ndërlidhura me gjendjen ekzistuese të menaxhimit me mbeturinat në Maqedoni tregojnë se problemet kryesore dhe kufizimet janë të koncentruara në sferat të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e sistemit për menaxhimin me mbeturinat dhe rolin e tyre në shoqëri:

- Politika dhe korniza ligjore;
- Aspekti institucional/organizativ;
- Resurset njerëzore/kapacitetet;
- Finansimi/mbulimi i shpenzimeve dhe investimet;
- Vetëdija e subjekteve të interesuara dhe komunikimi;
- Disponimi i të dhënave/informimi;
- Shmangia dhe zvoglimi i mbeturinave;
- Përpunimi dhe reciklimi i mbeturinave;
- Ndarja, skladimi, mbledhja dhe transportimi i mbeturinave;
- Tretman/përpunimi i mbeturinave;
- Deponimi final dhe sanimi i mbingarkesës së mjedisit jetësor;

- Ndikimi ndaj shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit jetësor dhe natyrës, me ndikim potencial për ekonominë maqedonase.

Analiza e këtyre sferave problematike tregojnë se gjendja aktuale me menaxhimin e mbeturinave në Maqedoni mund të karakterizohet si e nivelit nënstandardeve në shikim resurseve bjerëzore dhe financiare, si e pamjaftueshme dhe jo efikase në shikim të monitorimit, si dhe pengohet nga mangësit politike dhe sociale ( siç janë zbatimi i dispozitave, konsultimet me subjektet e interesuara, vetëdija e publikut), që rezulton në sisteme disfunktionale të ndryshme dhe efekte të ngjashme negative ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj shëndetit të njerëzve.

### 3. ASPEKTET STRATEGJIKE DHE QËLLIMET E MENAXHIMIT ME MBETURINAT

#### 3.1 Çështjet strategjike

Zhvillimi i Republikës së Maqedonisë drejt sistemit të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave do të kërkojë ndryshime të mëdha të dispozitave ekzistuese, në organizimin institucional dhe në përvojën e përgjithshme të menaxhimit me mbeturinat. Harmonizimi i ligjeve, rregullave dhe procedurave me *acquis communautaire* paraqet shënjën e parë, e në disa pjesë të shoqërisë shënjë të rëndësishme se diçka thelbësore do të ndryshojë në sistemin e menaxhimit me mbeturinat në të gjitha segmentet e shoqërisë – nga Qeveria, nëpër mes sektorit prodhues dhe shërbyes deri te qytetarët individual. Obligimi thelbësor fillestar qëndron në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, sidomos në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapsinor, e cila duhet ta iniciojë procesin e aktiviteteve vijuese:

Veprimi i qëllimeve strategjike të përgjithshme dhe të veçanta për përvojën bashkëkohore të menaxhimit me mbeturinat, duke marur parasysh dëmet ekzistuese në mjedisin jetësor;

- Vërtetimi se të gjitha subjektet e interesuara në shoqëri e kuptojnë raportin midis menaxhimit joadekuat me mbeturinat efektet negative ndaj mjedisit jetësor, sidomos ndaj tokës, ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrit dhe ujit të pijëshëm, .
- Vendosja e sistemit kornizë në të cilin të gjithë subjektet e involvuara do të marrin pjesë në vendosjen për zhvillimin e menaxhimit me mbeturinat;
- Vendosja e të gjitha masave dhe instrumenteve në politikën e stimulimit dhe për mbështetjen e ndryshimeve në sistemin e menaxhimit me mbeturinat
- Vërtetimi se të gjitha subjektet e interesuara i kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre në aktivitetet të cilat janë të nevojshme për arritjen e qëllimeve dhe strategjive afat shkurtëra dhe afatgjata;
- Zbatimi i masave dhe instrumenteve të negociuara

Ndryshimet e suksesshme në menaxhimin me mbeturinat mund të iniciojë Qeveria, me shfrytëzimin e autoritetit të saj ligjor dhe rregullator, por suksesi përfundimtar në realitet mund të arrihet vetëm nëse të gjithë subjektet e involvuara janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në menaxhimin me mbeturinat dhe nëse motivohen me masat organizative dhe, mbi të gjitha, me masat ekonomike.

#### ***Regullativa ligjore, institucionet dhe zbatimi***

Realizimi i suksesshëm i Strategjisë për menaxhimin me mbeturinat do të varet para së gjithash, nga formimi i rregullativës përkatëse dhe gjithpërfshirëse, së bashku me organizimin e qartë të institucioneve, të cilat do të jenë vetëdijshme që ti kryejnë detyrat e monitorimit dhe mbikqyrje mbi zbatimin. Kjo kornizë do të sigurojë bazat për zbatimin e suksesshëm të aksioneve për menaxhimin me mbeturinat, të cilët do të dalin nga ky dokument strategjik.

Detyra për transponimin, zbatimin apo implementimin e legjislaturës dhe standardeve të UE-së paraqet sfidë të madhe. Implementimi i *Direktivave për deponitë* do të jetë më e vështira dhe me kërkesa më të mëdha në praktikë, qëllimete e direktivave për lloje të veçanta të mbeturinave kërkojnë që të krijohet një sistem i ri i menaxhimit ku do të involvohen sektori privat, metodat e veçanta të monitorimit dhe zbatimi i instrumenteve të veçanta finansiara. Përgatitja dhe zbatimi i instrumenteve ligjore do të kërkojë kuadër plotësues në institucionet publike (MMJPH dhe sidomos njësitë e vetëqeverisjes lokale), trajnim përkatës dhe specializim i të punësuarve.

### ***Fleksibiliteti operativ afatgjatë***

Transponimi i instrumenteve ligjore në strukturën e legjislaturës maqedonase, realizimi i investimeve dhe sjellja e infrastrukturës së re për mbledhje/tretman/deponim të mbeturinës do të kërkojnë kohë shtesë; kështu, infrastruktura për sistem të ri të integruar për menaxhimin me mbeturinat do të vendoset me një vonesë kohore të caktuar. Mund të pritet se regulative ligjore europiane mund të sjellë standarde të reja apo të ndryshuara dhe kërkesa për zgjidhjen e çështjeve të ndërlidhura me menaxhimin me mbeturinat, për këtë arsye është me rëndësi që të zhvillohet një sistem i tillë i menaxhimit me mbeturinat në Maqedoni ashtu që kapacitetet infrastrukturore për menaxhimin me mbeturinat

- do të paraqesin bazën e sigurtë teknike,
- do të mundësojnë zgjerime shtesë teknologjike dhe hapsinore
- dhe aq sa është e mundëshme do ta mbajnë shkallën e fleksibilitetit operativ.

### ***Faktorët ekonomik***

Finansimi i vendosjes së një sistemi të ri për menaxhimin me mbeturinat, si dhe i sanimit të mbingarkesave ekzistuese në mjedisin jetësor të shkaktuara nga menaxhimi jo adekuat me mbeturinat në të kaluarën është identifikuar si problem i veçantë në Maqedoni, i cili duhet të shqyrtohet me kujdes.

Shpenzimet, përfshirë këtu investimet e nevojshme kapitale dhe shpenzimet operative të cilat duhet të mbulohen, janë faktor jashtëzakonisht të rëndësishëm për një vend me 2 milion banorë, ku veçanërisht është i theksuar efekti i madhësisë së ekonomisë. Procese të caktuara standarde të tretmanit/deponimit të mbeturinave të cilat janë adekuate në vendet e mëdha europiane bëhen të paqëndrueshme ose jo efektive në krahasim me çmimin në Maqedoni, për shkak të sasisë më të vogël të mbeturinave, kompenzimeve më të ulëta për mbeturinat, si dhe shpenzimet më të mëdha në punë në vëllim relativisht më të vogël. Kjo është evidente sidomos për proceset e reciklimit/tretmanit të të gjitha llojeve të mbeturinave, sidomos të mbeturinave të rrezikëshme. Përsëri, arsya ekonomike e proceseve të reciklimit/tretmanit të llojeve të mbeturinave të caktuara, sidomos në mbeturinën e rrezikëshme, mundet që të vërtetohet me zbatimin e studimeve të caktuara plotësuese fizilibite.

Efikasiteti i lartë operativ në krahasim me shpenzimet e parakushtit themelor për mbajtjen e shpenzimeve të deponimit në nivel real, ndërsa kyçja e sektorit privat në aktivitetet për menaxhimin me mbeturinat shihet si mundësi e mirë për arritjen e një efikasiteti të tillë. Kryesisht, sektori privat mundet më mirë të menaxhojë me faktorët dominant të shpenzimeve të tërësishme operative, d.m.th. shpenzimet për të punësuarit dhe shpenzimet për punën dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe të paisjeve, në krahasim me ndërmarrjet publike.

Faktor tjetër kyç ekonomik paraqesin tregjet e kufizuara lokale për materiale dhe për prodhime të fituara nga mbeturinat, të dedikuara për reciklim ose për shfrytëzim për prodhimin e energjisë. Këto tregje, me siguri, do të mbeten relativisht të vogla. Pjesa më e madhe e materialeve për reciklim duhet të eksportohet, që do të imponojë harxhime të rëndësishme për veprimin dhe për transportin, ndërsa me këtë mund ta tejkalojnë vlerën tregtare të materialit. Prodhimi i energjisë nga mbeturinat kërkon, nga njëra anë, investime shtesë për paratretman të mbeturinave që të prodhohen dhe të shfrytëzohen gazrat, mbeturina të lëngëta dhe të ngurta si karburantet, si dhe vënia e instrumenteve të veçanta ekonomike, nga ana tjetër. Energjia e prodhuar do të mundet që të shfrytëzohet në vend.

Maqedonia është vend me shkallë relativisht të lartë të transparencës ekonomike, ku tregtia e jashtme përfshin mbi 90% nga BPV (bruto prodhimi vendas). Por, në vend ekzistojnë të hyra relativisht të ulëta tipike dhe përgjithësisht standard i ulët i jetesës së banorëve. Në bazë të kësaj, për momentin, vendosja dhe zbatimi i tarifave reale për menaxhimin me mbeturinat të cilat duhet ti paguajnë amvisritë për shërbimet e menaxhimit me mbeturinat, është detyrë më pak reale. Gjendja e vështirë financiare e ndërmarrjeve industriale paraqet kufizim tjetër për zbatimin e plotë të parimit „ndotësi

paguan “, për finansimin e tretmanit përkatës të mbeturisë së parrezikëshme dhe mbeturinës prioritare të rrezikëshme.

Mbingarkesat e caktuara në mjedisin jetësor ,d.m.th., „vatrat ekologjike“, të cilat tani më shkaktojnë dëmtime të mjedisit jetësor, me efekte negative ndaj shëndetit të banorëve përmes kontaminimit të ujit, ajrit dhe të tokës punuese, paraqet kufizime të veçanta në zhvillimin e shoqërisë. Krahas investimeve kapitale për vënien e standardeve më të mira për menaxhim me mbeturinat, do të paraqiten edhe shpenzime të mëdha për mbylljen e domosdoshme dhe/ose sanimin i të vjetrave ose i deponive industriale dhe komunale të lëna pas dore. Nuk ekzistojnë mjete sistematike për ekzekutimin dhe për (ko)finansimin e aktiviteteve për revitalizimin e vatrave të caktuara ekologjike për shkak të stagnimit në punën e industrisë.

Më në fund, nevojat për kuadër plotësues në institucionet publike, vetë-monitorimi i krijuesve të mbeturinave, si dhe inspektimet e rregullta, do të kërkojnë mjete për mbulimin e shpenzimeve të mëdhaja në sektorin publik/administrativ, si dhe në sektorin privat prodhues dhe shërbyes.

### ***Vetëdija e publikut për problemin me mbeturinat***

Pikëpamjet e publikut për mbeturinat dhe çështjet e lidhura me menaxhimin me të njëjtin paraqesin probleme sociale. Ndonjëherë, ato mund të manifestohen si kundërshtim i fortë drejt ndryshimeve të domosdoshme efektive të përvojave ekzistuese të menaxhimit me mbeturinat dhe kjo mund të paraqesë pengesë të madhe dhe kufizim drejt realizimit të strategjisë së integruar për menaxhim me mbeturinat. Kuptimet e caktuara të publikut themelohen në frigën dhe brengën reale, një pjesë e kundërshtimeve kanë të bëjnë me mungesën e informimit dhe të mirëkuptimit. Gjithashtu, mungojnë edhe shembuj të mirë të kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat në praktikë, siç do të ishte një deponi e projektuar mirë, deponi e re rajonale bashkëkohore sanitare , kështu që banorët mbeten të pa besimtë drejt zgjidhjeve të reja sistematike.

Nga pikëpamja sociologjike, realizimit strategjik fundamental duhet të jetë ndryshim cilësor në identifikimin e tërësishëm të problemit me mbeturinat , si dhe në pranimin e nevojave të pashmangëshme për menaxhim të pranueshëm me mbeturinat në kohën e tashme dhe në atë kohë. Në këtë kuptim, MMJPH e vuri në pah nevojën e përgatitjes dhe zbatimit Strategjik nacional për informimin e publikut dhe për zhvillimin e vetëdijes së tyre, si dhe për zbatimin e programeve gjithëpërfshirëse për komunikim të kontinuar dhe konsultim me publikun dhe me të gjitha subjektet e involvuara në menaxhimin me mbeturinat, në periudhën para dhe gjatë realizimit të Strategjisë për menaxhimin me mbeturinat.

## **3.2 Qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta strategjike**

Rëndësia e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta në procesin e vendim marrjes politike për sistemin e ardhshëm për menaxhimin me mbeturinat është jashtëzakonisht i madh, sepse me ato definohet kompleks nga drejtimet në mes veti të lidhura dhe aktivitetet, me qëllim

- të mbahet kontroll mbi të gjitha llojet e mbeturinës së krijuar,
- të zvogëlohen sasit e mbeturinës së krijuar,
- të shfrytëzohen vlerat materiale dhe energjetike të mbeturinave,
- Të zvogëlohen sasitë e substancave të rrezikëshme në mbeturina,
- të sigurohet deponim final i pranueshëm nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor,
- të pengohet formimi i mbingarkesave të reja në mjedisin jetësor që do të duhet ti zgjidhin gjeneratat e ardhëshme.

- Të sanohen ngarkesat e mjedisit jetësor të cilat kryejnë ndikime negative ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj shëndetit të njerëzve.

Qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta të strategjis për menaxhim me mbeturinat e pasqyrojnë në përgjithësi **politikën nacionale** të pranuar për menaxhim me mbeturinat dhe paraqesin bazë për përgatitjen dhe për zbatimin e sistemit të integruar dhe në raport me shpenzimet sistemi efektiv për menaxhim me mbeturinat.

Qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta në fushën e menaxhimit me mbeturinat kryesisht janë fokusuar në menaxhimin e problemeve të lidhura me mbeturinat në vet burimin dhe shfrytëzimin optimal të pjesëve të tyre përbërëse, të vendimeve për aktivitete të domosdoshme për zvoglimin dhe për parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave dhe të hapave dhe masave të cilat janë të nevojshme që të arrihet përmirësim afatgjatë i gjendjes në mjedisin jetësor.

Qëllimet strategjike duhet të harmonizohen midis të gjithë segmenteve të shoqërisë, ndërsa qëllimet e harmonizuara në sferën e mbeturinave duhet të integrohen në planet zhvillimore në nivel nacional dhe, lokal, si dhe në planet e sektoreve prodhuese dhe shërbyese me pronësi private. Qëllimet dhe detyrat në princip duhet të jenë të harmonizuara me kërkesat e mjedisit ekonomik kooperativ, përkatësisht vendet e UE-së nga njëra anë dhe të formuara në mënyrë mjaft reale që të jenë të realizueshme nën kushtet e veçantë të një të ardhme të afërt dhe më të largët.

Qëllimet e përgjithshme strategjike dhe qëllimet e veçanta pasqyrojnë përcaktimin e gjithë shoqërisë maqedonase për ndryshime të varura midis tyre dhe të rëndësishme në menaxhimin me mbeturinat: politika dhe regulativa ligjore, struktura institucionale dhe organizative, resurset njerëzore dhe kapacitetet, finansimi dhe kthimi i shpenzimeve, vetëdija e subjekteve të involvuara, mbledhja e të dhënave dhe sistemi informativ dhe teknik për menaxhim me mbeturinat, si dhe eliminimi ose zbutja e të gjitha ndikimeve që sfidojnë nga aktivitetet e tanishme në menaxhimin me mbeturinat.

Strategjia e menaxhimit me mbeturinat duhet ta pasqyrojë **politikën nacionale** në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe të paraqesë bazë për përgatitjen dhe për zbatimin e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturinat, i cili do të jetë efektiv në raport me shpenzimet;

**Legjislatura nacionale** për menaxhim me mbeturinat duhet të jetë rezultat e politikës në pajtim me shoqërin, të miratohet me kërkesat dhe me standardet e UE-së në të gjithë sektorët në shoqëri dhe duhet të sigurojë zbatimin efektiv të dispozitave.

Duhet të vendoset **Strukturë institucionale dhe organizative** efektive në të gjitha etapat e realizimit të sistemit të ri të integruar për menaxhim me mbeturinat: nga planifikimi, dhënia e lejeve, finansimi dhe puna deri te zbatimi .

Gjatë vendosjes së sistemit për menaxhim me mbeturinat, duhet përkatësisht të forcohen **resurset dhe kapacitetet njerëzore** në sektorin publik dhe privat. Duhet maksimalisht të angazhohet ekspertiza e njohurive dhe teknikave të cilat ekzistojnë në universitetet dhe institucionet tjera, si dhe potenciali ekonomik i cili është prezent në vend.

Duhet të vendosen **resurse financiare** stabile dhe **mekanizma ekonomike** përkatëse stimuluese me qëllim të sigurimit të qarkullimit të të ardhurave nga kompenzimet për menaxhim me mbeturinat, të cilat do të jenë të mjaftueshme për mbulimin e plotë të shpenzimeve për sigurimin e sistemit të integruar të menaxhimit me mbeturinat në pajtim me parimin „ndotësi paguan “ dhe të cilët do të japin efekte maksimale në raport me aktivitetet organizative dhe operative.

**Vetëdija e të gjitha subjekteve të interesuara** në lidhje me çështjen e menaxhimit me mbeturinat, të integruara në shoqëri dhe pranimi i politikës dhe strategjisë nacionale për vendosjen e sistemit bashkëkohor, integruar për menaxhim me mbeturinat, në pajtim me standardet europiane duhet të paraqesë motivim të vazhdueshëm për përmirësimin e sistemit të menaxhimit me mbeturinat dhe për ndërimin e sjelljes së të gjitha përfaqësuesëve në shoqëri.

Implementimi dhe mbajtja e sistemit për **mbledhjen e të dhënave/sistemit informativ** duhet të përfshijë të dhëna për burimet, natyrën, sasinë dhe fatin e mbeturinave, të dhënat bazë për kapacitetet për shfrytëzimin, reciklimin dhe përdorimin e pjesëve përbërëse energjetike të llojeve individuale të mbeturinave dhe informatave për deponimin final të mbeturinave.

Sistemi i ri për menaxhim bashkohor me llojet e krijuara të mbeturinave duhet ti mer para sysh opsionet e ndryshme teknike për **shmangien e mbeturinave, zvoglimin e potencialit të tyre të rrezikshmërisë dhe zvoglimin e burimeve**, si dhe **shfrytëzimin e përmbajtjes së tyre materiale dhe/ose energjetike** sipas vlerësimit të “opcionit më të mirë të zbatueshëm nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor”, me qëllim që të arihet **deponim ekologjik** i siguar dhe të mbrohen resurset e papërmirësueshme natyrore, me emisionet minimale nga proceset e tretmanit/deponimit të mbeturinës në mjedisin jetësor.

**Aktivitetet e menaxhimit me mbeturinat** duhet ti pengojnë emisionet në mjedisin jetësor, si dhe efektet e dëmshme dhe efektet tjera negative ndaj shëndetit dhe mirëqenies së banorëve, për kafshët dhe vegjetacionin dhe për vendbanimet e tyre dhe mjedisin e tyre natyror, nëpërmes masave teknike me qëllim të veçant që të mbrohen sipërfaqet bujqësore dhe resurset e ujërave, të cilat paraqesin të mira të ineresit të veçant nacional.

Sistemi i menaxhimit me mbeturinat duhet ti zbatojë **teknikat më efikase dhe më efektive në raport me shpenzimet** për mbledhjen, transportin, selektimin, skladimin e përkohshëm dhe tretmanin/përpunimin e llojeve të selektuara të mbeturinave, me inkuadrimin e sektorit privat me qëllim që të arrihet niveli i 100% i mbledhjes dhe niveli optimal i shfrytëzimit material dhe energjetik i pjesëve përbërëse të përdorëshme të mbeturinave në pajtim me standardet nacionale.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave duhet të vendosë **deponi për mbeturina të rrezikshme dhe të parrezikshme** dhe kapacitete të tjera për deponimin final të mbeturinave, plotësisht të **harmonizuara me standardet europiane**, kurse me këtë do të mundësohet zvoglimi i potencialit të rrezikshmërisë së mbeturinave të deponuara të cilat nuk mund të paraqesin ngarkesë të re në mjedisin jetësor. Deponitë komunale ekzistuese dhe/ose vatrat industriale ekologjike duhet të mbyllen dhe/ose të relativizohen shkallë-shkallë.

Sistemi i menaxhimit me mbeturinat duhet të vendos **inventar për deponitë e egra dhe të ngarkesave të tjera në mjedisin jetësor**, i cili do të përmbaj informacione për rreziqet e vlerësuara dhe ndikimet e matura ndaj mjedisit jetësor. Detyrat prioritare për rekultivimin, si pjesë e Programit nacional aksional të mjedisit jetësor, duhet të definohen sipas kriterëve të cilat i marrin parasysh efektet negative dhe rreziqet për mjedisin jetësor, shfrytëzimi i ardhshëm i hapsirës fizike, shpenzimet për revitalizacion dhe pranueshmëria për vendbanimet.

### **3.3 Parimet themelore të menaxhimit me mbeturinat**

#### **3.3.1 Parimet kyçe**

Në procesin e realizimit të Strategjisë nacionale të menaxhimit me mbeturinat, duhet të meren parasysh dhe të zbatohen një numër i caktuar i parimeve kyçe të UE-së për menaxhim me mbeturinat. Përkundër nivelit të ulët të sistemit ekzistues për menaxhim me mbeturinat, këto parime do të sigurojnë, nga njëra anë, mbështetje themelore për politikën maqedonase në raport me përmirësimin e gjendjes ekzistuese në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të resurseve natyrore në të ardhmen, nga ana tjetër. Parimet themelore kyçe janë:

- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Hierarkia në menaxhimin me mbeturinat;
- Parimi i afërsisë;
- Vetëfinansimi;
- Opcioni më i mirë real ekologjik (OMRE);

- Parimi i kujdesshmërisë;
- Përgjegjësia e prodhuesit;
- Parimi „ndotësi paguan“;

**Zhvillimi i qëndrueshëm:** Menaxhimi i qëndrueshëm me mbeturinat don të thotë shfrytëzim më efikas i resurseve natyrore, nxitja e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritura të energjisë, zvoglimi i sasisë së mbeturinave të krijuara dhe në vendin ku ai krijohet, menaxhimi me mbeturinat me ndikim minimal mbi nevojat, mundësitë dhe zhvillimin e gjeneratave të ardhëshme.

**Hierarki në menaxhimin e mbeturinave:** Strategjitë e menaxhimit me mbeturinat duhet të jenë të orientuara në radhë të parë drejt parandalimit të mbeturinave të krijuara dhe drejt zvoglimit të cilësisë së tyre të rrezikëshme. Kur kjo nuk është e mundur, materialet e mbeturinave duhet të shfrytëzohen përsëri, të reciklohen ose të ripërtëriten, apo të shfrytëzohen si sekundare, madje edhe si burim i ripërtëritur i energjisë. Fraksionet e papërdorshme të mbeturinave deponohen të sigurt në deponi, ose me insinerimin pa shfrytëzimin për energji. Deponimi i mbeturinave është opcioni i fundit i dëshiruar, por i pashmangshëm në sistemin për menaxhim me mbeturinat.

**Parimi i afërsisë:** Mbeturinat duhet të trajtohen dhe/ose të deponohen aq sa është e mundur me afër nga burimi i krijimit, me qëllim që të shmangen ndikimet negative ndaj mjedisit jetësor gjatë transportit të panevojshëm.

**Vetëfinansimi:** Vendosja e një rrjeti të vetëfinansimit të kapaciteteve për deponimin e teritorit të një vendi varet nga llojet e mbeturinave dhe nga balansimi midis parimit të afërsisë dhe ekonomisë në të madhe.

**Opcioni më i mirë real ekologjik (OMRE):** Opcioni më i mirë real ekologjik (OMRE) është rezultat i procesit sistematik të sjelljes së vendimeve përmes konsultimeve, në të cilin theksohet mbrojtja e mjedisit jetësor në të gjitha mediat, d.m.th. tokës, ajrit dhe ujit dhe sigurohen përfitimet më të mëdha ose dëmet më të vogla për mjedisin jetësor si tërësi, me çmim të pranueshëm, afatgjatë, si dhe afatshkurtër.

**Parimi i kujdesshmërisë:** Masat e kujdesshmërisë të cilat ndërmerren sot do të ndihmojnë që të shmangen potencialet negative në mjedisin jetësor ose pasojat për shëndetin e njeriut në të ardhmen, sidomos në rastin e mungesës së sigurisë së plotë shkencore.

**Përgjegjësia e prodhuesit :** Operatorët ekonomik, e sidomos prodhuesit, distributerët dhe tregtarët me prodhime të vogla-krijues të mbeturinave duhet të bartin përgjegjësi kolektive:

- për zvoglimin e mbeturinave në minimum në fazën e prodhimit;
- për planifikimin dhe zhvillimin e prodhimeve të cilat përbëhen nga materiali përkatës për shfrytëzimin e sërishëm, reciklimin dhe/ose për prodhimin e energjisë, si dhe nga materiali pa rrezik të mbingarkesës së mjedisit jetësor kur prodhimet, me skadim të afatit për përdorim, bëhen mbeturina;
- për zhvillimin e tregjeve për shfrytëzimin e sërishëm dhe reciklimin e fraksioneve të cilat ndahen për shfrytëzimin nga prodhimet me afat të skaduar të përdorimit.

**Parimi „ndotësi paguan“:** Parimi „ndotësi paguan“ në menaxhimin me mbeturinat don të thotë se shpenzimet potenciale për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut, të ndërlidhura me krijimin, tretmanin dhe deponimin e mbeturinave, duhet të pasqyrohet në çmimin e prodhimeve dhe në kompenzimet të cilat arkëtohen për menaxhim të drejtë me mbeturinat ( internalizimi i shpenzimeve eksterne).

Politika maqedonase për menaxhimin me mbeturinat duhet të kultivojë parime shitesë dhe obligime , në fakt:

- Distinkcion të qartë midis mbeturinave të rrezikëshme dhe të parrezikëshme, selektimi i tyre në burimin, si dhe tretman i veçantë dhe deponim final i fraksioneve të rrezikëshme dhe të parrezikëshme të mbeturinave.
- Nxitja e zbatimit prioritar e instrumenteve të ndryshme ekonomike, në vend dhe si shtesë e procedurave administrative për zbatimin e dispozitave.
- Vendosja e sistemit të mbikqyrjes dhe kontrollit në lidhje me transportin e mbeturinave në kufijtë e vendit në nivel nacional dhe vendosje e sitemit të veçantë të kontrolluar për transport të mbeturinave të rrezikëshme kur e kalon kufirin e shtetit, pa marr parasysh se është i dedikuar për shfrytëzim të sërishëm, reciklim ose për deponimin final të mbeturinave.

### 3.3.2 Parimet kyçe për kultivimin e menaxhimit me mbeturinat me elementet themelore të strategjisë së UE dhe resurseve

Strategjia për menaxhimin me resurset paraqet pjesën kryesore të Programit të gjashtë aksional të mjedisit jetësor (2002-2012), në të cilën menaxhimi me mbeturinat llogaritet si pjesë përbërëse për *menaxhimin e qëndrueshëm me resurset natyrore*, së bashku me politikën për prodhim të integruar. Qasja e këtillë don të thotë integrim më aktiv i problemeve në mjedisin jetësor të ndërlidhura me resurset në politikat e tjera të shoqërisë.

Strategjia tematike për parandalimin dhe për reciklimin e mbeturinave i vendos drejtimet dhe i përshkruan mënyrat për përmirësimin e menaxhimit me mbeturinat përmes nxitjes së *politikës së prodhimit të integruar* dhe *politikës së parandalimit të integruar dhe kontrollit të ndotjes*. Kjo don të thotë zhvillimi, prodhimi dhe shpenzimi i produkteve dhe mallrave gjatë së cilës ndikimi ndaj mjedisit jetësor, gjatë ciklit të tërë jetësor të prodhimit është zvogluar me shfrytëzim më të mirë të materialit të lëndës së parë të pa ripërtëritur dhe të resurseve të energjetikës, zvoglimin të emisioneve në mjedisin jetësor dhe përmes menaxhimit të qëndrueshëm me mbeturinat si fazë finale e ciklit jetësor. Proceset për shfrytëzimin e sërishëm, reciklimin dhe shfrytëzimin e materialeve/energjisë nga fraksionet e mbeturinave mund të rezultojë në shfrytëzimin më të mirë të resurseve dhe të deponisë, deponohen vetëm fraksionet e papërdorshme. Qasja e këtillë don të thotë se çdo pjesë e mbeturinave shikohet jo vetëm si burim i ndotjes, por edhe si resurs potencial i cili duhet të shfrytëzohet, ndërsa kjo do të çojë deri te ndarja e zhvillimit ekonomik dhe sasisë së mbeturinave të shkaktuara.

Menaxhimi i drejtë me mbeturinat e bioshpërbëra të cilat paraqesin fraksion të rëndësishëm në mbeturinat komunale dhe në mbeturinat nga pastrimi i ujrave të ndotura, në mbeturinat bujqësore dhe në mbeturinat në industrinë për ushqim dhe pije, mund të kontribuojë drejt *zvoglimit të emisioneve të gazrave të qelqta*. Në parim, të gjitha mbeturinat e shpërbëra biologjikisht don të thotë material i përdorshëm në ciklet e prodhimitarisë bujqësore dhe burim i energjisë së ripërtëritur. Ridestnimi nga deponia në proceset e tjera të shfrytëzimit të materialeve/energjisë dhe kontrolli i emisioneve në ajër nga kapacitetet ekzistuese për deponim mund të kontribuojë në masë të madhe në masa të caktuara lokale kundër ndryshimeve klimatike globale.

### **3.4 Karakteristikat strategjike të skemës së përgjithshme për menaxhim me mbeturinat**

#### **3.4.1 Parimet themelore për zhvillimin e skemës për menaxhim me mbeturinat në Maqedoni**

Zbatimi i parimeve europiane kyçe në sistemin e ri për menaxhim me mbeturinat në Maqedoni paraqet bazën kornizë për zhvillimin e skemës gjenerale për menaxhim me mbeturinat nga burimet e krijimit të mbeturinave deri në deponimin final të mbeturinave, duke i marr parasysh ngarkimet ekzistuese të mjedisit jetësor të shkaktuara nga menaxhimi joadekuat me mbeturinat në të kaluarën. Sistemi për menaxhimin me mbeturinat do të zhvillohet gradualisht, por me progresivitet, ndërsa masat e veçanta mund të kenë prioritet të ndryshëm në kontekstin e shkallës së tanishme të zhvillimit të sistemit dhe prania e ngarkesës së mjedisit jetësor. Vendosja e sistemit nacional për menaxhimin me mbeturinat paraqet aktivitet afatgjatë në të gjitha segmentet e shoqërisë, por parimet themelore strategjike për zhvillimin e menaxhimit me mbeturinat duhet pjesërisht ti pasqyrojnë prioritetet kryesore si bazë nisëse për përpunimin e planeve nacionale për menaxhim me mbeturinat, në nivel nacional dhe lokal.

#### ***Zgjidhja e problemeve të ndërlidhura me mbeturinat e burimit***

Parimi i zgjidhjes së problemeve të ndërlidhura me mbeturinat në vet burimin, që do të zbatohet si një nga prioritetet, don të thotë përgjegjësi për pronarin e mbeturinave ti kontrollojë dhe ti mbledhë individualisht llojet e mbeturinave, ti regjistrojë sasinë dhe karakteristikat e tyre dhe ti sigurojë procedurat e tilla të trajtimit dhe të deponimit të cilat janë në pajtim me parimet, e pranueshme me dispozitat, të pranueshme në aspekt të mbrojtjes së mjedisit jetësor, si dhe nga aspekti ekonomik. Ky parim mund të zbatohet për mbeturinat komunale të cilat krijohen në burimet e dispenzuara, me përgjegjësi të përbashkët të banorëve, komunat dhe shërbimet e tyre publike. Personat e tjerë – sektori prodhues dhe shërbyes, do ta zbatojnë vet këtë parim.

Përgjegjësia primare për mbeturinat i përket pronarit të mbeturinave, i cili e mban përgjegjësinë për të gjatë gjithë ekzistencës shekullore të mbeturinave, nga burimi i krijimit të mbeturinave deri ke objekti për deponimin e tij final dhe përgjithësisht është përgjegjës për dëmet në mjedisin jetësor të shkaktuara me menaxhim jo të rregullt me mbeturinat.

Përgjegjësi shtesë për mbeturinat ke pronari-prodhuesi i prodhimeve dalin kryesisht nga mundësia e tij që ta parandaloj krijimin e mbeturinave me mbylljen e rrjedhave të brendshme të materialit të lëndës së parë në proceset prodhuese, ta shfrytëzojë energjinë nga procesi i llojeve të mbeturinave dhe ti çojë në minimum sasinë e mbeturinave të rrezikshme potenciale i cili duhe të deponohet. Këto masa në radhë të parë janë teknike dhe teknologjike sipas karakterit të tyre, përfshirë këtu edhe riorganizimin e prodhimit dhe shfrytëzimin e materialeve të cilat mund të reciklohen dhe substancave më pak të dëmshme në procesin e prodhimit. Potenciali i rrezikshëm i mbeturinave nga prodhimtaria, si dhe potenciali i rrezikshëm i prodhimeve të shfrytëzuara duhet të zvoglohet dhe të rezultojë me rreziqe më të vogla për mjedisin jetësor. Masat preventive duhet të stimulohen dhe me kërkesa të mëdha për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të shoqëruara me instrumente ekonomike.

Njohjet e detajuara të karakteristikave të mbeturinave në vet burimin mundëson të zbatohen mënyrat optimale të menaxhimit të mbeturinave. Njohja e mënyrës optimale të menaxhimit me mbeturinat, madje edhe po qe se kërkohen procese afatshkurtëra të tretmanit, i zvoglon rreziqet për ndikimet negative ndaj mjedisit jetësor, nuk duhet lejuar përzierja e fraksioneve të mbeturinave me karakteristika të ndryshme të rrezikut, me qëllim që të zvoglohet rreziku për mjedisin jetësor.

Si prioritet, pronarët e mbeturinave janë të obliguar të kenë regjistër për të gjitha llojet e mbeturinave, duke tërhequr vërejtjen e rrezikshmërisë së tyre, karakteristika inerte ose të parrrezikshme, pa marr parasysh potencialin e tyre për shfrytëzimin ose tretmanin e planifikuar ose deponimin final në lokacione të tjera.

Të gjitha masat teknike për mbrojtjen e mjedisit jetësor, me qëllim të zvoglimit të emisioneve në ajër dhe në ujë janë gjeneratorë të mbeturinave të reja dhe deponimi final i sigurtë i këtyre mbeturinave duhet të bëhet pjesë përbërëse e planeve dhe proekteve teknike finansiare.

### ***Mbledhja e ndarë e llojeve të ndryshme të mbeturinave***

Ndarja e mbeturinave të krijuara në vet burimin ofron mundësi që të zgjedhet ose të vendoset sistem përkatës për çdo lloj të mbeturinave, me qëllim që të arrihet shfrytëzimi maksimal i vlerës materiale dhe energjetike të mbeturinave me çmim më të ulët të mundshëm të paratrazimit dhe zvoglimit të rreziqeve dhe potencialeve të rrezikshmërisë së mbeturinave të papërdorshme të cilat duhet të deponohen, të bëhen minimale.

Sa i përket mbledhjes së mbeturinave, prioriteti kryesorë i Maqedonisë është vendosja e sistemit të mbledhjes së mbeturinave në mënyrë të ndarë

- Sipas karakteristikave të tyre të rrezikëshme,
- Sipas krijimit të tij në burim të vetëm ose në burim të disperzuar, dhe
- Sipas qëllimit për menaxhim të mëtutjeshëm, që duhet të jetë i pranueshëm në aspekt të mbrojtjes së mjedisit jetësor edhe nga aspekti ekonomik.

Në esencë, mbeturinat mund ti shohim edhe si lëndë e parë sekundare; ato mund të reciklohen ose disa fraksione të tij mund të shfrytëzohen si materiale ose për prodhimin e energjisë. Mbledhja e ndarë e llojeve individuale të mbeturinave në ***Burimet e vetme*** të cilat janë, kryesisht, reparte përpunuese ose kapacitete për prodhimin e energjisë, lëjnë disa opsione të hapura për zgjedhje të pranueshme nga pikëpamja teknike dhe teknologjike:

- Përpunimi i mbeturinave në lokalitetin i cili është në pronësi të pronarit,
- Transporti dhe përpunimi në kapacitet të përbashkët apo në kapacitet tjetër për tretmanin ose për përpunimin ose
- Transporti dhe deponimi i mbeturinave në lokacionin në pronësi të pronarit të tij ose në kapacitet tjetër për deponim në shtetin tonë ose jashtë shtetit.

***Mbeturinat komunale*** duke përfshirë ***mbeturinat nga ndërmarrjet e vogla shërbyese*** me fraksion tipik të mbeturinave në burimet e disperzuara, sistemi i ndarë për mbledhjen do të zhvillohet në disa faza me prioritete të ndryshme:

Përfshirja e të gjitha amvisrive në sistemin e organizuar të mbledhjes së mbeturinave të tjera të përziera është prioriteti i parë. Paralelisht mund të zhvillohet sistemi i mbledhjes së fraksioneve të selektuara të mbeturinave komunale, siç janë mbeturinat masive mbeturinat nga ndërtimtaria dhe mbeturinat e caktuara nga amvisria me pjesë përbërëse të rrezikëshme. Sistemi për mbledhje duhet të aftësohet drejt teritorit të zënë me mbledhjen dhe drejt kapacitetit për deponim final sipas qasjes së raportit midis shpenzimeve dhe përfitimeve.

Ndarja e vet burimit të pjesëve përbërëse të mbeturinave komunale të cilat mund të reciklohen, ndarja në fraksione të lehta nga mbeturinat komunale të përziera me qëllim të prodhimit të karburantëve nga mbeturinat dhe nxitja e shfrytëzimit të mbeturinave (plehrave) biologjike në kopshte do ta paraqesë fazën e zhvillimit në vijim në menaxhimin me mbeturinat komunale. Mbledhja e ndarë e mbeturinave biologjike nga amvisritë në qytetet do të sillt vetëm nëse ekziston treg për trajtimin e bio-mbeturinave ose prodhimet nga tretmani mund të shfrytëzohen në procesin e sanitimit të deponive dhe ngarkesave të tjera në mjedisin jetësor për një periudhë më të gjatë.

Rrjeti për grumbullimin e dedikuar për përpunimin e përbërëse të dobishëm të *prodhimeve me afat të skaduar të përdorimit* do ta organizojnë prodhuesit, importuesit, distributorët dhe tregëtarët me prodhime në ndërmarje specializuese shërbyese dhe do të prezentojë formë të posaçme të sitemit në grumbullim separat për rrjedha individuale të veçanta të mbeturinave ndaj bazës së principit për përgjegjësi të prodhuesit. Zbatimi i përgjegjësisë për prodhimin mundet që të ketë prioritet për disa rrjedha të prodhimeve me afat të skaduar të përdorimit, duke kyqur lloje të caktuara të paketimit dhe mbeturina nga paketimi të krijuara në ndërmarjet prodhuese dhe komerciale. Sistemi i grumbullimit mundet të organizohet dhe/ose të kryhet nga pronari/prodhuesi i mbeturinave ose nga shërbimi i autorizuar publik ose privat. Efektet e caktuara të volitshme dhe të shpejta mundet që të priten në raport me shfrytëzimin e materialit/energjisë nga mbeturinat, në sasi më të vogla të mbeturinave në deponit dhe punësim me investim relativisht të vogël dhe harxhime të ulta operative.

### ***Përpunimi i mbeturinës si këmbim për resurset natyrore***

Materiali i tërsishëm që plasohet në treg është i gjykuar të mbetet mbeturin pas skadimit të afatit të përdorimit dhe secili proces prodhues krijon forma të caktuara të mbeturinave. Duke marrë para sysh atë që mbeturina mundet të paraqet lëndë të parë sekundare, menaxhimin e qëndrueshëm me mbeturinat don të thotë shfrytëzim optimal i resursit potencial të mbeturinës si këmbim për shfrytëzimin e resurseve natyrore të pa ripërtritura, duke marrë para sysh aspektet ekonomike, aspektet e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe aspektet sociale, sipas kërkesave të koncepteve për zhvillim të qëndrueshëm. Me zbatimin e masës së njejtë, lidhjet në mes zhvillimit ekonomik dhe prodhimit të mbeturinës në vendin në zhvillim do të dobësohen, kurse ka mundësi që edhe të ndërpriten.

Separacioni në rrjedha individuale të mbeturinave ose grupi kompatibil i mbeturinave në vet burimin është kushti kryesor për fitimin e cilësisë përkatëse në fraksionet e përdorura nga mbeturina, pa marr para sysh nivelin e rrezikut të njëjtë. Rrjedhat e materialeve nga grumbullimet e ndara të mbeturinave mundet teknikisht më lehtë që të menaxhohen dhe më lehtë të arrihen standardet teknike për reciklimin e materialeve ose për shfrytëzimin e vlerës energjetike të mbeturinave, me çmim më të ulët. Në rastin e mbeturinës medicinale, grumbullimi i ndarë i mbeturinës me mbeturin me rrezik të madh, mbeturinë komunale e mbetur dhe fraksione të cilat mund të reciklohen do të paraqet masën themelore, të pashmangëshme në institucionet shëndetësore.

Mbeturina e paratrajtueshme mundet të reciklohet në proces të njejtë ose në proces tjetër prodhues; shfrytëzimi i vlerës energjetike në individuale ose në grup të zgjedhur të mbeturinës mundet që të bëhet realitet në Maqedoni dhe mundet të realizohet në kapacitete të caktuara prodhuese dhe stacione termo-energjetike nën kushtet teknike të veçanta dhe kushte për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Shfrytëzimi i energjis nga mbeturina e paratrajtuar në instalime për prodhimin e energjis nga mbeturina me efikasitet të lartë energjetik dhe me shfrytëzimin e burimeve të ripërtritura të energjis mundet që të paraqet opsion të volitshëm për kryeqytetin e Maqedonisë, por ndërtimi i kapaciteteve të tillë do të lihet për realizimin në fazën e dytë zhvillimore në sistemin për menaxhim me mbeturinat.

Sipas definicionit, biomasa nga mbeturinat është material biodegradues në proceset biologjike dhe bioteknologjike në bujqësi, pylltari dhe industrin ushqimore dhe industrin për pije dhe në sektorin komunal. Shfrytëzimi i komposteve dhe i mjeteve tjera për përparimin e shtresave tokësore konsiderohet se është prioriteti i parë nga aspekti i menaxhimit të qëndrueshëm me fraksionin biodegradues të mbeturinës. Por, për zbatimin në bujqësi. Patjetër duhet të arrihen kërkesat e veçanta për cilësinë në raport të llojeve të kuturave, përmbajtja e substancave toksine dhe bio-akumulative në shtresat tokësore, si dhe niveli i mbrojtjes së ujërave nëntoksore. Sipas asaj, shfrytëzimi i materialit tokësor i përgaditur nga mbeturinat biondërtuese llogaritet se është realizuar opsion afatgjatë për projektet për revitalizimin e deponive të rrezikëshme dhe për ngarkesat tjera në mjedisin jetësor.

Pa marr para sysh prejardhjen, biomasa është njëra nga burimet e ripërtrira energjetike, por edhe si pjesë përbërëse e mbeturinës së fortë komunale. Për vendin me resurse të kufizuara energjetike, me përjashtim të sasisë së drurit, potencialit hidroenergjetik, resurset energjetike të tjera të përmirësuara,

siç janë mbetjet urbane dhe pjesa e mbetur e drurit, nus-prodhimet shtazore, plehrat e rëndomt, fundrina nga ujrat e ndotur dhe druri, biomasa mundet të bëhet lëndë e parë gjithnjë e më e rëndësishme për prodhimin e lëndëve djegëse të gazta, të lëngta dhe të ngurta për transport dhe për prodhim të energjis, në industri dhe në amvisëri.

Të gjitha llojet e shfrytëzimit të biomasës do të kontribuojnë mjaftë drejt zvogëlimit të emisioneve të gazrave të qelqta.

### ***Rrjeti racional i kapaciteteve për trajtim dhe deponim***

Grumbullimi në pjesën më të madhe prej rrjedhave të mbeturinave dhe vendosja e rrjetit racional i kapaciteteve për trajtim dhe për deponim të mbeturinave, të cilat do të posedojnë leje përkatëse për kryerjen e aktiviteteve përkatëse në menaxhim me mbeturinat, janë detyra të pashmangshme për Maqedonin, për atë që ta mbrojë dhe ta përmisoj cilësinë e mjedisit jetësor dhe të ruaj hapsirën e dedikuar për aktivitete tjera të rëndësishme në shoqëri. Patjetër duhet që të ndërtohet infrastrukturë më e mirë për menaxhim me mbeturinat për menaxhim, së pari, me mbeturinat e fortë komunale dhe me mbeturinat e rrezikëshme nga industria, institucionet shëndetsore dhe prej blegtorisë dhe prej thertoreve.

Planet për menaxhim me mbeturinat dhe planet investuese për rrjetin e infrastrukturës në Maqedoni, në të cilën do të parashihen të gjitha fazat e menaxhimit me mbeturinat, patjetër duhet ti marrin para sysh ekonominë e metodave të volitshme teknike të zbatueshme dhe metodave të volitshme ekologjike në trajtim dhe në deponim final, principet në afërsi dhe në vetqëndrueshmëri dhe standardet e larta në mbrojtjen e mjedisit jetësor. Përsëri, procese të caktuara në ripërtirjen e shfrytëzimit të mbeturinës së krijuar mundet që të jenë të pazbatueshme ose me efekt të pavolitshëm në krahasim me harxhimet, për shkak të sasisë së vogël të mbeturinave dhe si rezultat i sajë për shkak të pragut ekonomik të pavolitshëm në madhësinë e instalimeve për trajtim të mbeturinës, pjesa më e madhe e aktiviteteve në paratrajtimin dhe deponimin e mbetjeve do të realizohen në nivel rajonal, me më shumë se 200.000 banorë.

Mbeturina e rrezikëshme nga institucionet shëndetsore do të grumbullohet dhe do të trajtohet në kapacitet special centralizues, para mënjanimit/deponimit final; fraksionet tjera të parrezikëshme në mbeturinat do të menaxhohen në vendosjen e sistemit rajonal për menaxhim me mbeturinat komunale.

Prodhuesit e sasive më të mëdha të mbeturinave të rrezikëshme do të detyrohen të ndërtojnë dhe të rekonstruojnë kapacitete pronësore për trajtim, stabilizim dhe deponim, në teritorin pronësor, kurse të njejtë do të punojnë me posedimin e lejes për kryerjen e aktiviteteve në menaxhim me mbeturinat. Fraksionet e selektuara nga mbeturina e rrezikëshme nga kapacitetet e vogla të ndryshme industriale dhe prodhuese mundet të trajtohen dhe të deponohen në kapacitet të përmisuar qendror, përderisa pjesë do të eksportohet sipas sistemit të veçantë rregullarë në kontrollë për transport të mbeturinës së rrezikëshme, në rast në kalimin e kufijëve shtetëror në pajtim me Konventën e Bazelit dhe me Direktivat e UE për transport të mbeturinës, pa marr parasysh në dedikimin për shfrytëzim të sërishëm, reciklim ose deponim të mbeturinës.

Nus-prodhimet shtazore që krijohen në objektet blegtorale dhe në thertoret patjetër duhet të trajtohen përkatësisht dhe të deponohen me qëllim që të pengohen rreziqet që mund të rezultojnë nga ato për shëndetin e kafshëve dhe të njerzive dhe të shfrytëzohet përmbajtja energjetike nga mbetjet.

Mbeturina nga stacionet e planifikuara për ripastrimin e ujrave të ndotura, veçanërisht fundrina mundet të nënshtrohet në paratrajtim në kapacitetet e pavarura ose në kapacitetet për trajtim të përbashkët me fraksione të veçanta të caktuara nga mbeturina komunale, pa marr para sysh rrjetin e stacioneve për pastrimin e ujit komunal të ndotur. Proceset teknologjike të zgjedhura në paratrajtim do të mvaren nga shfrytëzimi planifikues në bio-cikluset bujqësore, në revitalizacionin e deponive ose në proceset e prodhimit të energjis nga mbeturina.

Rrjeti i kapacitetit për grumbullimin, skladimin dhe paratrajtimin për rrjedhat e veçanta të mbeturinave do të planifikohet ndaj bazës së rezultateve nga studimet fizibile, në të cilat do të meren parasysh tregjet në dispozicion për materiale që duhen të reciklohen dhe për prodhime me afat të skaduar të

përdorimit ose për disa nga fraksionet e tyre, në vend ose në ndojërën nga vendet fqinje. Me rjedhat e veçanta të mbeturinave dhe prodhime të caktuara me afat të skaduar mundet të menaxhojnë, kryesisht, ndërmarje të vogla private me leje administrative për aktivitetet konkrete të menaxhimit me mbeturinat.

### ***Racionaliteti në menaxhimin me hapsirën dhe ruajtjen e trashëgimis natyrore dhe kulturore***

Territori i Republikës së Maqedonis paraqet vlerë nacionale dhe bazë për zhvillimin ekonomik dhe social në vend. Në lidhje me menaxhimin me mbeturinat, vendimet e veçanta të pranueshme janë vendimet me të cilat promovohet shfrytëzimi racional i tokës punuese, toka nën kullosat dhe nën malin, toka e dedikuar për vendbanimet dhe për aktivitetet prodhuese, si dhe ato të cilët janë themeluar në shfrytëzim racional dhe mbrojtja e resurseve të ujrave dhe në tokën.

Instalimet për menaxhimin me mbeturinat do të locohenë në rajonet e caktuara në largimin e pranuar nga vendbanimet, me qëllim që të minimizohen ndikimet e perceptcionit dhe dekoncentrimet e mundshme. Vendimet e këtilla do të jenë të bazuara në kritere të miratuara nga Qeveria dhe do të rezultojnë në ruajtjen dhe në përmisimin e cilësis së mjedisit jetësor.

Masat për ruajtjen dhe për mbrojtjen e trashëgimis natyrore dhe kulturore janë të lidhura ngushtë me shfrytëzimin e kufizuar racional të tokës, në resurset e ujrave dhe ekosistemin karakteristik; të gjitha masat do të rezultojnë në efekte të mjaftueshme afatgjate për mjedisin jetësor dhe për natyrën, si dhe në shfrytëzim të qëndrueshëm në të gjitha resurset natyrore në vend.

### ***Deponimi i mbeturinës stabilizuese dhe sasia e mbetjeve nga mbeturina***

Deponimi mbetet si opion i fundit, por i patejkalueshëm për deponim për pjesë tëpapërdorëshme nga mbeturina e krijuar ose për mbetjet nga mbeturina pas proceseve të ndryshme të trajtimit; kjo paraqet opcionin më të padëshiruar në hierarhinë e menaxhimit me mbeturinat edhe përkundër zbatimit të standardeve të larta teknike në ndërimin dhe në punën, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe të mjedisit jetësor.

Mbeturina e mbetur, gjegjësisht ato pjesë përbërse materiale dhe energjetike të mbeturinës të cilat tani më nuk munden që të shfrytëzohen, do të deponohet kryesisht si material i stabilizuar joreaktiv ose do të vazhdojë paratrajtimi para deponimit me qëllim që të stabilizohen mbeturinat, të zvogëlohet maksimalisht vullumi i lymit dhe të zvogëlohet mobiliteti i substancave të dëmshme dhe të rrezikëshme jashta kapaciteteve për deponimin nëpërmes ekstratit

Megjithatë, në periudhën e parë në vendosjen e sistemit për menaxhim me mbeturinën komunale mundet që të arrihen efektet vijuese:

Në përgjithësi, sasia totale e mbeturinave të cilat do të deponohen në deponitë do të rritet për shkak të rritjes së shkallës së mbledhjes së mbeturinave.

Vetëm disa lloje të mbeturinave pjesërisht mundet ti shpëtojnë deponimit në deponi. Mund të pritet zvoglim i caktuar i ekstrateve me përbërje të rrezikshme të mbeturinave dhe kontroll më i vogël i emisioneve të gazrave serë që prodhohen në deponit, me shfrytëzim të teknologjis më përparimtare.

Zbatimi i teknologjive në periudhat vijuese në vendosjen e sistemit për menaxhim me mbeturinën komunale patjetër duhet të sjellë deri te zvogëlimi i kontinuar në përmbajtjen e substancave të biodegraduara edhe në aktivitetin e tyre në deponit, kurse rezultati përfundimtar patjetër duhet të mbetet deponimi në mbetjet interne, që do të siguroj emisione të pranueshme dhe të kontrolluara nga kapaciteti për deponim.

Mbeturina e papërdorëshme urbane, me karakteristika të njejta me ato të mbeturinës inerte, do të deponohen në deponinë e veçantë pa mbetje nga mbeturina tjetër.

Deponimi i fraksioneve të rrezikëshme nga mbeturina mundet që të kryet vetëm pas paratrajtitit përkatës, me qëllim të imbolizohen pjesët përbërse të mbeturinës.

### ***Revitalizacioni i lokaliteteve të kontaminuara – vatrat ekologjike***

Lokalitetet e kontaminuar në mjedisin jetësor, d.m.th rajone industriale të kontaminuara dhe deponit josanitare komunale, paraqesin rrezik serioz për popullsinë që jeton në ose rreth rajonit të kontaminuar, përshkak të ndikimit direkt negativ ose indirekt ndaj shëndetit të tyre , nëpërmes bartjes së materieve ndotëse në zinxhirin e prodhimit të ushqimit, e pasfiduar prej emisioneve në ajër, në ujërat sipërfaqësore dhe tokësore edhe në tokë. Revitalizacioni i lokaliteteve të kontaminuara në mjedisin jetësor mundet të kontribuojë në masë të madhe drejt zvogëlimit të pasojave negative ndaj shëndetit të njeriut, sipërfaqet bujqësore, llojlojshmëria biologjike dhe natyra dhe përfundimisht ndaj prodhimeve ushqimore në tregjet maqedonase dhe të tjera.

Deponit e paligjshme dhe deponit tjera jo legale komunale paraqesin lokalitete të veçanta të kontaminuara në mjedisin jetësor të cilat në pjes më të madhe do të jenë të mbyllura ose të revitalizuara, në pajtim me prioritetet e vërtetuara të cilat janë në fuqi në varshmëri nga rreziqet ose nga ndikimet negative ndaj mediave të ujrave dhe ndaj vendbanimeve të afërta.

Revizioni ekologjik edhe analizat e rrezikut, në lidhje me vlerësimin e potencialit të rrezikshëm edhe në ndikimet e mjedisit jetësor nga lokalitetet e kontaminuara industriale do të shërbejnë si bazë primare për qasjen në revitalizacionin dhe për vendosjen e prioriteteve për revitalizacion.

Krahas kësaj , do të vendoset sistem i ri i tërsishëm në përgjegjësit ekologjike, i cili do të inkuadroj mekanizma ligjor, instucional dhe financiar me qëllim të formohet inkuadrim sistematik drejt zgjidhjes së problemeve me revitalizacionin e lokalitetave industriale të kontaminuar do të zgjedhen nëpërmes inkuadrimin të secilit rast të ndarë, veçanrisht nëpërmes negociatave me pronarët e rinjë të kapacitetet industriale dhe kapaciteteve e xeheve , duke pasur parasysh çështjet në sukcesionin juridik, kërkesat teknike të revitalizacionit, investimet e mundshme dhe finansimin e mundshëm.

### **3.4.2 Karakteristikat themelore e shemave gjenerale për menaxhim me mbeturinat**

Shema gjenerale për menaxhim me mbeturinat paraqet pasqyrë të masave themelore tekniko-teknologjiketë varura dhe të ndërlydhura midis tyre në sistemin për menaxhimin me mbeturinat, të cilat janë të domosdoshme për rritjen e madhe të shkallës së mbledhjes, për kryerjen e aktiviteteve me qëllim që të arrihet zvoglimi i shkallë-shkëllshëm i sasisë së mbeturinave edhe i potencialit të rrezikshëm të mbeturinave në vet burimin, zmadhimi i shkallë-shkallshëm i kualitetit të fraksioneve të mbeturinave të mbledhura me qëllim që të zvoglohet shkalla e shfrytëzimit të vlerës materiale dhe energjetikenga fraksionet e vlefshme të mbeturinave, të ndërtohen dhe të rikonstruktohen deponi për mbetje të mbeturinave sipas standardeve të UE dhe përfundimisht, të revitalizaciohen hapsirat e kontaminuara.

Masat teknologjike e paraqesin pjesën teknike në vendosjen sistematike në sistemet për grumbullimin dhe transportin e mbeturinës dhe vendosja e rrjetit infrastrukturor të kapaciteteve për shfrytëzimin, trajtim dhe deponim final të mbeturinës, duke pasur para sysh ndërtimin e pashmangshëm shumë fazësh të sistemit për menaxhim me mbeturinat, kurse si pasoj nga ajo efektet e ngadalshme ndaj zvogëlimit të sasis edhe në potencialin e rrezikshëm të mbeturinës në deponit.

#### ***3.4.2.1 Karakteristika themelore në shemën gjenerale për menaxhim me mbeturinën komunale***

Shema gjenerale për menaxhim me mbeturinën komunale supozon opsione paralele dhe të njëpasnjëshme të cilat i përfshijnë të gjitha masat e domosdoshme, nga grumbullimi, skludimi, shfrytëzimi i fraksionet të përdorshme, trajtim, deri te deponimi final i mbeturinës që e krijon vendbanimin e tërsishëm në Maqedoni. Kjo shem komplekse gjithashtu inkuadron opsione të caktuara për mbeturinat që e krijojnë ndërmarjet e vogla, prodhuese dhe shërbyese, për shkak të shpërndarjes hapsinore në sasi më të vogla mbeturinë e krijuar edhe shkaqet ekonomike edhe nga shkaqet tjera .

Shema gjenerale për menaxhimin me mbeturinë komunale i përfshin , së parin, aktivitetet vijuese teknike dhe masat:

### ***Zvogëlimi i sasisë së mbeturinës komunale dhe potenciali i sajë për rrezik të burimit***

Zvogëlimi i sasisë së mbeturinës komunale dhe potencialit të sajë për rrezik të burimit mundet që të arihet me

- stimulimin e përdorimit të afatgjatë në paketimin primar;
- kompostimin e fraktionit të bio-degraduese të mbeturinës nga amvisrit kur ajo është e pranuar në vendbanimet dhe shfrytëzimin e kompostimit në kopshtet;
- kompostimi i mbeturinës së gjelbërt nga sipërfaqet publike dhe nga sipërfaqet private të gjelbërta, siç janë parqet, kopshtet, pentarit, fidanishtet;
- grumbullimi i ndarë i pjesëve përbërse të rrezikëshme të mbeturinës komunale dhe dhënia e tyre sistemit për shfrytëzimin e të njëjtave.

Zvogëlimi më i suksessëm i pjesëve përbërse të rrezikëshme në mbeturinë komunale mvaret, në mas të madhe, nga sasia më e vogël e pjesëve përbërse të rrezikëshme në prodhimet dhe në paketimin, që plasohen në tregun.

### ***Grumbullimi i ndarë i llojeve të mbeturinave komunale***

Në përgjithësi, sasia e mbeturinës komunale rritet paralelisht me zhvillimin ekonomik në vend. Por, vetëm grumbullimi i ndarë i fraksioneve individuale të mbeturinës komunale të burimit mundet të rezultojë me zvogëlim më të madhë në sasin e mbeturinës së përzier komunale e dedikuar për deponim si mbetje të papërdorshme.

Bazat themelore për grumbullim me prioritetin më të lartë do të jenë:

- grumbullimi i mbeturinës së përzier komunale nga vendbanimet, duke shfrytëzuar numër të caktuar dhe orar të automjeteve ose thasë për grumbullimin dhe pajisjen përkatëse për stacionet tejet ngarkuese dhe për transportin e mbeturinës, sipas dendësis së vendbanimit dhe sipas madhësis së teritorit e përfshir me grumbullimin në pajtim me organizacionin rajonal të menaxhimit me mbeturinat;
- grumbullimi i ndarë i mbeturinës së grumbulluar, që kryhet me grumbullimin periodik nga trotoret ose me zbatimin e opcionit "sistemi i sjelljes" ("bring-system") që të grumbullohen fraksionet e mbeturinës së grumbulluar në "trualle për reciklim" d.m.th objekte për grumbullimin për fraksione të caktuara të mbeturinës ( gjithashtu përkatëse për mbeturinë e grumbulluar me pjesë përbërse të rrezikëshme);
- ofrimi i opcionit për pranimin e mbetjeve të rrezikëshme dhe fraksioni tjetër i mbeturinave nga amvisrit që mundet të reciklohet në "placet për reciklim".

Masat teknike për grumbullimin e llojeve prodhime të produkteve të caktuara me afat të skaduar të përdorimit që mund të realizohen lehtë me pjesëmarrje financiare të vogël të pronarit të mbeturinës ose pa pjesëmarrje të këtillë:

- grumbullimi i ndarë i paketimit sekundar dhe terciar në formë për material të pastër për reciklimin e tregjeve, në qendrat e mëdha distributive dhe të magazinave, në ndërmarjet prodhuese dhe grumbullimi separat në fletën për reciklim, në sasi të madhe, në institucionet publike.
- Grumbullimi i gomave të përdorura në vullkanizerët dhe në serviset e mekanikëve, në ndërmarjet transportuese edhe në "placet për reciklim" në periudhën kalimtare;

- Grumbullimi i automjeteve të shfrytëzuara në placet në puntorit e autorizuara, derisa janë të përgaditura për detoksikacion dhe demontazh.

Masat e caktuara teknike për grumbullimin e pjesëve përbërse të mbeturinës komunale që mund të riciklohet do të realizohen ngadalë, veçanërisht në vendbanimet me mbi 50.000 banorë:

- Përbërësit e mbeturinës komunale që mund të riciklohen, si fraksione të veçanta, të burimit, së pari, paketimi do të grumbullohet si teknik e grumbullimit nga trotoret ose me vendosje të "ujdhesave të grumbulluara".
- Grumbullim i ndarë i fraksioneve në mbeturinën komunale dhe sasi më të vogla në mbeturinat urbane të dedikuara për riciklimin e materialeve ose për shfrytëzimin për energjin mundet të zbatohet, gjithashtu, me zbatimin e opcionit "sistemi i sjelljes" në "placet për riciklim". "Placet për riciklim" do të renditen në lokacionet e deponive rajonale komunale dhe në lokacionet e stacioneve tejetngarkuese për mbeturin dhe/ose në sferat prodhuese/shërbyese të locuara në pajtim me planet lokale hapsinore në kufijt e vendbanimeve.
- Masat teknike për grumbullimin e llojeve të ndryshme të prodhimeve me afat të skaduar të përdorimit mundet të zbatohen sipas principit të përgjegjësisë së prodhuesit. Grumbullimi separat i prodhimeve me afat të skaduar të përdorimit, siç janë gomat e vjetra, automjete të vjetra, mbeturinat nga pajisjet elektronike, vajra të përdorur mineral, bateri dhe akulumator, mundet të zbatohen në rrjetin e placeve të specializuara për grumbullimin e riciklimin, të organizuar si shërbime publike ose në rrjetin për grumbullim të ndarë të organizuar nga prodhuesit.

#### **Përpunimi i mbeturinës komunale edhe i llojeve të veçanta si këmbim për resurset natyrore**

„Truallet për riciklim” mundet që të kenë funksion gjeneral si kapacitete plotësuese për pastrim për fraksionet grumbulluese, me qëllim që të arrihet cilësia e kërkuar sipas standardeve për riciklim edhe në kapacitetet për skladingim për kohën skladingimit në hymjen “ lëndë të para” dhe fraksionet e pastruara të mbeturinës. Këto funksione mundet ti kryejnë edhe ndërmarjet specializuese për ekonomizim dhe tregëti me lëndë të para sekundare, veçanërisht në raport me proceset e pastrimit, shtypjen dhe skladingim e fraksioneve për paketim primar.

Fraksionet e caktuara të selektuara të mbeturinës komunale, edhe ato që përmbajnë substanca të rrezikëshme, do të lajmërohen në kapacitete për trajtim dhe për deponim nga shkaqet ekonomike; bashkëpunimi me vendet fqinje llogaritet se është veçanërisht i rekomanduar.

Në çdo rast, “truallet për riciklim” të formuara në nivel rajonal, do ta ndërmarrin edhe funksionin e kapaciteteve për paratrajtim mekanik, me qëllim që të ndahet **fraksioni i lehtë** nga mbeturina komunale e përzier dhe të përgaditet lëndë djegëse sekundare për kapacitetin për prodhimin e energjis nga mbeturinat. Separacioni mekanik paraqet pjesë përbërse të instalimit për trajtim mekaniko-biologjik (TMB). Instalimi TMB mundet të siguroj nivel më të lartë të fleksibilitetit në shikim të përpunimit të mëparshëm në fraksionin separues të lehtë, nga njëra anë dhe trajtimi efikas biologjik në të mbeturinën **fraksion më i rënd** në pikëpamje të trajtimit të përbashkët, së bashku me fraksione të tjera në mbeturina organike, siç janë fundrinat nga stacionet ripastruese për ujë të ndotur komunal, prodhimi i shfrytëzimit të biogazit, prodhimi i mbetjeve biologjike stabile me përmbajtje të zvogëluar në pjesët përbërse biondërtuese, nga ana tjetër. Megjithatë, krahas fleksibilitetit më të vogël, instalimi për insineracion të mbeturinës komunale për shfrytëzimin e energjis, d.m.th prodhimi i energjis elektrike dhe shfrytëzimin i ngrohtësisë për nxemje qendrore, mbetet si opcion.

Mbetjet stabilizuese nga proceset e TMB mundet të mënjanohen me shfrytëzimin e tyre si material mbështjellës të deponive ose si material i përdorur për aktivitete të përgjithshme afatgjate të revitalizimit në sferat e larta ndotëse me deponi industriale dhe të minierës.

**Kompostimi** i mbeturinës së gjelbërt nga sipërfaqet publike dhe nga sipërfaqet private të gjelbërta, siç janë parqet, kopshtet, pemtarit, fidanishtet, do të zbatohet me qëllim që të reciklohet biomasa e tokës në nivel lokal ose në kombinim me mbeturinën organike nga prodhimi bujqësor.

Paratrajtimi, reciklimi i llojeve tjera të shfrytëzimit të **prodhimeve me afat të skaduar të përdorimit** mundet të zbatohen në nivel të ndryshëm të procesit teknologjik, në mvarshmëri nga karakteristikat e veçanta të prodhimeve, kapacitetet qasëse për reciklim ose për llojin tjetër të shfrytëzimit edhe nga ekonomia në madhësinë. Prodhimet nga proceset e paratrajtimit mundet të kalojnë në procese të ndryshme teknologjike të reciklimit edhe në deponim final që egzistojnë në Maqedoni edhe në vende tjera të botës.

- Aktiviteti kryesor i paratrajtimit për automjete të vjetra, në pikëpamje teknike, që do të kryhet në vend do të jetë detoksikacioni i demontimit të pjesëshëm.
- Grumbullimi, demontimi i detoksikacionit të baterive automobilistike dhe akulumatorëve do të nxitet me zvogëlimin e deponimit të tyre jolegal; nga shkaqet e njejta, do të vendoset sitem për grumbullimin në shitore edhe në serviset, për baterit e imta të harxhuara dhe akulumator të cilët zakonisht prolongohen së bashku me mbeturinën komunale.
- Demontimi i pjesëshëm dhe mënjanimi i pjesëve përbërse të rrezikëshme mundet të jenë detyrat e veçanta realizuese në menaxhimin me mbeturinën e pajisjes elektrike dhe elektronike.
- Gomat e vjetra mund të selektohen sipas përkatësis për ripërtirje; gomat e papërdorura mundet të ridërgohen në paratrajtim special për reciklim ose mundet të shfrytëzohen si lëndë djegëse sekundare në proceset industriale termale.
- Vajrat e grumbulluara minerale nga proceset prodhuese/shërbyese dhe vajrat shfrytëzuese të motoreve mundet të shfrytëzohen, përgjithësisht, në proceset e kontrolluara industriale; reciklimi i vajrave të përdorura ende mbetet si opcion nën kushtet e caktuara ekonomike.

Megjithatë, vendosja e rrjetit të kapaciteteve dhe kryerja e të gjitha aktiviteteve teknike në paratrajtim, reciklimi edhe në llojet tjera të menaxhimit të qëndrueshëm me prodhimet me afat të skaduar të përdorimit, në shtet dhe jashta shtetit, do të duhet të zbatohet në mënyrë ekonomike realizuese, sipas vendimit për ndërmarje prodhuese dhe tregtare.

## ***Rrjeti i kapaciteteve për trajtim dhe për deponim të mbeturinës komunale***

### ***Rrjeti i deponive rajonale për mbeturina komunale***

Kompleksi qendror nga kapacitetet infrastrukturore për mënjanim të mbetjeve nga mbeturina komunale do të jetë rrjeti i deponive në nivel rajonal, të cilat do të ndërtohen, përgaditen dhe do të punojnë sipas standardeve të UE për menaxhim me mbeturinat. Rajonet për menaxhim me mbeturinat do të paraqesin shoqëri të **domosdoshme të bashkësive për shkak të zgjidhjes së përbashkët të problemit me mbeturinën komunale**; madhësia e rajonit do të jetë në vëllim i cili mundëson instalimin e konceptit teknik për ekonomi financiare optimale të madhësis për deponit rajonale ose ndërkomunale.

Themelimi i kapaciteteve rajonale për deponimin e mbeturinave komunale, si obligim ligjor i bashkësive edhe për mbeturinën e caktuar të parrrezikëshme nga burimet tjera përbëhet nga vendimet vijuese konceptuale në lidhje me orarin, ndërtimit dhe i punës së deponive:

- Përcaktimi i standardeve teknike për menaxhim me mbeturinat për deponit e reja edhe për deponit e mbindërtuara ekzistuese, si edhe standardet minimale për punë për mbindërtimin e pjesës nga deponit ekzistuese për kohën e punës;
- Rekonstruimi dhe revitalizimi i deponive me rrezikshmëri të mesme për mjedisin jetësor si rezultat i kushteve të volitshme hidro-gjeologjike, me qëllim të sigurimit të lokacioneve kohore për mënjanimin e mbeturinave dhe të sigurohen kushte përkatëse për punë dhe ndikimi i pranueshëm ndaj mjedisit jetësor nga deponitë e tilla kohore.

- Rekonstruimi dhe mbindërtimi i deponive me rrezikshmëri të ulët dhe me ndikim të vogël ndaj mjedisit jetësor si rezultat i kushteve të volitshme hidro-gjeologjike, në nivel të deponive rajonale të parapare me ligj;
- Ndërtimi i deponive të reja rajonale, në pajtim me standardet e reja teknike dhe ekologjike.

Deponimi është fazë e fundit por edhe e pashmangëshme në hierarkin e menaxhimit me mbeturinat; por ky është opcioni i vetëm real për deponim final në mbeturinë e grumbulluar komunale deri te ndërtimi i “Trualleve për reciklim” dhe në infrastrukturën tjetër të plotësuar për trajtim të mbeturinës; përfundimisht, në deponit mundet të deponohen vetëm fraksionet e papërdorshme dhe stabile të mbeturinës komunale.

Në deponit e reja të rekonstruara, patjetër duhet të egzistoj hapsir e veçant e dedikuar për deponim të fraksioneve të parrrezikëshme të mbeturinës, derisa deponimi i përbashkët është i papranueshëm përshkak të karakteristikave të mbeturinave ose përshkak të teknologjis së deponis.

#### Rrjeti i kapaciteteve infrastrukturore për shfrytëzimin e materialit/energjisë nga mbeturinat komunale.

Në mes kapaciteteve plotësuese infrastrukturore, instalimet për trajtim mekaniko-biologjik (TMB) për mbeturinat komunale dhe paisjet për prodhimin e energjisë nga mbeturinat do të luajnë rol të rëndësishëm në qasjen drejt menaxhimit të qëndrueshëm me mbeturina komunale në fazën e dytë të zhvillimit.

Instalimet për (TMB) mund të jenë efektive në proceset e shfrytëzimit të fraksioneve të përziera të mbeturinave për materiale dhe energji, zvoglimi i pjesëve përbërëse biodegraduese në mbetjet e mbeturinave, stabilizimi biologjik mbetjeve nga trajtimi, ndërsa mund të shfrytëzohen edhe për revitalizimin e deponive edhe të vatrave të rrezikëshme ekologjike. Instalimet e tilla do të jenë të rradhitura në mënyrë racionale në hapësir, duke pasur parasysh madhësinë ekonomike, për arritjen e efekteve optimale finansiare; ata gjithashtu, mund të shfrytëzohen për trajtim paralel të fraksioneve të mbeturinave të caktuara të parrezikshme, nga industria ushqimore dhe industria e pijeve.

Mbeturina nga stacionet e planifikuara pastruese për ujin e ndotur komunalë, veçanrisht fundrina (milita), mundet të jetë e nënshtruar në paratrajtimin në kapacitete të pavarura ose në kapacitetet për trajtim të përbashkët me fraksione veçanërisht të caktuara nga mbeturina komunale, pa mar para sysh rrjetin e stacioneve ripastruese për ujë të ndotur komunal. Proceset e zgjedhura komunale për paratrajtim do të mvaren nga shfrytëzimi i planifikuar në bio-cikluset bujqësore, në revitalizacionin e deponive ose në prodhimin e energjis nga mbeturina.

Instalimet për prodhim të energjis nga mbeturinat e shfrytëzojnë fraksionin e lartë kalorik të fituar, kryesisht, nga separacioni mekanik i mbeturinës komunale ose nga pastrimi i fraksioneve të grumbulluara separate që mund të reciklohen, si lënd djegëse; ato duhet ti plotësojnë kërkesat për efikasitet të lart për prodhimin e energjis edhe për shfrytëzimin e energjis së ndotur ngrohëse.

Lokacionet përkatëse të instalimeve për prodhimin e energjis nga mbeturinat, ose, përderi sa zgjedhet opcioni për instalim qendror për insineracion për mbetje të përziera deri te mbeturina komunale, mundet të planifikohen në qytetet me rrjet të posaçëm për nxemje ose në pogonet prodhuese në kërkesa të larta të energjis për nxemje në proces. Mbjetet joreaktive nga trajtimi termal i mbeturinës komunale me pjesët përbërse imbolizuese të mundet të anulohen në deponit rajonale, me çka do të shkaktojnë ndikim më të vogël ndaj mjedisit jetësor.

#### **Mbyllje dhe revitalizimi (rimedijimi) i deponive të paligjshme për mbeturinë komunale**

Deponit komunale joligjore, të cilat paraqesin rrezik të lartë për mjedisin jetësor, do të mbyllen edhe do të planifikohen masa përkatëse për zbutjen e pasojave ndaj mjedisit jetësor.

Masat teknike për revitalizacion të deponive të paligjshme do të përbëhen, kryesisht, nga punët vendore dhe regullimi i pejsazhit, masa kundër lëshimit të ujit dhe formimit të shtresave të mbuluara, stabilizim plotësues i lymishtës dhe i mbylluar (i përcaktuar prerazi). Ndikim të veçant do ti kushtohet

në ndërprerjen dhe kontaktin në mes rrjedhjes së ujit nëpërmes trupit të deponis dhe ujrave nëntoksore dhe/ose sipërfaqësor dhe në instalimin e grumbullimit pasiv ashtu edhe atij aktiv dhe përfshirja e gazit të deponis. Materiali i grumbulluar i deponive të vogla të egra do të gërmohet dhe do të dërgohet në deponit e reja rajonale ose të përkohëshme.

Revitalizacioni i deponive, në bazë, është aktiviteti afatgjat; aktivitetet e këtylla mbesin prioritet në rastet në të cilat ka ndikim direkt ndaj burimeve të ujit për pije. Revitalizacioni do të zbatohet gjatë bazës të hetimit teren për kontaminimin e tokës, në ujin sipërfaqësor dhe nëntoksor, si dhe sipas studimet fisibile dhe mjetet që do të jenë të siguruara.

### **3.4.2.2 Karakteristike themelore në shemën për menaxhim me mbeturinën medicinale**

Mbeturina nga institucionet shëndetsore përbëhet nga fraksionet e rrezikëshme dhe të parrezikëshme, kurse edhe fraksione që mund të reciklohen; Suksesshmëria e sistemit të ardhshëm për menaxhim me mbeturinat në mas të madhe mbaret nga diciplina në ndarjen e mbeturinës në vet burimin. Aktivitetet teknike kryesore përbëhen prej

- Grumbullimit të ndarë të fraksionit të rrezikshëm të mbeturinës, Fraksioni i mbeturinës së njëjtë me mbeturinën komunale dhe fraksione të pastra për reciklim; fraksionet e rrezikshme do të paketohen në burimin, do të skladohen dhe do të transportohen sipas kërkesave sanitare në paketim të përmisuar;
- Grumbullimi dhe skladimi i fraksioneve separate të mbeturinës medicinale nga kapacitetet qendrore për skladim që bie në spitalet e përgjithshme, qendrat shëndetsore edhe në klinikat private;
- Ndarja dhe transportimi i mbeturinës së rrezikëshme të grumbulluar
  - Për skladimin (mbeturin radioaktive medicinale) ose
  - Deri te kapacitetet qendrore dhe/ose ndërajonale për trajtim/deponim, ose
  - Deri te lokacioni tjetër i kapacitetit për trajtim ose për deponim;
- Puna e kapacitetit për trajtim të mbeturinës së rrezikëshme insinerator ose autoklav, duke kyqur të gjitha aktivitetet e domozdoshme për mbajtje, monitorim edhe për lajmërim;
- Transporti i mbetjeve nga mbeturina e parrezikëshme nga procesi i trajtimit të mbeturinës medicinale për deponim, duke i inkuadruar regjistrimin e tipave, sasive dhe vendin e paracaktuar përfundimtar.

Mbetjet me aftësi për djegie me proceset të aktivizuara me autoklav mundet më tutje të shfrytëzohen si lënd djegëse në instalime për prodhimin e energjis nga mbeturinat.

### **3.4.2.3 Karakteristikat themelore të skemave për menaxhim me mbeturinat urbane**

Aktivitetet e ndërtimitaris gjenerojnë sasi të mëdhaja të mbeturinës, e cila nga ana tjetër mundet të shfrytëzohet përsëri në të njëjtën sferë teknike, si lënd e parë ose si aditiv. Fraksione të caktuara të drunjëve ose të plastikës mundet të shfrytëzohen edhe në prodhimin e energjis. Por mbeturinat e azbestit paraqet fraksion të rrezikshëm të mbetjeve/mbeturinave urbane ,e cila kërkon teknikë të veçantë të mbledhjes dhe deponimit. Masat vijuese të realizuara teknike dhe teknologjike llogariten si prioritare:

- Grumbullimi i mbeturinës urbane;
- Ndarja e fraksioneve me vlerë të burimit;
- Mbledhja e ndarë e mbeturinave me azbest në vet burimin dhe paketimi i mbeturinave në foli plastike;
- Ndarja në qendrat për reciklim, duke shfrytëzuar pajisjet stacionare ose mobile për përpunim;

- Ndërtimi i mono-deponive për mbeturinën urbane dhe pjesa tjetër që mbetet pas reciklimit ose deponimit në lokacionet e veçanta të deponive komunale;
- Deponimi i mbeturinave me azbest në qeli të ndara të kapaciteteve për deponim të mbeturinave urbane;
- Gërmimi dhe shfrytëzimi i mbeturinës urbane të deponuar ilegalisht , mundësisht si një nga opsionet për mbulimin e deponive komunale, kur nuk kërkohen masa të veçanta për revitalizimin në lidhje me ndikimin ndaj mjedisit jetësor.

#### **3.4.2.4 Karakteristikat themelore të skemës për menaxhimin me mbeturinat e parrezikëshme dhe të rrezikëshme industriale**

Gjatë procesit të aderimit drejt UE mundet të pritet ristrukturim intenziv i prodhimit maqedonas industrial, veçanrisht sipas kërkesave të direktivave për PIKN. Rezultatet e pritura nga ristrukturimi i industrisë do të jenë shfrytëzime më efektive të lëndëve të para dhe energjis, mbyllje intenzive të materialit ciklues prodhues dhe shfrytëzim i substancave më të vogla të rrezikëshme në prodhimet; të gjitha këto efekte paraqesin masa efektive për uljen në minimum të mbeturinës së burimit. Relacionet politike dhe ekonomike me UE dhe pronësia e përbashkët e kompanive, sipas skenaris optimistike, do të jep bazë për trajtim racional të mbeturinës edhe për deponim sigurues të mbeturinës së rrezikëshme dhe të parrezikëshme, si dhe për revitalizimin e ngarkesës në mjedisin jetësor i cili është pasojë nga menaxhimi i tanishëm jo i rregullt me mbeturinën e rrezikëshme.

Industria prodhuese e Maqedonisë dhe prodhimi i energjis do të zbatojnë tre masa themelore teknike për menaxhim të suksesëshëm me mbeturinën e rrezikëshme dhe të parrezikëshme:

- Mbeturina e rrezikëshme dhe e parrezikëshme udhëheqen ndarazi në burimin dhe ndarazi deponohen në deponit për mbeturin të llojit të ndryshëm.
- Rrjedha interne e lëndës së parë në proceset prodhuese udhëqet nëpër cikluse të cilat janë realisht të realizueshme ose rrjedha të veçanta të mbeturinës do ta gjejnë zbatimin e tyre në sektorët tjera industriale dhe energjetike si lënd e parë e ripërtirë sekundare.
- Menaxhimi me mbeturinën e rrezikëshme nga proceset e xeheve do të definohet nëpërmes shqyrtimit strategjik dhe sipas drejtimeve që rrjedhin nga rregullativa ligjore për xehetari.

Mbeturina e parrezikëshme, kryesisht me prejardhja minerale, veçanërisht mbeturina metalurgjike dhe bramc/hiri nga proceset termale dhe metalurgjike, mundet të shfrytëzohen si aditiv në ndërtimtarit ose prodhimin e çimentës, si shtesë e poshtme të rugëve. Fraksionet e këtylla nga mbeturina mundet, gjithashtu, të shfrytëzohen si material bazë ndërtimor për deponitë e dedikuara për deponim të mbeturinave të parrezikëshme nga prodhimtaria e rrethit. Mbeturina e parrezikëshme me prejardhja minerale, në varshmëri nga kompatibiliteti hemikal, mundet të deponohet në deponi komunale ose të shfrytëzohet si material plotësues ndërtues për deponit komunale.

Industria metalurgjike gjeneron bramc dhe pluhur fluturues, i cili paraqet sasi të kryesore të mbeturinave të rrezikëshme në Maqedoni. Në një të afërme të afërt, masat për zvoglimin e ndotjes së ajrit dhe ujit, siç është filtrimi i gazrave lëshues dhe i gazrave të oxhaqeve, trajtimi fiziko-kimik i ujrave të ndotur, do të gjenerojnë sasi shtesë të mbeturinave të rrezikëshme të cilat do të duhet të deponohen.

Bramci nga Zn/Pb dhe pluhuri nga gazi i oxhakut do të shfrytëzohen sërish dhe do të reciklohen në shkallë më të madhe, me teknika të ndryshme për paratrajtim edhe për nxehje të sërishme. Mbetjet e papërdorshme pas imbolozimit të pjesëve përbërse të demshme deponohen në kapacitet të ri të locuar për mbeturin të rrezikëshme ; deponia e përhershme do të revitalizohet.

Pluhuri që fluturon në ajr nga hekurishtet do të reciklohet me shfrytëzimin e çelikut të vjetër të standardizuar si lëndë e parë e kontrolluar. Mbetjet e papërdorshme pas imbolozimit të pjesëve përbërse të dëmshme do të deponohen në kapacitetin e ri përkatës të locuar për deponimin e mbeturinës së rrezikëshme; deponia egzistuese do të revitalizohet.

Për krijuesit e vegjël të mbeturinës së rrezikëshme, do të vendoset sistem përkatës për grumbullimin dhe deponimin, i përbër nga transporter të liçencuar, depo për grumbullimin dhe për skladimin e kapacitetit qendror për përpunimin dhe për deponimin e mbeturinës së rrezikëshme; gjithashtu, do të meret para sysh mundësi për shumë të mbeturinave të caktuara të rrezikëshme, siç janë PHB me vajrat ose në kondenzatorët elektrik si opcion i vetëm dhe më i realizueshëm, veçanërisht në periudhën e kalimtare.

Mbeturina e grumbulluar që mundet të djeget mundet të shfrytëzohet si lëndë djegëse sekundare në çementarën ose të ndizet në instalimin për insperacion të mbeturinës së rrezikëshme, së bashku me mbetjet e papërdorshme të pesticideve dhe paketimit të kontaminuar, përderisa ajo është e realizueshme.

#### ***3.4.2.5 Karakteristika themelore të shemeve për menaxhim me mbeturinën e bujqësis***

Fraksionet e mbeturinave nga bujqësia edhe nga aktivitetet e caktuara shoqëruese, plehërat e kafshëve, indi shtazor, dhe idet bimorë llogariten si mbeturin ose si nus-prodhim në marrëdhënie me dy opsione: përpunimi ose deponimi.

Skema për menaxhim me mbeturinën e bujqësis dhe me nus-prodhimet fillon me vendosjen e “ praktikës së mirë bujqësore”. Praktika e mirë bujqësore patjetër duhet të jet hap i rëndësishëm drejt përmisimit të veprim me mbeturinën e bujqësis dhe mënjanim të tij, veçanërisht në marrëdhënie me skladimin përkatës të mbeturinës së stabilizuar dhe zbatimit të sajë në sferat në periudh të kufizuar të vitit, përmisimi i kushteve të kafshëve dhe shëndetit në fermat e kafshëve dhe blegëtorve, ndryshimi i praktikës së deritanishme, me lirim e ndezjes ekologjike të pavolitshme të mbetjeve nga arat e mbjella dhe këmbimi me kompostim lokal dhe menaxhim të rregullt me mbetjet nga pesticidet dhe ndotja e kontaminuar.

Stabilizimi i plehërit të ahrit për zbatimin në bujqësi do të prodhohet me lagunirim të rregullt, skladim më të gjatë ose me trajtim aeroben/anaeroben; rrjedhjes nga lagunat për skladim/stabilizim të plehërit të ahrit do të pastrohen para se të lëshohen në ujrat nëntoksor, në stacionin ripastrues për ujrat e ndotura.

Plehëri i kafshëve do të shfrytëzohet si këmbim i shkëlqyeshëm për prodhimin e energjis së ripërtir (biogasi), me ndihmën e kalbjes anaerobne të lokacionit në fermën shtazore; instalimet e përhershme për biogasin do të rekonstruohen dhe do të ripërtihen. Kalbjet anaerobe paralele të plehrit të ahrit me kultura përkatëse si gruri dhe /ose me trajtimin e mëpërparshëm të nus-prodhimeve shtazore me rrezik më të ulët nga thertoret, në pajtim me kërkesat e dispozitave të UE-së për nus-prodhimet shtazore, mundet të locohet edhe në llokacione tjera të volitshme.

Do të vendoset struktura ekonomike të qëndrueshme të kapaciteteve për mbledhjen e ndarë(veç e veç) të indeve shtazore që i përkasin klaseve të ndryshme të rrezikshmërisë dhe kapacitete për inde shtazore me kapacitet të lartë të rrezikshmërisë (mbeturina të rrezikshme). Kapaciteti i tillë mund të organizohet si shërbim publik, por i ndërlidhur me procesin e djegies së kombinuar mish/eshtna në një proces përkatës prodhimit të energjisë nga indet e paratrajuara shtazore.

Struktura plotësuese teknike për trajtimin e indit shtazor me rrezik më të vogël do të përbëhet nga kapacitetet industriale.

- ku nus-prodhimet edhe fraksionet nga mbeturinat e selektuara për trajtim anaerob dhe aerob rrjedhin shtresa të zbatueshme në bujqësi pa kufizim ose
- ku nus-prodhimet mundet të gjejnë zbatim të vyeshëm ( prodhimi i yndirave, industria e ushqimit për kafshët shtëpiake,...).

Do të vendoset sistem i kthyeshëm për mbetje toksike agrokimike ( insekticide, fungicide) dhe për paketim e kontaminuar, me kthimin e mbeturinës së dërguesit për skladim kohor edhe për vendosje të mëtutjeshme, trajtim dhe/ose deponim.

Djegja e biomases së drurit është mënyrë tradicioanale e prodhimit të energjis së njetësis në shtëpit maqedonase; përsëri, stimulimi i grumbullimit të drurit për mbeturin në malet dhe në prodhimet e energjis me djegjen e ripërtirë të drurit për ngrohje nga biomasa mundet të futet në nivel të ndërmarjes (instalime lokale ose prodhime që mund të plasohen në tregë).

### **3.4.2.6 Revitalizacioni i lokaliteteve industriale, deponit dhe ngarkesa tjera në mjedisin jetësor në lidhje me ndikimin dhe me reziqet në mjedisin jetësor – vlerësimi dhe vendosja e prioriteteve**

Aktivitetet e sektorit të xehtaris dhe metalurgjis, veçanërisht praktikat të cilat janë larg me standardet që kërkohen për pakësimin në minimum të krijimit të mbeturinës edhe për menaxhim të drejt me mbeturinat, i kanë sfiduar ngarkesat më të mëdhaja të mjedisit jetësor në Maqedoni, Ligniti, xehja e bakrit, xehja e nikelit, dhe mineralet me ngjyrë gërmohenen në gërmesa të hapura, derisa xehja e plumbit dhe e cinkut gërmohen me ekstraksion, me aktivitetet nëntokësore xeherore. Punët nëntokësore xeherore zbatohet edhe për xehen e antimonit dhe gjatë ekstraksionit të asbestit. Xehetarët prodhojnë sasi të mëdhaja të xeheve dhe /ose flotacion shterpë dhe një të tretën nga mbeturina e hidroshterpëve e locuar në rrethin e xehetarëve posedojnë cilësi të rrezikëshme. Ndikimet e kontinuara negative ndaj mjedisit jetësor sfidohen nga menaxhimi jo i regullt me mbetjet e rrezikëshme nga industria metalurgjike dhe kimike dhe nga termo-centralet. Me zbatimin e **kritereve për cilësit e rrezikëshme** të rajonit të kontaminuar me mbeturinat, të njejtat janë të identifikuar si vatra ekologjike, kurse me zbatimin e kritereve për **kontaminimin e dëshmuar ose potencial** të tokës edhe në ujrat nëntokësor, si në kushtet lokale hidrogjeologjike, sferat e kontaminuara mundet të rangohen si vatra ekologjike me rrezik të lartë, të mesëm dhe të ulët.

Hetimet ekologjike dhe teknike të kryera deri tani dhe vlerësimet e preleminare të teknologjive përkatëse dhe të disponueshme për revitalizacion tregojn në opzione të ndryshme për revitalizacion që mund të zbatohen vetë ose me shfrytëzimin e metodave të kombinuara në shumë metoda teknike:

- Prishje selektive dhe mënjanimi sigures i ndërtimeve të vjetra të kontaminuara;
- Zbatimi i formës së lokacioneve për mbeturin me qëllim të kufizohet sipërfaqja që do të mbulohet dhe do të pyllëzohet ;
- Zbatimi i formës në lokacionet për mbeturinat, mbulimi me tokën ose me material të tokës punuese, pas së cilës vjen pyllëzimi; ( material për mbulesën: tokë natyrore ose maetrial të tokës punuese, d.m.th mbetje të stabilizuara organike nga trajtimi mekaniko-biologjik në mbeturinën komunale edhe nga fundrina nga uji i pastruar nga mbeturinat);
- Izolimi i lokacionit . izolimi i depos me mbeturin të rrezikëshme ose mbeturin që skadon, me tamponimin edhe me sistem drenazh për grumbullimin e ujit (të pandotur) rrjedhës, mbyllja e deponis për mbeturinat me më shumë shtres të pa lejuara ( nëse është e nevojshme, me pranimin e formës) edhe me pastrimin e formës) dhe me pastrimin e ekstratit të grumbulluar.
- Krijimi i barrierës hidrologjike për hollësimin dhe për pastrimin e ujrave të kontaminuara të ndotura;
- Gërmimi i mbeturinës së rrezikëshme dhe në tokën e kontaminuar;

- Deponimi i mbeturinës së rrezikëshme dhe toka e kontaminuar në deponin e sigurtë për mbeturin të rrezikëshme;
- Gjurmimi i pjesëve toksike organike nga tokat e kontaminuara;
- Inseracioni i mbeturinës që digjet ( lokal ose jashta vendit, në instalim fiksial ose në celurar për inseracion);
- Zbatimi i metodave të veçanta, siç janë:
  - Ngritja e mbulesës kohore mbi vendin për gjurmim, me hapsirë për pajisje dhe për automjete për gjurmimin dhe për transport, me qëllim të pengohen skadimet e ujrave të atmosferës dhe të kontrollohet era e pakëndshme.
  - Sistemi drenazh për grumbullimin e ekstraktit për pastrimin ose për opsionet e shfrytëzimit.
  - Mbulesa kohore ose basti me bashkime polimere, për shfrytëzim të mëvonshëm.

Zgjedhja finale e metodës dhe projektit me plan për revitalizim kryhet veçanërisht për secilën vatër ekologjike, pas përgaditjes së studimeve fisibile, dhe do të themelohet, kryesisht, në karakteristikat e materialit të deponuar të ndotur dhe/ose në tokat e kontaminuara, të kushteve hidro-gjellogjike edhe në hetim detal të tokës/ uji sipërfaqësor/ uji nëntoksor, për secilin lokacion ndarazi.

Proekte për remedijim me prioritet të lartë do të jenë ato ku vatrat ekologjike në tokat edhe në resurset e ujrave tani më janë dëshmuar dhe kur mundet të mobilizohen mjetet për finansim.

#### 4. MASA PËR REALIZIMIN E STRATEGJIS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT

Aritja e qëllimeve strategjike është e themeluar në zbatim të shkallëzuar në skemën e përgjithshme për menaxhim me mbeturinat, me të cilën deponohet koncepti i kornizës teknike dhe teknologjike për menaxhim me mbeturinat, e përshtatur drejt karakteristikave në mjedisin jetësor në Maqedoni. Dinamika e zbatimit të masave teknike dhe teknologjike rradhitet veçanërisht në investimet në kapacitetet për menaxhim me mbeturinat, me masat për stimulim të investimeve dhe me masat për mbulimin e harxhimeve për punën e sektorit të përgjithshëm për menaxhim me mbeturinat. Masat e nevojshme duhet të jenë të miratuara me zhvillim ekonomik në vend dhe me standardin e jetës së vendbanimit, njëra anë edhe me harxhimet e skenarive të pavoritshme dhe pasojave afatgjate për mjedisin jetësor dhe për ekonominë, nga njëra derisa koncepti për menaxhim me mbeturinat realizohet shumë ngadal edhe nëse nuk vendosen problemet themelore në sferën e menaxhimit me mbeturinat.

Zbatimi i suksesëshëm i konceptit për menaxhim me mbeturinat, i cili në masë të madhe përfshin shfrytëzimin e materialeve/energjis nga mbeturina mvaret nga sigurimi i masave siguroese të lidhura ngusht, në fakt rregullativa ligjore për menaxhim me mbeturinat, masat institucionale dhe organizative, masa ekonomike, masat për mbrojtjen e natyrës dhe trashigimis kulturore, masat për subjektet e interesuara edhe për zhvillimin e vetëdijes të publiku në lidhje me problemet me mbeturinat dhe nxitja e aktiviteteve hetimore dhe zhvillimore.

- Do të siguroj informata te publiku për çështjet e përgjithshme nga sfera e menaxhimit me mbeturinat, për ndryshimet e domozdoshme në sjelljen/qëndrimet në të gjitha antarët e shoqëris në lidhje me menaxhimin me mbeturinat dhe me fitime finansiare dhe efekte pozitive për mjedisin jetësor nga konceptet e këtilla dhe do të mundësoj informim të rikthyeshëm;
- Do të shpall material informativ si gazet e veçantë ose broshura;
- Do të përgadis, në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit, programet mësimore në të cilat do të jen të kyçura tema për mjedisin jetësor;
- Do të bashkëpunoj me organizatat joqeveritare dhe me instucionet shkencore.

Që të realizohet strategjia për menaxhim me mbeturinat ose proektet nga dituria nacionale, Zyra për Komunikim me Publikun do të përgatis/do të sigurojë model për realizimin dhe do të siguroj/do të organizojë kampanjë për ngritjen e vetëdijes publike për të gjitha subjektet e interesuara, veçanërisht për grupet e tanguara të tërsishme.

Zyra për Komunikim me Publikun, gjithashtu, do të udhëheq kampanja informative për ritjen e vetëdijes në krijuesit e mesëm dhe të vegjël në mbeturinën e rrezikëshme me qëllim që të realizohet kuptim, pranim dhe bashkëpunim në procedurat për identifikim, parandalimin, sjellja dhe shfrytëzimi dhe në vendimet për deponim final në mbeturinën e tyre.

Modeli për realizimin e strategjis për menaxhim me mbeturinat do ti përfshijë pikat vijuese analitike filluese:

- Identifikimi i brengës së publikut dhe i ekspertëve në lidhje me praktikën ekzistuese në menaxhimin me mbeturinat.
- Identifikimi i karakteristikave hapsinore, ekologjike, teknologjike, ekonomike dhe organizative në projektin.
- Caktimi dhe analiza e përvojave më të rëndësishme, problemet, perceptcionet, opinionet dhe pritje në lidhje me praktikën e tanishme dhe të planifikuar në menaxhim me mbeturinat.
- Analiza e mendimit publik për udhëheqsin ose për grupin udhëheqës të projektit publik.
- Identifikimi i grupeve qëllimore në publik dhe identifikimi i rjetit në aktorët kryesor në fazën e realizimit.
- Analiza e qëndrimeve në lidhje me problemet në mjedisin jetësor, veçanërisht në lidhje me metodat e reja në trajtim dhe deponim të mbeturinës si pjesë nga menaxhimi me mbeturinat.
- Analiza e karakteristikave socio-psikologjike dhe politike e banorëve të tanguar (indirekt).

Realizimi i strategjis për menaxhim me mbeturinat, si dhe në projektet nga sfera e menaxhimit me mbeturinat, imponon identifikimin e aktiviteteve përkatëse për ngritjen e vetëdijes publike të dedikuara për grupe konkrete të tërsishme, si dhe identifikimi i personave ose në grupet e tërsishme formale/joformale të cilat mund të kryejnë ndikim të fuqishëm në realizimin e projekteve. Karakteristikat e komunikimit për llojet e ndryshme të grupeve të tërsishme në publik, d.m.th udhëheqës të projekteve, publiku politik, publiku profesional, publiku i gjerë, mediat bashkësit lokale, janë shumë të ndryshme dhe për ato patjetër duhet të zbatohen masa të ndryshme për komunikim dhe masa tjera, që të arihet realizim i suksesëshëm i projekteve individuale në sferën e menaxhimit me mbeturinat.

## **5. PASQYR E PLANIT ME AKSIONET PËR ZBATIMIN E STRATEGJIS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT**

Arritja e qëllimeve strategjike të përcaktuar për tejkalimin e problemeve egzistuese dhe mangësit me menaxhim me mbeturinat dhe në rrug të veprimit efikas dhe efektive në raport të harxhimeve sistemi për menaxhim me mbeturinat dhe në rrugë të revitalizacionit të ngarkesës së madhe në mjedisin jetësor dhe në vatrat ekologjike imponon vëllim të gjërë të aksioneve të cilat do të zbatohen në të njejtën kohë dhe në periudh të gjatë afatgjate rreth 20 vite. Por, plani me aksionet për realizimin e strategjis për menaxhim me mbeturinat do ti përfshijë aktivitetet që patjetër duhet të ndërmeren në periudh më të shkurtër dhe më të paraparë në një afat prej 12 vitesh, me qëllim të përgaditet baza për vendosjen e sistemit teknik efektiv të menaxhimit me mbeturinat, i cili do të jetë efikas në marëdhëniet me harxhimet: Planin me aksionet për menaxhim me mbeturinat përfshin tre tema kryesore:

- Përcaktimi i prioriteteve të masave të ndërlidhura në mes veti dhe aktivitetet të drejtuara drejt ndërrimit të praktikave egzistuese në menaxhimin me mbeturinat;
- Masa/aktivitete konkrete kohore me të cilat do të mundësohet kalim më i lehtë drejt funksionimit të sistemit më bashkëkohor për menaxhim me mbeturinat;
- Vlerësimi i investimeve të nevojshme dhe i shpenzimeve të tjera shoqëruese fitimet afatshkurte dhe afatgjate.

Periudha e tillë e shkurtër, gjashtë vjeçare imponon sfidë të madhe për subjektet që vendosin të ndërmarin dhe ti zbatojnë ato masa prioritare të cilat përfundimisht do ti nxisin aksionet inicuese afatshkurte drejt përmisimit të praktikës egzistuese në menaxhimin me mbeturinat.

### **5.1. Prioritetet e masave dhe aksioneve**

Gjatë përcaktimit të aksioneve/masave afatshkurte, detyr më e rëndë është që të identifikohen prioritet, sidomos nga aspekti i mungesës, kufizimet dhe përpjekjet e nevojshme që duhet të investojnë që të realizohet sistemi integruar i menaxhimit me mbeturinat në pajtim me kërkesat vëllimore në UE, duke pasur para sysh gjendjen nënstandarde nismëtare që egziston në momentin.

Planin për realizimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat duhet, në thelb, të trajtohet si kompleks i instrumenteve me mvarshmëri reciproke për vendosjen e infrastrukturës themelore të funksionimit të qëndrueshëm për menaxhim me mbeturinat komunale dhe ato të rrezikshme dhe për revitalizimin e ngarkesave të caktuara prioritare të mjedisit jetësor në periudhën e paraparë 12 vjeçare.

Kriteret për zgjidhje të masave aksioneve prioritare dhe janë themeluar në model të thjeshtë i cili e reflekton radhitjen e logjikshme të zbatimit të kërkesave ligjore në sferën e menaxhim me mbeturinat:

- sigurimi i resurseve njerëzore dhe strukturave organizative

- përgatitja e dokumenteve politike dhe rregullative
- Përgatitja e dokumentacionit teknik dhe investues
- vendosja e sistemeve për mbështetje, sidomos për ngritjen e vetëdijes ke publiku dhe për mbështetje finansiare
- realizimi i investimeve në infrastrukturën themelore të menaxhimit me mbeturinat.

Përgatitja efektive e **detyrave politike/rregullative** dhe **formimi i strukturës së nevojshme** institucionale shkon pa shmangshëm paralelisht me përforcimin përkatës të **resurseve njerëzore**.

### **Korniza ligjore e menaxhimit me mbeturinat dhe instrumentet ekonomike**

Si sfera me **prioritet të lartë** , me të cilat duhet të fillohet, janë direktivat më të rëndësishme të UE-së të cilat duhet të transponohen dhe të kultivohen në legjislaturën e Maqedonisë, me qëllim të rumbullaksimit përkatësisht dekompletimit të **kornizës së përgjithshme ligjore për menaxhim me mbeturinat:**

- për menaxhim me mbeturinat
- për menaxhim me mbeturinat e rrezikëshme
- për deponimin e mbeturinave.

Përgatitja dhe miratimi i kornizës së përgjithshme për menaxhim me mbeturinat, me aktet nënligjore relevante, janë nën kompetencë të plotë të MMJPH. Vendosja e **sistemit të informimit** për menaxhim me mbeturinat llogaritet si vërtetë e rëndësishme, duke pasur parasysh statusin e tanishëm të mungesës së të dhënave për menaxhim me mbeturinat , në nivel nacional dhe lokal. Sistemi i këtillë do të paraqesë njëkohësisht masën për mbikqyrjen e”butë” të secilit krijuesi të mbeturinave, si dhe bazën e përgatitjes së planeve për menaxhim me mbeturinat, dokumente teknike dhe investuese, për mbikqyrje ndaj qarkullimit të llojeve të ndryshme të mbeturinavenë vend dhe për kompenzimet/plotësimet e kompenzimeve për menaxhim joadekuat dhe për deponim të mbeturinave të veçanta.

Por, zbatimi i rregullativës ligjore të sjellur për menaxhim me mbeturinat do të ndikojë pashmangshëm edhe në kompetencat e sektorëve të tjerë publike; kështu koordinimi efikas midis ministrive dhe koncenzusi i plotë do të jenë parakushte të pashmangëshme për zbatimin e suksesshëm të planit për realizimin e strategjisë. Do të jetë i domosdoshme **harmonizimi i interesave të ndryshme** i shoqërisë me qëllim që të bëhet ndryshimi i rregullativës ligjore në drejtim të sigurimit të prioriteteve të interesit publik, d.m.th. mjedisi jetësor mbi interesin e shfrytëzuesit individual.

Miratimi i ndryshimeve të tilla mund të sjellë deri ke sigurimi i bazës ligjore për dispozitat për kthimin e plotë të shpenzimeve për kryerjen e shërbimeve të menaxhimit me mbeturinat, pa marr parasysh se ajo do të bëhet me arkëtim direkt apo indirekt, e sidomos për formimin e fondeve të veta të cilët janë të domosdoshme për mbulimin e shpenzimeve për përgatitjen e studimeve fizibiliteti, dokumentacionit teknik/investues, ndërsa mund të përdoren edhe për ko-investim të caktuar në kapacitetet rajonale për menaxhim me mbeturinat. Amendmanet e miratuara me efekt direkt ndaj disiplinës pagesore mund të paraqesë bazën ligjore dhe realizimin praktik të instrumenteve ekonomike dhe financiare të cilat do të zbatohen për zvoglimin/përpunimin, si dhe për motivimin e sektorit privat që të konkurojë për kryerjen e shërbimeve të caktuara komunale, madje edhe të investojë në kapacitete të caktuara për trajtim të mbeturinave.

Instrumentet e vetme ekonomike, të cilat mund të zbatohen të pavarura, janë masat stimulative për energjinë e shitur, të fituar nga mbeturinat bio-degraduese ose fraksioneve të mbeturinave.

Të gjithë mund të jenë të vetëdijshëm se dokumentet e sjellura politike dhe ligjore paraqesin kusht sine qua non (parakusht absolut) për vendosjen e një sistemi të ri bashkëkohor për menaxhim me mbeturinat.

### **Struktura institucionale dhe aktivitetet**

Përgatitja e dokumenteve politike, rregullative, planore dhe teknike/teknologjike, si dhe zbatimi i procedurave të ndryshme për regjistrim/pasja me leje/liçenca dhe mbledhja/dorëzimi i të dhënave, si prioritet i lartë, **përforcimi i dukshëm i instrumenteve administrative, inspektuese dhe institucioneve të tjera** dhe do sjellë punësime të reja dhe trajnime të kuadrit. Numri i të punësuarve shtesë të trajnuar do të rritet pes vitet e para, ndërsa grupi i të punësuarve do të jetë i organizuar mirë në kuadër të sektorit për mbrojtjen e mjedisit jetësor, me ndarjen e qartë të përgjegjësi midis të punësuarve, ndërsa detyrimisht do të vendosen lidhje të bashkëpunimit të mirë ndër institucional, të cilët i përkasin resurseve të ministrive të ndryshme dhe midis institucioneve të nivelit shtetëror dhe lokal.

Akcenti kryesor i aktiviteteve të institucioneve dhe drejtorive të reja dhe atyre ekzistuese por të përforcuara, do të vëhet në përgatitjen e dokumenteve politike dhe investuese. Të gjitha këto aktivitete planifikohen të realizohen kryesisht me shfrytëzimin e ndihmës teknike nga kompanitë konsultative të vendit dhe të jashtme.

**Përgatitja e dokumenteve politike dhe planore** paraqet pjesën qendrore të të gjitha aksioneve të cilat propozohen për sektorin e menaxhimit me mbeturinat; ky proces kërkon një periudhë kohore prej 5 viteve. Përgatitja e planeve për menaxhim me mbeturinat, në nivele të ndryshme, duhet ti kyç aktivitetet të cilat janë themeluar me status të veçantë të llojeve të caktuara dhe llojeve të ndryshme të mbeturinave dhe të aksioneve të nevojshme për tejkalimin e praksës ekzistuese dhe inicimi i menaxhimit më të mirë përmes marrjes parasysh të kërkesave të përmbledhura në direktivat përkatëse të UE-së për menaxhim me mbeturinat:

- mbyllja e deponive komunale me rrezik të madh;
- plane për përshtatjen e deponive për mbeturina komunale;
- aktivitete për planifikimin e menaxhimit me mbeturinat e rrezikshme;

- planifikimi për zvoglimin e sasisë së mbeturinave bio-degraduese për mënjanim;

- planifikimi i aktiviteteve për menaxhim me mbeturinat/mbetjet urbane, përfshirë këtu kapacitetet e nevojshme për deponim;

- dokumentet politike për nxitjen e parandalimit ,shfrytëzimit të sërishëm dhe reciklimit, shfrytëzimit të mbeturinave për energji dhe përmirësimi i burimeve energjetike të qëndrueshme; dhe

-dokumente politike për zbatimin e masave(sistemeve) për lloje të veçanta të mbeturinave: vajrat e mbeturinave, mbeturin gomash, mbeturinë akumulatorësh, automjete të vjetra, PHB, mbeturina nga paketimet, mbeturina nga paisjet elektrike dhe elektronike së bashku me kampanjat promovuese publike dhe aksionet për mbështetjen e realizimit të të gjitha sistemeve të përmendura.

**Përgatitja e dokumenteve teknike dhe investuese** paraqet detarat tjera pas përpunimit të dokumenteve bazë politike dhe planore. Dokumentet teknike do ti përcaktojnë opcionet teknike për menaxhim me mbeturinat në aspekt teknik, dokumentet investuese do të japin përgjigje të saktë për vlerën e nevojshme të investimeve, për opcionet optimale teknike dhe ekonomike dhe për pasiguritë eventuale, për kornizën kohore të ndërtimit dhe për burimet reale të finansimit.

Nevoitet **vendim i shpejtë politik** për sistem rajonal të menaxhimit me mbeturinat dhe **themelim i këshillave rajonale** në nivel ndërkomunal për zbatimin e detyrave të rëndësishme organizative në sferën e menaxhimit me mbeturinat. **Qeveria** e sidomos **MMJPH** do ta nxisë dhe organizojë themelimin e grupeve të reja rajonale- ndërmarrjeve dhe /ose institucioneve për zbatimin e detyrave të sistemit për menaxhim bashkëkohor me mbeturinat, duke filluar nga planifikimi përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm teknik, investues, sigurimi i pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme, organizimi i resurseve të nevojshme për investime, deri sa të arrihet realizimi i investimeve në infrastrukturën e menaxhimit me mbeturinat dhe përgatitjes së dispozitave për sistemin e arkëtimit me qëllim të realizimit të ardhurave të nevojshme dhe të kthehen shpenzimet për shërbimet e kryera. Detyra të rëndësishme të institucioneve të reja rajonale paraqesin përgatitjen dhe zbatimin e planeve për mbylljen e destinacionit për mbeturina me rrezik të madh për mjedisin jetësor dhe për deponitë jo-standar për mbeturina komunale të komunave.

Aksion i rëndësishëm prioritar është **themelimi i organizatës qendrore për menaxhim me mbeturinat**

Me detyrë që të planifikojë, proektoj, ndërtojë dhe menaxhojë me kapacitete për deponim të mbeturinave të rrezikshme, në nivel nacional. Organizimi i tillë (ndërmarrje publike ose firmë në pronësi të përbashkët publik-privat ) do të sigurojë shërbime për llojet e ndryshme të mbeturinave të rrezikshme industriale të krijuar nga krijues më të vegjël të mbeturinave, në lokacione të ndryshme i cili nuk mund të shfrytëzohet rishtas apo të reciklohet; kapaciteti për mbeturina të rrezikshme do të përfshijë kryerjen e llojeve të ndryshme të trajtimit, deponimi, ndërsa përderisa është ekonomokisht e realizueshme, instalim për djegie të mbeturinave të rrezikshme).

Nxitja e **skemave për traktate vulnetare të ndërlidhura me menaxhimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave** sipas parimit për "përgjegjësia e prodhuesit" mund edhe të mos jetë aktivitet prioritar, por planifikimi operativ dhe vendosja e sistemit për menaxhim me mbeturinat për llojet e veçanta të mbeturinave mund dukshëm të përmbajë zgjidhje të caktuar për llojet e veçanta të mbeturinave, për zvoglimin e presionit të deponive dhe për zbutjen e rrezikut në mjedisin jetësor. Skemat e këtilla kërkojnë involvimin minimal të qeverisë, detyra e së cilës do të përbëhet, kryesisht, nga vënia e rregullave për orientimin e shpenzimeve intere për zvoglimin e çmimeve të produkteve të reja të cilat do të shiten dhe për rrjedhën pagesore, si dhe për përcjelljen e punëve organizative/finansiare dhe në arritjen e qëllimeve kuantitative për shfrytëzimin e fraksioneve të mbeturinave ndaj kërkesave të direktivave të PIKN.

MMJPH, gjithashtu menjëherë do të fillojë negociatat me sektorin prodhues për gjetjen e një zgjidhje më të shpejtë dhe më të realizueshme për deponimin e mbeturinave të tyre të rrezikshme dhe për revitalizimin e vatrave ekologjike me qëllim të zbutjes së ndikimeve të tyre ndaj mjedisit jetësor.

### **Infrastruktura teknike prioritare**

Përgatitja e njëpasnjëshme e dokumenteve teknike dhe investuese dhe kërkesat për finansim janë detyrat primare për sa i përket fillimit të investimeve në infrastrukturën primare teknike. këto detyra mund të redukohen (përmbledhen) në dy aktivitete themelore:

-përgatitja e proekteve teknike dhe studimet fizibiliteti dhe

-përgatitja e kërkesës për finansim dhe investim, siç janë kërkesat e IPA-s studimet fizibiliteti tani më të përgatitura.

Mbyllja e deponive të egra dhe e deponive me rrezikshmëri të lartë, si dhe ndërtimi/rikostruimi i njëpasnjëshëm i kapaciteteve qendrore për menaxhim me mbeturinat – deponitë rajonale, pritet të realizohen në periudhën kohore prej 9 vitesh.

Vendosja e *infrastrukturës prioritare teknike për menaxhim me mbeturinat komunale dhe me mbeturinën tjetër të parrrezikëshme*, do të fokusohet, kryesisht, në organizimin e grumbullimit të mbeturinës, me ndarje të shkallëzuar të rrjedhave të selektuara të mbeturinës në vet burimin, ndërtimi i kapaciteteve transportuese, mbyllja e deponive të egra dhe deponive jostandarde dhe ndërtimi/mbindërtimi deponive standarde rajonale për mbeturin të rrezikëshme, të cilat do të fokusohen si kapacitete qendrore në sistemin rajonal për menaxhim me mbeturinën komunale. Infrastruktura teknike për veprimin me mbeturinën interne, mbeturinën kryesore ndërtuese, mundet që të zhvillohet me dhënien e mundësive në sektorin privat, ndaj bazës së licencës.

*Menaxhimi me mbeturinën e rrezikëshme që krijohet në industrinë, instucionet shëndetsore, fermat blektorale edhe në thertoret* si prioritet i parë, do të përfshijnë masat për separacion të fraksionet të rrezikëshme dhe të parrrezikëshme të mbeturinës në burimin e krijimit të tijë, si dhe përgatitja e planeve për menaxhim me mbeturinat dhe investimet. Përpunimi i dokumenteve teknike investuese në lidhje me teknologjitë e reja për përpunimin dhe revitalizimin e vatrave ekologjike. Investimet në paisjen e re për procesin teknologjik dhe në kapacitetet për trajtim/deponim të mbeturinave të rrezikshme mund të zhvendosen drejt pjesës së dytë periodike të realizimit të strategjisë për menaxhim me mbeturinat.

Kryesisht, **llojet e veçanta të mbeturinave**, siç janë paketimet dhe mbeturinat nga paketimi gomat e vjetra, akulumatorët e automjeteve, automjetet e vjetra, mbeturinat nga paisjet elektrike dhe elektronike dhe produkte të tjera të veçanta me afat të skaduar të përdorimit janë me rëndësi më të vogël dhe mund të realizohen në fazën e dytë të zhvillimit, edhe pse një pjesë e tyre mund të menaxhohen përmes pjesëmarrjes së sektorit privat dhe përmes shemave vullnetare sipas parimit “përgjegjësia e prodhuesit”.

Përgatitja e dokumentacionit përkatës teknik dhe investues për kapacitetet e dedikuara për zvoglimin e mbeturinave bio-degraduese të deponuara, për shfrytëzimin e mbeturinave për prodhimin e energjisë mundet të shqyrtohet menjëherë pas njohurive detale për sasinë dhe për përbërjen e llojeve të mbeturinave, të cilat përmbajnë mbeturina bio-degraduese dhe jo-degraduese. Realizimi i proekteve të tilla për menaxhim me mbeturinat dukshëm do të kontribuojë për zvoglimin e emisioneve të gazrave të qelqta që lëshohen nga menaxhimi me mbeturina dhe me ujrat e ndotur.

## **Vetëdija e publikut dhe e krijuesve të mbeturinave për menaxhimin me mbeturinat**

Vendosja e infrastrukturës teknike prioritare për menaxhim me mbeturinat komunale dhe mbeturinat e tjera të parrezikshme do të inicohet me aktivitete të gjera për informim, të orientuara drejt uhvillimit të vetëdijes së publikut dhe të vetëdijes ke krijuesit e mbeturinave, të shoqëruara me aktivitete dhe kampanjave efektive promovuese përmes komunikimit me publikun me të cilat do të mbështeten aktivitetet e tjera profesioniste në procesin e realizimit të sistemit të planifikuar për menaxhim me mbeturinat.

### **Masa të veçanta kohore dhe aktivitete**

Me qëllim që të mundësohet kalim më i lehtë drejt funksionimit të menaxhimit më bashkëhor me mbeturinat, do të jenë masa dhe aktivitete të domozdoshme të caktuara të pashmangëshme kohore. Mbyllja e deponive jo standarde për mbeturinën komunale në Maqedoni mundet që të sjell deri në mangësi të papranueshme të kapaciteteve për deponim të mbeturinës komunale. Zhgjidhje të përshtatëshme për periudhën kalimtare, konsiderohet, është përgaditja e planeve për përshtatjen dhe rekonstruimin e deponive të zgjedhura me qëllim që të zgjidhet problemi i mangësis së kapacitetit për skladim drejt rrugës së **deponimit kohor të mbeturinës komunale**. Deponit egzistuese, por të rekonstruara, do ta pranojnë mbeturinën komuale nga komunat e ndryshme të cilat do ta formojnë rajonin e ardhëshëm për menaxhim me mbeturinat dhe të njejtat duhet të punojnë sipas standardeve bashkëohore për punë. Deponit që do të parashihen për rekonstruim patjetër duhet të plotësojnë kritere të caktuara në aspekt të karakteristikave në lokacionet, logjistika transportuese dhe afërsia e vendbanimeve, e kushteve hidro-gjeologjike dhe kushteve gjeologjike dhe kufizimet, si dhe në shikim të kufizimeve nga aspekti i mbrojtjes së natyrës dhe ndikimet e vërtetuara ndaj mjedisit jetësor. Detyra primare e MMJPH është që të zgjedh lokacione në lokacione egzistuese, të cilat mund të jenë përkatëse që mënyr teknike të mbindërtohen deri në shkallën e kapaciteteve standarde të tërsishme për menaxhimin me mbeturinat në fund të periudhës kalimtare.

Sa i përket menaxhimit me mbeturinën e rrezikëshme në periudhën kalimtare, në krijuesit e llojit të këtill duhet që tu jepet periudh e caktuar që të përgaditen dhe ti realizojnë investimet e nevojshme për kapacitet, tretman dhe për deponim. Në **periudhën kalimtare**, MMJPH, ME dhe krijuesit e mbeturinës patjetër duhet të investojnë përpjekje të mëdha me qëllim të gjejnë **vendime ekologjike dhe financiare të pranueshme për deponim të fraksioneve e ndarae të rrezikëshme**, në mënyr i cili sfidon ndikim më të vogël negativ ndaj mjedisit jetësor sipas masave teknike momentale qasëse.

### **5.3 Vlerësimi i investimeve i fitimeve të nevojshme**

Shpenzimet e tërsishëme kapitale të ndërlidhura me transponimin e Direktivave themelore të UE-së të ndërlidhura me çështjen e menaxhimit me mbeturinat në kornizën ligjore maqedonase dhe zbatimi i tyre i plotësishtëm vlerësohet diku rreth 400 milion €. Shpenzimet e investuara për remedijacionin e deponive komunale të mbyllura vlerësohen në vlerën përafërsisht prej 30 milion €. Shpenzimet investuese shtesë prej rreth 77 milion € janë të nevojshme për

aktivitetet për remedijacionin e vatrave prioritare ekologjike. Këto shpenzime kapitale nuk i përfshijnë investimet për transponimin/zbatimin e Direktivave të UE-së për lëndë të para minerale, Regulative e UE-së për nus-prodhimet e kafshëve dhe Direktiva për insinerimin e mbeturinave.

Me qëllim që të arihen së qëllimeve themelore për zvoglimin e ndikimeve negative ndaj mjedisit jetësor të cilat i shkaktojnë mbeturinat, investimet prioritare në transponimin e regulativës ligjore dhe në infrastrukturën për mbeturina komunale dhe të rrezikëshme, duhet të arrijnë, në nivel vjetor, rreth **1,5% nga BPV** (vlera e përdorëshme referente është 5,77 miliard dollarë amerikan në vitin 2005). Kapacitetet e posifistizuara teknologjike për tretman bioteknologjik dhe termal të mbeturinës do të kërkojnë investime shtesë kapitale; këto investime do të bëhen të pa shmangëshme në fund të periudhës për zbatimin e strategjis për menaxhim me mbeturinat. Rreth 10% nga investimet vjetore në vendosjen e sistemit për menaxhim me mbeturinat do të harxhojnë për mbullimin e harxhimeve të lidhura me personalin për transponim juridik dhe për zbatim, si dhe për ndihm teknike në procesin e transponimit dhe zbatimit. Sipas vlerësimeve të para, rreth 40% e të gjitha investimet do të realizohen në industri, ndërsa rreth 60% do të realizohen nga resurset publike, në proekte për vendosjen e sistemeve dhe infrastrukturës për menaxhim me mbeturinat.

Zbatimi i Strategjis për menaxhimin me mbeturinat do të vijë deri te ndryshimet më të mëdha në veprimin, tretmani dhe deponimin e mbeturinave në ven, si dhe ndryshime në shikim të shfrytëzimit të mbeturinës si material dhe për energji dhe përpunim i fraksioneve të përdorura. Përfitimet kryesore nga zbatimi i qëllimeve strategjike themelore në menaxhim me mbeturinat do të jenë:

- Zvoglimi i numrit të të sëmurëve nga frymëmarrja dhe shqetësimi i banorëve lokal me zhurmë dhe rreziqe të zvogluara për shëndetin nga ujrat e kontaminuara, ajri dhe toka punuese.
- Përfitime për ekosisteme dhe resurse të tjera në mjedisin jetësor me zvoglimin e emisioneve nga aktivitetet e ndërlidhura me mbeturinat në ujrat, ajrin dhe tokën punuese dhe me zmadhimin e shfrytëzimit të energjisë nga mbeturinat;
- Rreziqet e zvogluara shëndetësore nga eksplozimet, si dhe ndikimet më të vogla ndaj ngrohjes globale me përfshirjen e emisioneve të metanit nga deponitë dhe shfrytëzimin e tyre për prodhimin e energjisë;
- Ndotje më të vogël të ujrave nëntokësore dhe sipërfaqësorë nga shtrydhja e deponive të pambrojtura, kurse si rezultat i kësaj rreziqe më të vogla nga kontaminimi i ujit të pishëm, tokës punuese, prodhimet bujqësore;
- Rritja e efikasitetit në shfrytëzimin e materialit dhe prodhimtaria e zvogluar e materialit primar si rezultat i rritjes së nivelit të reciklimit;
- Shpenzime më të vogla për mbledhje, tretman dhe deponim të mbeturinave, duke pasur parasysh se do të prodhohen më pak mbeturina;
- Menaxhim më i mirë dhe monitorimi i llojeve të mbeturinave.

#### **5.4 Pasqyrë e planit me aksionet për menaxhim me mbeturinat**

Që të mundësohet instalimi i infrastrukturës bazë të shëndoshë ekologjike teknike për menaxhim me mbeturinat komunale dhe mbeturinat e rrezikëshme, duhet të silllet strukturë ligjore përkatëse, institucionale, organizative dhe strukturë tjetër ndihmëse, si dhe strukturë financiare. Nuk mund të bëhet dallim çka

është më me rëndësi, sepse të gjitha parakushtet krijojnë kushte për funksionimin e infrastrukturës teknike. Elementet integrale dhe të gjitha çështjet e shqyrtuara do të krijojnë strukturë të përgjithshme për planin me aksione për menaxhim me mbeturinat, ku prioritetet kryesore janë rolet e theksuara dhe përgjegjësitë e të gjitha subjekteve të involvuara në menaxhimin me mbeturinat.

Plani aksional për zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat është i strukturuar sipas aktiviteteve kryesore, për të cilat janë përcaktuar subjektet e involvuara dhe përshkrim konciz i lëndës themelore, si dhe fillimi i prituri i aktiviteteve dhe periudha kohore e realizimit në kornizat e secilës detyr të planifikuar. Detyrat dhe obligimet të lidhura në mes veti me prioritet më të lartë do të realizohen paralelisht; sipas asaj, është evidente se detyra të ndara, sidomos ndërtimi i instalimeve me teknika më të mëdhaja dhe kërkesa financiare, mundet të inicohen vetëm në periudhën 12 vjeçare, me përpunimin e dokumentacionit teknik dhe investues.

Masa/aksione bazë të ndërlidhura midis tyre janë prezentuar dhe përshkruar shkurt në grupet në **Tabelën 1:**

**Tabela 1: Pasqyrë e planit të Tabela 1: Pasqyrë e planit aksional të strategjisë për menaxhim me mbeturinat me subjektet e involvuara kompetente dhe masat/aksionet themelore të ndërlidhura midis tyre**

MASAT	SUBJEKTET	LËNDA E DETYRAVE DHE AKTIVITETEVE THEMELORE	VITET E ZBATIMIT												
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
<b>Masat politike dhe ligjore</b>															
Transponimi i plotë i kornizës ligjore	MMJPH	Transponimi i Direktivave të UE-së dhe ndryshimi i rregullativës ligjore për mjedisin jetësor dhe rregullativa tjetër ligjore e tanguar, Transponimi i dispozitave dhe qëllimeve nacionale në nivel lokal, përgatitja e akteve nënligjore, standardet teknike, kodekset e sjelljes, metodologjia për lajmërim dhe doracakët	x	x	x	x									
Instrumentet për monitorim dhe zbatim	MMJPH	Rregullimi i dhënies së lejeve dhe liçencave, vlerësimi dhe rregullimi i dënimeve dhe kompenzimeve të barabarta me shpenzimet reale për dëmet në mjedisin jetësor të shkaktuara nga menaxhimi jo i rregullt me mbeturinat, përcaktimin e procedurës për zbatimin arkëtimit të kompenzimeve për shërbimet e kryera.		x	x	x	x								
<b>Struktura institucionale dhe organizative dhe ekzekutimi i masave</b>															
Ndarja e kompetencave në nivel nacional, emrimi i organeve kompetente/personave															
Ndarja e kompetencave, obligimeve dhe përgjegjësi	Qeveria dhe Kuvendi, MMJPH, TVM,	Koordinimi i obligimeve dhe kompetencave midis ministrive në lidhje me zbatimin e strategjisë për menaxhim me mbeturinat; vënia	x	x											

	MSH,MVL,MF, ME, MBPAU	e një trupi koordinativ dhe mbikqyrës midis ministrive.																		
Formimi i sektorit për menaxhim me mbeturinat	MMJPH – Sektori i menaxhimit me mbeturinat MMJPH-ZKP	Planifikimi; detyra administrative (leje, lajmërimi); koordinimi i studimeve konceptuale, studimet fizibiliteti, studime për vlerësimin e rreziqeve studimeve të tjera në sferën e mjedisit jetësor, aspektet institucionale dhe financiare; promovimi i kampanjave promovuese si aktivitete ndihmëse dhe detyra të tjera të ndihmës teknike	x	x	x	x														
Emrimi i grupeve/personave përgjegjës në ministrinë e tjera, institucionet dhe në sektorin prodhues	MBPAU,MSH,MBPU i institucionet e shëndetësore,krijuesit e mbeturinave industriale dhe të tjera, fermerit blegtorale	Planifikimi;detyra konceptive, teknike dhe realizimi, struktura institucionale dhe financiare; promovimi i kampanjave publike si aktivitete ndihmëse dhe detyra të tjera të ndihmës teknike në lidhje me menaxhimin me mbeturinat e rrezikëshme medicinale, mbeturinat nga blegtoria dhe nga therrtoret		x	x	x	x													
<b>MASAT</b>			<b>VITET E ZBATIMIT</b>																	
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12						
<b>STRUKTURA E NDËRLIDHUR INSTITUCIONALE MIDIS NIVELIT SHTETËROR DHE LOKAL DHE SEKTORIT E TJERA</b>																				
Struktura e ndërlidhur institucionale për sistemin e menaxhimit me <i>mbeturinat e rrezikshme industriale</i>	MMJPH, krijuesit e mbeturinave të rrezikshme, poseduesit e deponive të mbeturinave të rrezikshme	Vendosja e organizimit në nivel shtetëror për planifikim, projektim, sigurimi i resurseve financiare, ndërtimi dhe puna e kapacitetit për trajtim/deponim të mbeturinave të rrezikshme. Krijimi i skemave për menaxhim me mbeturinat e rrezikshme, planet,ekzekutimi i studimeve fizibiliteti për shkallën e zgjedhjeve të centralizuara./decentralizuara/eksportuese		x	x	x														
Struktura e ndërlidhur institucionale për menaxhim me mbeturinat nga <i>institucionet shëndetësore</i>	MMJPH;MSH; institucionet shëndetësore	Vendosja e sistemit organizativ për projektim,ndërtim dhe puna e kapacitetit për trajtim/mënjanim/deponim të mbeturinave të rrezikshme medicinale Ekzekutimi i studimeve fizibiliteti	x	x	x															
Struktura e ndërlidhur për sistem të menaxhimit <i>me nus-prodhimet e rrezikshme të kafshëve nga fermat blegtorale dhe therrtoret</i>	MBPAU,MMJPH,krijuesit e nus-prodhimeve të kafshëve	Vendosja e organizimit në nivel shtetëror për planifikim, projektim,sigurimi i resurseve financiare, ndërtimi dhe puna e kapaciteteve për trajtim/deponim të nus-prodhimeve të kafshëve. Krijimi i skemave për menaxhim me mbeturinat me nus-prodhimet nga kafshët, planet,ekzekutimi i studimeve fizibiliteti për opsione teknike për deponim.		x	x															
Struktura e ndërlidhur institucionale për menaxhim me <i>mbeturinat komunale</i>	MMJPH,MVL, komonat(niveli rajonal-NMMFK)	Themelimi i grupeve ekzekutuese për investime dhe punë në nivel rajonal (NMMFK) me detyra të ndryshme teknike, detyra për menaxhim me hapsirën, detyra ekonomike, organizative dhe operative për përgatitjen e skemave për menaxhim me mbeturinat, plane dhe raporte, për dokumente teknike dhe investuese, për parashtrimin e kërkesës për finansim nga fondet ndërkombëtare, për afarizëm me infrastrukturën dhe shërbimet,për finansimin për funksionim të integruar të menaxhimit me mbeturinat komunale, për	x	x	x															

		mbylljen/sanimin e deponive të egra, për zvoglimin e bio-mbeturinave të deponive.																		
Struktura e ndërlidhur institucionale për menaxhim me <i>llojet e veçanta të mbeturinave</i>	MMJPH,ME,MF,sektori relevant ekonomik	Vendosja e strukturës organizative,finansiare dhe operative për mbledhje trajtim, përtmirësim/reciklim dhe deponim të llojeve të veçanta të mbeturinave d.m.th. prodhime të vjetra. Krijimi i skemave për menaxhim me mbeturinat, planet, studimeve fizibiliti për menaxhim me llojet e veçanta të mbeturinave (paketimi dhe mbeturinat nga paketiimi, mbeturina me PCB, akumulatorë dhe bateri, mbeturina nga paisjet elektrike dhe elektronike, gomat e vjetra);			x	x	x	x												
<b>MASAT</b>	<b>SUBJEKTET</b>	<b>LËNDA E DETYRAVE DHE AKTIVITETEVE THEMELORE</b>	<b>VITET E ZBATIMIT</b>																	
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12						
Struktura e ndërlidhur institucionale për menaxhim me <b>automjetet e vjetra</b>	MMJPH, MF, MPB, sektori relevant ekonomik	Vendosja e strukturës organizative, finansiare dhe operative për mbledhje, trajtim, rimëkëmbje/reciklim dhe deponim të automjeteve të vjetra. Krijimi i skemës për menaxhim me automjetet e vjetra, plani dhe studimet fizibiliti; vënia e sistemit të ndërlidhur për vërtetim-regjistrim/shkatërrim.		x	x	x	x	x												
Tregu konkurues për shërbimet e menaxhimit me mbeturinat dhe pjesëmarrja në sektorin privat	MMJPH, MVQL, komunat(niveli lokal-NMMFK)	Reforma e shërbimeve komunale për menaxhim me mbeturinat; vendosja dhe zbatimi i tenderëve për shërbim, monitorimi dhe kontrolli i punës së dhënësve të shërbimeve dhe të menaxhimit me mbeturinat e forta komunale		x	x	x														
Struktura institucionale për zbatimin e instrumenteve finansiare/ekonomike	MMJPH, MF, komunat (niveli rajonal-NMMFK),operatorët për menaxhim me mbeturinat, krijuesit e mbeturinave, asociacionet ekonomike	Formimi i sistemit të kompenzimeve/taksa dhe tatime shtesë, pëlqimi për destinimin dhe riinvestimin në infrastrukturën për menaxhim me mbeturinat. Vendosja e skemës për menaxhim vullnetar me prodhimet e vjetra sipas parimit „përgjegjsia mbi prodhuesin “ me kyçjen e shpenzimeve interne të destinuara për deponimin në prodhimet e reja të cilat shiten.		x	x	x	x	x												
<b>MASAT PËR LEJE DHE ZBATIM</b>																				
Vendosja dhe zbatimi i sistemit për leje/liçenca	MMJPH-DMJ	Sistemi i lejeve për kapacitetet dhe aktivitetet për mbledhje/trajtim/deponim të mbeturinave	x	x																
Vendosja e sistemit për monitorim, mbledhje të të dhënave dhe informim	MMJPH-DMJ, QIMMJ,„institucionet e autorizuara, krijuesit e mbeturinave	Mbledhja e të dhënave,kontabilimi dhe informimi,monitorimi i mjedisit jetësor;	x	x																
Kryerja e mbikqyrjes mbi zbatimin dhe informimin	MMJPH-Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor	Inspektimi i krijuesve të mbeturinave dhe kapaciteti për mbledhje/trajtim/deponim për të gjitha llojet e mbeturinave;	x	x	x	x														
<b>Resurset njerëzore/Krijimi i kapaciteteve</b>																				

Kapacitetet e MMJPH	MMJPH-DMJ	Sektori për menaxhim me mbeturinat: punësime të reja dhe trajnim; Inspektimi dhe QIMMJ:trajnimi,paisje për matje dhe përpunimi i të dhënave, ZKP:paisje dhe trajnim për komunikimin me publikun	x	x	x										
Kapacitetet e komunave	Komunat dhe NMMFK në nivel rajonal	Punësime të reja dhe trajnim për shkak të kërkesës së shtuar për menaxhim me mbeturinat nga aspekti politik, organizativ dhe financiar.		x	x	x	x								
Kapacitetet e operatorëve për menaxhim me mbeturinat	Shërbimet publike dhe private për menaxhim me mbeturinat	Ndarja e shërbimeve për menaxhim me mbeturinat nga shërbimet e tjera komunale, pjesëmarrja e sektorit privat në mbledhjen,ndarjen,transportimin e mbeturinave			x	x	x	x	x						
<b>MASAT</b>	<b>SUBJEKTET</b>	<b>LËNDA E DETYRAVE DHE AKTIVITETEVE THEMELORE</b>	<b>VITET E ZBATIMIT</b>												
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
Kapaciteti i krijuesve të mbeturinave	Krijuesit,poseduesit e mbeturinave dhe operatorët e kapaciteteve; MMJPH	Emrimi i personave përgjegjës për çështje të ndërlidhura me mjedisin jetësor; emrimi i menaxhuesve të mbeturinave, planifikimi i menaxhimit të mbeturinave,zbatimi i monitorimit, vendosja e prodhimit dhe prodhimeve më të pastërta,EMAS, teknologji për , IPKN, aktivitetet e komunikimit me publikun, përgatitja e dokumentacionit investues, finansimi i investimeve		x	x	x	x	x	x						
<b>Masat teknike</b>															
<b>MASAT TEKNIKE KOHORE</b>															
Mbledhja,ngarkimi dhe transportimi i fraksioneve të mbeturinave komunale	NMMFK në nivel rajonal; shërbimet publike dhe private për menaxhim me mbeturinat	Përgatitja e skemës teknike dhe studimi fizibiliteti për mbledhjen e fraksioneve të mbeturinave, ngarkimi dhe transporti, tenderet dhe pjesëmarrja e sektorit privat, investimi në sistemin e modernizuar transportues.		x	x	x	x								
Deponimi kohor i mbeturinave komunale	MMJPH, MVL, komunat	Përzgjedhja e lokacioneve për deponi adekuate për mbylljen/sanimin/mbindërtimin për deponimin kohor/të ardhshëm të mbeturinave komunale si pjesë të skemave rajonale për menaxhim me mbeturinat dhe rezultate nga studimet e realizuara fizibiliteti.	x												
Deponimi kohor i mbeturinave komunale	NMMFK në nivel rajonal, MMJPH dhe komunat	Përgatitja e planeve për adaptimin,dokumentet teknike, dokumente për menaxhim hapsinor dhe dokumente investuese për mbylljen/sanimin/mbindërtimin e deponive; kërkesa për finansime nga fondet e mbrendëshme dhe ato ndërkombëtare, menaxhimi administrativ, teknik dhe financiar me investime nga paisja me leje, ndërtimi deri ke afarizmi me kapacitetet rajonale për menaxhim me mbeturinat.		x	x	x	x	x	x						
Sistemi për menaxhim me mbeturinat e rrezikshme industriale	MMJPH, krijuesit e mbeturinave industriale	Vendosja e sistemit për mbledhjen e të dhënave/informatave Mbledhja e ndarë e mbeturinave të rrezikshme në burimin dhe skladimi i kohshëm (nëse është i zbatueshëm)	x	x											

MASAT	SUBJEKTET	LËNDA E DETYRAVE DHE AKTIVITETEVE THEMELORE	VITET E ZBATIMIT												
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
MASAT TEKNIKE SISTEMATIKE															
Deponi për <b>mbeturinat komunale</b>	NMMFK në nivel rajonal, MMJPH dhe komunat	Përgatitja e dokumenteve teknike, dokumente për menaxhim me hapësirën dhe dokumente investuese për deponitë e reja rajonale dhe për mbledhjen e fraksioneve të cilat mund të reciklohen, kërkesa për finansim nga fondet e brendëshme dhe ato ndërkombëtare, menaxhimi administrativ, teknik, dhe financiar me investimet nga paisja me leje, ndërtimi deri ke afarizmi me deponitë rajonale.				x	x	x	x	x	x	x			
Menaxhimi me <b>lloje të veçanta të mbeturinave</b>	MMJPH, NMMFK/niveli rajonal/, sektori ekonomik rajonal, ndërmarrjet private	Përgatitja e dokumenteve teknike, dokumentet për menaxhim me hapësirën, dokumente organizative dhe investuese për mbledhje, përpunim/reciklim të materialit që mund të reciklohet, paketimi dhe mbeturinat nga paketimidhe prodhimet e tjera të vjetra, tenderet dhe lidhja e marrëveshjeve.						x	x	x	x	x	x	x	x
Proektimi i repartëve dhe deponive për menaxhim me <b>mbeturinat e rrezikshme</b>	MMJPH, krijuesit e mbeturinave të dëmshme	Kërkesa për finansim nga fondet e brendëshme dhe ato ndërkombëtare. Përgatitja e dokumenteve teknike, dokumenteve për menaxhim me hapësirën dhe dokumentet investuese për vendosjen e sistemit për menaxhim me mbeturinat e rrezikshme (mbledhja e fraksioneve të ndara në vet burimin, skladimi me kohë, shfrytëzimi, paratrajtimi, ndërtimi/rikonstruimi i deponive ose i teknikave të tjera për deponim të sigurt në vend ose jasht vendit)		x	x	x									
Ndërtimi/afarizmi me repartet dhe deponitë për menaxhim me <b>mbeturinat e rrezikshme</b>	MMJPH dhe/ose ndërmarrjet e licensuara specialiste (ndërmarrjet private/publike)	Ndërtimi i një deponie të përbashkët për mbeturina të rrezikshme/rikonstruktimi i deponive ekzistuese për mbeturina të rrezikshme industriale/puna e deponive me reparte për paratrajtim				x	x	x							
Proektimi i kapaciteteve për trajtim dhe deponim të <b>nus-prodhimeve me prejardhje nga kafshët</b> nga fermat blegtorale dhe thertoret	MMJPH, MBPAU dhe/ose krijuesit e nus-prodhimit me prejardhje nga kafshët	Kërkesë për finansim nga fondet e brendëshme dhe ato ndërkombëtare. Përgatitja e dokumenteve teknike, dokumenteve për menaxhim me hapësirën dhe dokumenteve investuese për vendosjen e sistemit për menaxhim me nus-prodhimet me prejardhje nga kafshët (dorëzimi dhe deponimi i prodhimeve si prioritet i I, prodhimi i biogazit dhe plehrave si prioritet i II)			x	x	x								
Ndërtimi/afarizmi me repartet dhe deponitë për menaxhim me	Ndërmarrjet e specializuara (ndërmarrjet publike/private)	Ndërtimi/puna e instalimeve të reja për përfshirjen e biogazit/prodhimi i energjisë elektrike.						x	x	x	x				





Strategjia për komunikim me subjektet e interesuara	МЖСПП –ККЈ, создавачи на отпад	Kryerja e detyrave informative, konsultative, dhe koordinative për ngritjen e vetëdijes dhe diturive për problemet e ndërlidhura me mbeturinat dhe zgjidhjet e tyre.	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Strategjia e komunikimit me publikun	ММЈРН-ЗКР, të gjitha subjektet e interesuara	Realizimi i kampanjave për njohjen me problemet që kanë të bëjnë me mbeturinat dhe rreziqet e ngjashme, me qëllim që të ndryshohen perceptimet negative për çështjet nga sfera e menaxhimit me mbeturinat, për përmirësimin e arkëtimit, edukimi kundër mënjanimin jolegal të mbeturinave, mbështetja e proekteve të reja për menaxhim me mbeturinat dhe investimi në objektet e infrastrukturës.	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	X

Kjo strategji do të shpallet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë ”

**Nr. 19-1541/1 e sjellur më**

11 mars të vitit 2008

Shkup

**ZËVENDËS KRYETAR I QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Mr. Zoran Stavreski

## 6. ANEKSI


### Lista e shkurtesa

OMRE	Opcioni Më i Mirë Real Ekologjik
VNMJ	Vlerësimi i Ndikimeve ndaj Mjedisit Jetësor
AV	Automjetet e Vjetra
EMAS	Skemë për Menaxhimin e Mjedisit Jetësor dhe Revizioni Ekologjik
UE	Unioni European
PBV	Prodhimtaria Bruto e Vendit
HDPE	Polietileni me Dendësi të Lartë
HZW	Mbeturina të Rrezikëshme
PIKN	Parandalimi i Integruar dhe Kontrolli i Ndotjes
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
TMB	Tretman Mekaniko-biologjik
MOH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MVL	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
ME	Ministria e Ekonomisë
MMJPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapsinor
MF	Ministria e Financave
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MTL	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
PNAMJ	Plani Nacional Aksional i Mjedisit Jetësor
OJQ	Organizata Joqeveritare
PNMB	Plani Nacional i Menaxhimit të Mbeturinave
SNMM	Strategjia Nationale e Menaxhimit të Mbeturinave
Pb	Plumbi
PCB	Polikloruret Bifenile
PCT	Polikloruret Trefenile
PET	Polietilenteraftafati
ZKP	Zyra e Komunikimit me Publikun (MMJPH)
PPP	Partneriteti Privat-Publik
PVC	Polivinilkloruri
ISHB	Inspektorati Shtetërorë i Bujqësisë (MBPAU)
ISHMJ	Inspektorati Shtetërorë i Mjedisit Jetësor (MMJPH)
ISHT	Inspektorati Shtetërorë Tregtarë (ME)


ISHSSH	Inspektorati Shtetëror Sanitaro-Shtetëror (MSH)
SMM	Strategjia e Menaxhimit me Mbeturinat
NT	Ndihma Teknike
ToR	Detyrat Proektuese
VOC	Bashkimi i organeve të avulluara
WEEE	Paisja e Mbeturinave Elektrike dhe Elektronike
Zn	Zing




## LIOJET DHE SASIA E DISA MBETURINAVE TË VEÇANTA , VITI 2005




## MENAXHIMI EKZISTUES ME MBETURINAT (VITI 2005 )




## PARIMET THEMELORE TË SKEMËS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT KOMUNALE




# PARIMET THEMELORE TË SKEMAËS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT MEDICIONALE



# PARIMET THEMELORE TË SKEMËS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT E RREZIKSHME DHE TË PARREZIKSHME INDUSTRIALE



## PARIMET THEMELORE TË SKEMËS PËR MENAXHIM ME MBETURINAT DHE MBETJET URBANE



## PARIMET THEMELORE PËR SKEMËN E MBETURINAVE BUJQËSORE DHE NUS-PRODHIMEVE

